# TAKVIM
# 1447-1448

# KALENDAR
# 2026

*Boton:*
**KRYESIA E BASHKËSISË ISLAME TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**
*Prishtinë, rr. "Bajram Kelmendi" nr. 182*
**Tel & fax: 038 / 224-001**
**www.bislame.com**
e-mail: takvimi@hotmail.com

*Për botuesin:*
**Myftiu, Naim ef. Tërnava**

*Kryeredaktor:*
**Ahmet Sadriu**

*Redaksia:*
Resul Rexhepi
Sabri Bajgora
Ramadan Shkodra

*Lektor:*
Bajram Zeqiri

*Redaktor teknik & kopertina:*
Nuhi Simnica

*Shtypi:*
"Printing press"- Prishtinë

© **Copyright:**
Të gjitha të drejtat e botimit, ribotimit, fotokopjimit a përkthimit i përkasin Kryesisë së BI-së të Kosovës.
Ndalohet me ligj riprodhimi i plotë apo i pjesshëm pa lejen e botuesit

# TAKVIM
# 1447-1448

# KALENDAR
# 2026

Prishtinë

بسم الله الرحمن الرحيم

*Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!*

# NË VEND TË PARATHËNIES

Falënderojmë dhe madhërojmë Allahun e Madhëruar - Krijuesin e kësaj gjithësie, Sunduesin, Mbikëqyrësin, Furnizuesin, Zotin e qiejve dhe të Tokës, të Plotfuqishmin, të Gjithëdijshmin, Absolutin.

E lusim Allahun e Gjithëdijshëm që të na e shtojë dijen dhe të na bëjë prej atyre që punojnë me ato që Ai na ka mësuar. E lusim Atë që të jetë i kënaqur me ne dhe familjet tona.

Mëshira dhe bekimi i Allahut qofshin mbi Pejgamberin tonë, Muhamed Mustafanë, mbi familjen dhe shokët e tij të sinqertë, si dhe mbi të gjithë ata që e pasuan dhe do ta pasojnë rrugën e tij deri në Ditën e Gjykimit.

*Të nderuar lexues,*

Revista *"Takvimi"* po vazhdon misionin e saj, të cilin e ka nisur që nga themelimi, duke dhënë kështu mesazhin te çdo besimtar, pa marrë parasysh peripecitë dhe vështirësitë, të cilat kohë pas kohe paraqiten në rrugëtimin e saj. Duke pasur parasysh zhvillimet e shpejta teknologjike, kur tashmë një numër i madh i revistave veçse kanë kaluar në platformat online, revista *"Takvimi",* vazhdon edhe më tej të publikohet në formën e saj origjinale, dhe kjo falë kërkesave dhe interesimit të lexuesve të saj. Për të gjithë këtë, ne falënderojmë lexuesin tonë të respektuar, pastaj bashkëpunëtorët tanë dhe në veçanti falënderojmë Kryesinë e Bashkësisë Islame të Koso-

vës, e cila gjithherë i është përgjigjur pozitivisht kërkesave të redaksisë së revistës.

Revista *"Takvimi"* e këtij viti, në brendësinë e saj, përmbledh tema nga fusha të ndryshme, si: akaidi, tefsiri, fikhu, ahlaku, arsimi, e drejta sheriatike dhe fusha të tjera, të cilat e karakterizojnë natyrën e kësaj reviste. Në të, gjithashtu përmblidhen edhe opinione dhe kontribute të dijetarëve eminentë islamë, e që në gjuhën shqipe, vijnë të përkthyera nga bashkëpunëtorët tanë.

Si zakonisht, edhe këtë vit, revistën *"Takvimi",* e kemi ndarë në dy pjesë, në atë tematike dhe atë kalendarike. Në pjesën e parë, kemi sjellë tema të ndryshme, duke filluar nga ato, që kanë të bëjnë me besimin e deri te temat që kanë të bëjnë me trajtimin edukativ.

Tema e parë ka të bëjë me lirinë e besimit, pra me atë se si mundet njeriu të arrijë deri te besimi, pra deri tek e vërteta. Kjo temë vjen e shkruar dhe e trajtuar nga Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnava.

Pas kësaj teme, kemi sjellë një temë nga tefsiri, më konkretisht komentimin e ajeteve 71-75 të sures Ez Zumer, në të cilat autori, prof. Sabri ef. Bajgora, shtjellon domethënien e këtyre ajeteve, duke na bërë me dije se Dita e Gjykimit është e sigurt dhe se atë ditë, njerëzit do të ndahen në grupe, jobesimtarët në njërën anë dhe besimtarët në anën tjetër.

Se si ta shpenzojmë pasurinë tonë për bamirësi, është tema e radhës, për të vazhduar më pas me një vështrim rreth rëndësisë së qetësisë në namaz, pra përkushtimit ndaj shtyllës së dytë të fesë, namazit.

Për rëndësinë e kohës dhe shfrytëzimin e saj në adhurimin e Krijuesit, më pas për udhëzimin e Kuranit për besim të

drejtë dhe moral fisnik, dhe në fund për cilësitë siç janë: injoranca, diskriminimi dhe fanatizmi, që nuk i takojnë Islamit, flasin temat e radhës.

Si duhet që besimin tonë ta shoqërojmë me vepra të mira, të ofruar me shembuj konkret dhe për Islamin dhe integrimin evropian, janë temat që e vazhdojnë përmbajtjen e këtij numri. Edukimi dhe përgatitja e fëmijëve pas mungesës sonë, mendjemadhësia si virtyt i shëmtuar, janë ndër temat e fundit, ndërsa e kemi përmbyllur këtë numër me një temë që na e përkujton një prej tragjedive më të mëdha njerëzore të fund shekullit XX, atë të Srebrenicës, ku u vranë dhe u masakruan mbi 8000 boshnjakë të pafajshëm.

Redaksia e *"Takvimit"* jo domosdoshmërish pajtohet me opinionet e autorëve të shkrimeve që boton.

Lexues të nderuar, me këtë rast po ua rikujtojmë se revista *"Takvimi"* përmban në brendinë e saj ajete kuranore dhe hadithe të Pejgamberit a.s., prandaj luteni që, gjatë përdorimit të saj, të keni kujdes.

Dhe krejt në fund, e lusim Fuqiplotin të na ndihmojë që amanetin ta kryejmë me përgjegjësinë më të lartë, të na i falë gabimet dhe jemi nën mbrojtjen e Tij përgjithmonë.

Vetëm me ndihmën e Allahut arrihen qëllimet dhe ia dilet mbanë.

و الحمد لله على نعمته العظيم

Vel hamdulil-lahi ala niametihi el adhijm.

*Prishtinë,*
*dhjetor 2025*

**Ahmet Sadriu**

**Myftiu Naim ef. TËRNAVA**

# LIRIA E BESIMIT
## (Kapacitetet e kufizuara të njeriut që si i vetëm ta gjejë të vërtetën)

Allahu, xh.sh., e veçoi njeriun prej krijesave të tjera duke ia dhuruar mendjen dhe veçoritë e tjera dalluese, përmes së cilave ia mundësoi edhe që ta arrijë atë që nuk kanë mundësi për të arritur krijesat e tjera, në raport me organizimin e jetës dhe përkushtimin në besim dhe adhurim të Zotit Një të Vetëm, Krijuesit të kësaj gjithësie.

Shumë herë kemi thënë se mendja e njeriut është e kufizuar, e për këtë arsye edhe njohuritë e tij janë të kufizuara. Edhe arritjet e njeriut, përkundër se janë të mëdha dhe mbresëlënëse, dhe të cilat gjithsesi se duhen vlerësuar e pasur në konsideratë, megjithatë janë të kufizuara. Po ashtu, edhe çdo gjë që e posedon njeriu në veten e tij është e kufizuar dhe ka nevojë për ndihmë në raport me qëllimin që njeriu synon ta arrijë.

Të gjitha veçoritë (cilësitë) e njeriut janë të kufizuara, siç janë: shi kimi, dëgjimi, fuqia, dëshira, vullneti, jeta e kështu me radhë.

Mendja e njeriut, e cila edhe e veçon njeriun prej gjallesave të tjera, është për t'u respektuar për përpjekjet e vazhdueshme në zbulimin e fshehtësive të kësaj bote dhe shpikjet për

lehtësimin e jetës së njeriut, pra që njeriu të jetojë sa më në rehati dhe sa më mirë. Megjithatë, horizonti i studimit është i kufizuar, edhe pse në sytë tanë njeriu në kë të kohë vetëm se e ka arritur atë që nuk e ka ëndërruar ta arrijë në të kaluarën e afërt. Sot jemi dëshmitarë të zbulimeve të njëpasnjëshme që bëjnë njerëzit, dëshmitarë të studimeve në hapësirë, përpjekje e rezultate që trokasin në rizgjimin e mëtutjeshëm të ndërgjegjes së njeriut në raport me Krijuesin, që patjetër të arrihet deri tek ajo që urdhëron Kurani. Dhe, kështu duhet të vazhdohet derisa mendja të lirohet nga iluzioni, nga epshi, nga humbja, e ta dijë atë për çfarë asnjëherë nuk ka pasur dije, dhe përmes saj të triumfojë ndaj të keqes, ndaj epsheve, ndaj çdo gjëje që njeriun e largon nga qëllimi i ardhjes së tij në këtë jetë.

Zoti, xh.sh., e udhëzoi dhe e begatoi babanë e njerëzimit, Ademin, a.s., kur atë e krijoi nga toka dhe i mundësoi ta organizojë jetën në To kë, ta zbukurojë atë dhe të jetë në vazhdimësi me urdhrat dhe adhurimin ndaj Tij. Ai që nuk dëgjon dhe nuk i përfill këto urdhra të Allahut, xh.sh., këto shpallje të dërguara prej Tij, i tilli do të jetë në humbje.

## Mohimi si reflektim i dobësimit shpirtëror, jo i fakteve

Pjesa më e madhe e njerëzve, të prirë nga egoja dhe të mishëruar me intrigat e shejtanit, megjithatë e refuzuan dhe nuk e besuan Tevra tin, Inxhilin, Zeburin, dhe njësoj gjer më sot vazhdon historia edhe me Kuranin, si fjalë të Zotit, xh.sh. Allahu, xh.sh., thotë:

وَمَا قَدَرُوا اللَّهَ حَقَّ قَدْرِهِ إِذْ قَالُوا مَا أَنْزَلَ اللَّهُ عَلَى بَشَرٍ مِنْ شَيْءٍ قُلْ مَنْ أَنْزَلَ الْكِتَابَ الَّذِي جَاءَ بِهِ مُوسَى نُورًا وَهُدًى لِلنَّاسِ تَجْعَلُونَهُ قَرَاطِيسَ تُبْدُونَهَا وَتُخْفُونَ كَثِيرًا وَعُلِّمْتُمْ مَا لَمْ تَعْلَمُوا أَنْتُمْ وَلَا آبَاؤُكُمْ قُلِ اللَّهُ ثُمَّ ذَرْهُمْ فِي خَوْضِهِمْ يَلْعَبُونَ

***"Ata** (mohuesit) **nuk e njohën Allahun sa duhet njohur Atë kur thanë: "Allahu nuk i shpalli gjë asnjë njeriu." Thuaj: "Kush e zbriti librin me të cilin erdhi Musai, e që ishte dritë e udhërrëfyes për njerëz, e të cilin ju e bëni të shpërndarë në letra, që disa i prezantoni kurse shumicën i fshihni?! Dhe u mësuat çka nuk e dinit ju e as prindërit tuaj?!" Thuaj: "Allahu** (e zbriti)." **Mandej lëri ata që luajnë në atë kotësinë e tyre!"** (Enamë: 91)*

S'ka dyshim se Kurani është begati për mbarë botën, ngase Allahu, xh.sh., na e bën me dije se Kurani dhe Muhamedi, a.s., ishin dërguar mëshirë për mbarë njerëzimin, përkundër asaj që mohuesit e Zotit Një e refuzojnë këtë qasje.

Me këtë ajet dhe të ngjashëm si ky Allahu, xh.sh., na e bën me dije se mohuesit nuk e njohën dhe nuk e besuan Zotin Një, sa dhe si duhet. Ata e mohuan edhe dërgimin e pejgamberëve dhe zbritjen e librave të shpallur, si dhe i thoshin Muhamedit, a.s., se Zoti nuk i ka zbritur njeriut asgjë nga librat e shpallur. Pra, ndodhte ashtu siç po ndodh edhe sot, kur shumica e njerëzve i refuzojnë mësimet e Kuranit. Mirëpo Allahu, xh.sh., po e urdhëron Muhamedin, a.s., që t'u thotë atyre mohuesve, e me këtë ngjan sikur na drejtohet edhe ne sot, t'u themi mohuesve se, kush është Ai që e zbriti Tevratin te Musai, shpjeguesin dhe udhëzuesin për popujt ku

u dërgua, duke urdhëruar në të mirë dhe duke urdhëruar për largim nga e keqja?! Pra, librin për të cilin ju (çifutë) nuk treguat kurrfarë respekti, sepse e shpërndatë në fletë, duke i paraqitur disa e duke i fshehur disa, pastaj në atë që e lexonit duke paraqitur çka dëshironit vetë, pra, duke ndërhyrë dhe duke e devijuar dhe duke e fshehur atë që dëshironit ju nga fjala e Allahut, xh.sh.?!

Në fakt çifutët besuan dhe nuk e refuzuan Tevratin. Prandaj, tani me rastin e Kuranit, si është e mundshme që ata e refuzojnë Kuranin dhe të thonë se “Allahu nuk i shpalli gjë asnjë njeriu”, ndërsa e besuan shpalljen e Tevratit te Musai, a.s.?! Pra, si refuzojnë tash kur dihet se ata mësuan nga shpallja atë që nuk e dinin, as ata e as prindërit e tyre, për çështje të kësaj bote dhe për çështje që kanë të bëjnë me fenë?! Zoti, xh.sh., i thotë Muhamedit, a.s., që t’u drejtohet atyre e t’u thotë se “Allahu është Ai që e zbriti edhe Tevratin, edhe Kuranin.”

Kurani, ky libër përplot me begati për universin mbarë, e në veçan ti për njeriun, me të mira pa kufi, i zbriti Muhamedit, a.s., duke mos bërë kurrfarë dallimi në shpallje me atë që ka zbritur apo që është shpallur më herët, siç qenë librat e shenjtë: Tevrati, Inxhili, Zeburi, apo edhe fletushkat.

Për këtë kemi edhe ajetin kuranor nga sureja Nisa:

إِنَّا أَوْحَيْنَا إِلَيْكَ كَمَا أَوْحَيْنَا إِلَى نُوحٍ وَالنَّبِيِّينَ مِنْ بَعْدِهِ وَأَوْحَيْنَا
إِلَى إِبْرَاهِيمَ وَإِسْمَاعِيلَ وَإِسْحَاقَ وَيَعْقُوبَ وَالْأَسْبَاطِ وَعِيسَى
وَأَيُّوبَ وَيُونُسَ وَهَارُونَ وَسُلَيْمَانَ وَآتَيْنَا دَاوُودَ زَبُورًا

***“Ne të frymëzuam ty me shpallje sikurse e patëm frymëzuar Nu hun dhe pejgamberët pas tij; e patëm fry-***

***mëzuar Ibrahimin, Is mailin, Is'hakun, Jakubin dhe pasardhësit e tij, Isain, Ejubin, Junusin, Harunin, Sulejmanin, e Davudit ia patëm dhënë Zebu rin."*** *(Nisa: 163).*

Zoti, xh.sh., ua bënë me dije ithtarëve të librave, përmes Muhamedit, a.s., pra në përgjithësi, se ata ishin që e bënë dallimin mes pejgamberëve, duke i besuar disa, dhe duke i mohuar disa. Kurani përshkruan qëndrimet e çifutëve, ngase ata, bazuar në mendjemadhësinë dhe zili në e tyre të madhe, i thoshin Muhamedit, a.s., që t'ua zbresë përnjëherë një libër nga qielli në mesin e tyre, libër prej Zotit, xh.sh., në mënyrë që ata të binden në atë që thërriste Muhamedi, a.s. Zilia dhe mendjemadhësia e çifutëve nuk ishte diçka e re. Ata edhe më herët kishin pasur kërkesa dhe pyetje të tilla, të cilat i kishin bërë edhe para Musait, a.s. Ata bënë vepra të liga dhe e mohuan edhe Isain, a.s., të cilin, për më tepër edhe u munduan ta vrisnin.

Muhamedit, a.s., iu shpall revelata sikurse edhe pejgamberëve të tjerë para tij. Allahu, xh.sh., në Kuran na bën me dije se e frymëzoi me shpallje edhe Muhamedin, a.s., si pejgamber i fundit. Në Kuran është përmbledhur çdo gjë. Kurani është libër që përfshin përmbajtjen në vija të trasha të tërë shpalljeve, nisur prej Ademit, a.s. Kjo sepse edhe ata që ishin para Muhamedit, a.s., u frymëzuan po nga i njëjti burim, përmes engjëllit Xhibril. Allahu, xh.sh., ashtu siç e frymëzoi Nuhin, Ibrahimin, Imailin, Is'hakun, Jakubin dhe pasardhësit e tij, Isain Ejubin, Junusin, Harunin, Sylejmanin, Davudin, të cilit edhe ia zbriti 31 Muhamed Mahmud Hixhazi, Et tefsir el vadih, (Kajro; Universiteti i Az'harit, b. 9, 1978), f. 87. librin

Zeburin, po ashtu e frymëzoi edhe Muhamedin, a.s. Allahu, xh.sh. thotë në Kuranin fisnik në shenjë të Isait, a.s.:

ثُمَّ قَفَّيْنَا عَلَى آثَارِهِمْ بِرُسُلِنَا وَقَفَّيْنَا بِعِيسَى ابْنِ مَرْيَمَ وَآتَيْنَاهُ
الْإِنْجِيلَ وَجَعَلْنَا فِي قُلُوبِ الَّذِينَ اتَّبَعُوهُ رَأْفَةً وَرَحْمَةً وَرَهْبَانِيَّةً
ابْتَدَعُوهَا مَا كَتَبْنَاهَا عَلَيْهِمْ إِلَّا ابْتِغَاءَ رِضْوَانِ اللَّهِ فَمَا رَعَوْهَا حَقَّ
رِعَايَتِهَا فَآتَيْنَا الَّذِينَ آمَنُوا مِنْهُمْ أَجْرَهُمْ وَكَثِيرٌ مِنْهُمْ فَاسِقُونَ

***“Pastaj vazhduam pas tyre me të dërguarit Tanë, e pas tyre e dërguam Isain, të birin e Merjemes, dhe atij ia dhamë Inxhilin, e në zemrat e ithtarëve të tij dhuruam butësi e mëshirë, ndërsa murgërinë e shpikën ata vetë...”*** *(Hadid: 27)*

I zgjedhuri i fundit për pejgamber nga mesi i beni Israilëve ishte Isai, a.s., i cili lajmëroi edhe për ardhjen e Muhamedit, a.s., pas tij si pejgamber. Allahu, xh.sh., ia shpalli Inxhilin Isait, a.s., dhe në zemrat e ithtarëve të tij dhuroi butësi e mëshirë, e këta ishin havarijunët - apostujt, të cilët e kishin frikë Zotin, xh.sh., dhe ishin të mëshirshëm e me moral të lartë.

As Musai, a.s., nuk ishte pejgamberi i fundit të cilit iu shpall libër prej Zotit, xh.sh., libër i shenjtë, siç pretendojnë hebrenjtë. Shpallja e Allahut, xh.sh., vazhdoi edhe pas tij, te pejgamberët e tjerë me radhë, ngase shumë popuj kishin devijuar nga ajo që kishte zbritur e urdhëronte Tevrati. Allahu, xh.sh., e dërgoi Isain, a.s., për pejgamber të parafundit, duke ia dhuruar (shpallur) edhe librin e shenjtë, Inxhilin, i cili kishte të njëjtin qëllim sikurse Tevrati: që njerëzit të largoheshin nga besimet e kota dhe ta besonin Zotin Një, duke u përkushtuar në tërë atë që Allahu, xh.sh., ka zbritur (shpallur)

brenda librave të shenjtë. Për këtë na mëson edhe Kurani, përmes ajetit kuranor që e përmendëm më lart.

Isai, a.s., biri i Merjemes, u zgjodh pejgamber i parafundit, dhe atij iu shpall libër i shenjtë, iu shpall Inxhili, që kishte po të njëjtin qëllim që kishin edhe shpalljet e mëhershme te pejgamberët e mëparshëm: thirrjen e popullit beni Israil për besim në Zotin Një dhe adhurim të Tij, si dhe zbatimin në praktikë të tërë asaj që ishte shpallur në Inxhil.

Mirëpo, shumica e popullit nuk e dëgjoi dhe nuk e besoi atë për të cilën u dërgua Isai, a.s., pra, nuk besuan në shpalljen e Allahut, xh.sh., me përjashtim të një numri të vogël besimtarësh.

Në Inxhil, Allahu, xh.sh., kishte lajmëruar edhe për ardhjen e të dërguarit të fundit, Muhamedit, a.s. E tërë shoqëria njerëzore, përafërsisht për gjashtë shekuj, po priste momentin se kur do të vinte pejgamberi i premtuar prej Isait, a.s., dhe të merrnin fund edhe shumë padrejtësi. Allahu, xh.sh., thotë:

تَبَارَكَ الَّذِي نَزَّلَ الْفُرْقَانَ عَلَى عَبْدِهِ لِيَكُونَ لِلْعَالَمِينَ نَذِيرًا

***“I Madhëruar qoftë Ai që ia shpalli Furkanin** (Kuranin, dalluesin e të vërtetës nga e pavërteta) **robit të vet** (Muhamedit) **që të bëhet pejgamber i botës** (këshillues)!” (Furkan: 1)*

## Kurani i vërteton shpalljet dhe librat e mëparshëm hyjnorë

Falënderimi gjithherë i takon Allahut, xh.sh. i Cili e zbriti Kuranin fisnik te njeriu më fisnik e më bujar, i cili jetoi dhe veproi me Kuran për sa ishte gjallë! Allahu, xh.sh., këtë libër ia shpalli pa asnjë të metë. Pra, në të nuk mund të ketë apo të

gjendet ndonjëherë ndonjë mungesë, kontradiktë apo kundërthënie. Shpallja është e plotë dhe origjinali teti i saj është ruajtur me saktësinë, vërtetësinë, qëndrueshmërinë dhe përhershmërinë më të madhe ashtu siç ka zbritur. Dhe pikërisht kjo e bën dallimin mes të vërtetës dhe të pavërtetës, udhëzimit dhe humbjes, asaj që sot gjendet në librat e shpallur dikur dhe asaj që sot gjendet në Kuran. Këtë Kuran Allahu, xh.sh., ia shpalli, siç thotë Ai "Robit të Vet", duke e cilësuar dhe duke e nderuar Muhamedin, a.s., me këtë atribut, se ai ishte adhurues i Allahut, xh.sh., dhe i zgjedhur i Tij i ve çantë.

Allahu, xh.sh., e shpalli Kuranin si dallues i së mirës e i së vërtetës nga e pavërteta e gënjeshtra. Ai këtë ia shpalli robit të vet, Muhamedit, a.s., dhe e delegoi si shpallje për botën mbarë, pa dallim vendi, race apo gjuhe. Dhe, më e rëndësishmja, me këtë shpallje merr fund dërgimi i pejgamberëve, si dhe mbyllet dera e shpalljeve dhe e pejga mberisë. Allahu, xh.sh., thotë:

نَزَّلَ عَلَيْكَ الْكِتَابَ بِالْحَقِّ مُصَدِّقًا لِمَا بَيْنَ يَدَيْهِ وَأَنْزَلَ التَّوْرَاةَ
وَالْإِنْجِيلَ (٣) مِنْ قَبْلُ هُدًى لِلنَّاسِ وَأَنْزَلَ الْفُرْقَانَ إِنَّ الَّذِينَ
كَفَرُوا بِآيَاتِ اللَّهِ لَهُمْ عَذَابٌ شَدِيدٌ وَاللَّهُ عَزِيزٌ ذُو انْتِقَامٍ (٤)

***"Ai ta ka shpallur ty Librin me të vërtetën e saktë, duke vërtetu ar shpalljet e mëparshme. Ai e ka zbritur Tevratin dhe Inxhilin, udhërrëfim për njerëz; e zbriti edhe Furkanin*** *(dalluesin e së vërtetës nga gënjeshtra).* ***Ata që i mohojnë argumentet e Allahut s'ka dyshim se i pret ndëshkim i rreptë. Allahut është Ngadhë njyes, Shpagimtar!"*** *(Ali Imran: 3-4).*

Kurani me saktësinë e zbritjes vërteton çdo gjë që ka ndodhur më herët. Ai e vërteton edhe zbritjen e Tevratit dhe të Inxhilit, po edhe shpalljet e tjera.

Furkani (Kurani) është dalluesi i së mirës nga e keqja, i së vërtetës nga gënjeshtra e devijimi, si dhe udhëzuesi i vetëm i drejtë për besim në Zotin Një dhe adhurim të Tij. Të gjithë ata që në një apo mënyrën tjetër nuk e besojnë atë që i Madhi Zot, xh.sh., e ka zbritur (shpallur) te pejgamberët e tij, të tillët (jobesimtarët) do të ndëshkohen me ndë shkim të rëndë, kur në Ditën e Gjykimit do të dalin para Allahut, xh.sh., ngase ata i mohuan argumentet e zbritura prej Allahut, xh.sh. Allahu, xh.sh., thotë në Kuranin fisnik:

قُلْ مَنْ كَانَ عَدُوًّا لِجِبْرِيلَ فَإِنَّهُ نَزَّلَهُ عَلَى قَلْبِكَ بِإِذْنِ اللَّهِ مُصَدِّقًا
لِمَا بَيْنَ يَدَيْهِ وَهُدًى وَبُشْرَى لِلْمُؤْمِنِينَ

***“Thuaj: “Kush është armik i Xhibrilit** (është armik i Allahut), **e ai me urdhrin e Allahut e zbriti Kuranin në zemrën tënde, që është vërtetues i asaj që ishte më parë dhe udhërrëfyes e përgë zues për besimtarët.”** (Bekare: 97)*

Çifutët thonë se Xhibrili është engjëlli që është armik i tyre, ngase ai ka zbritur urdhër për shkatërrim, çarje e plasaritje në mesin e tyre. Në fakt Xhibrili e ka zbritur të vërtetën te Muhamedi, a.s., e vërtetë e cila fakton të vërtetën e shpalljes apo zbritjes së fjalës së Allahut, xh.sh., edhe te Musai, a.s. Asgjë nuk shpallet, apo asgjë nuk mund të vijë pa urdhrin e Allahut, xh.sh., dhe çdo gjë e zbritur si nga urdhri, ashtu edhe nga përmbajtja, ka për qëllim udhëzimin e shoqërisë njerëzore për besim të drejtë dhe udhëzim për kryerjen e veprave të mira.

## Besimi apo mohimi i pjesshëm si formë e mosbesimit

Nuk mund dhe nuk është e drejtë, madje është edhe e papranuesh me në çdo kohë dhe çfarëdo rrethane, që Kurani, shpallja e Allahut, xh.sh., të besohet pjesërisht, apo të mohohet pjesërisht. Nëse vetëm një fjalë nga Kurani e mohojmë, duke thënë se nuk është prej Allahut, xh.sh., apo se është e gabuar, atëherë mohuesi konsiderohet jobesim tar. Pra, kush është armik i Xhibrilit, është armik edhe i Allahut, xh.sh. Apo, me një gjuhë tjetër, kush nuk e beson Xhibrilin se është engjëll i shpalljes, ai nuk e ka besuar as Allahun për Krijues të kësaj gjithësie, dhe i tilli ka bërë kufër - ka mohuar, prandaj i tilli edhe është jobesimtar.

Duhet ditur se Kurani është vërtetuesi i vetëm i shpalljeve të më hershme, dhe se askush nuk mund të dijë rreth tyre më shumë sesa ajo që sjell Kurani. Zoti, xh.sh., thotë:

مَنْ كَانَ عَدُوًّا لِلَّهِ وَمَلَائِكَتِهِ وَرُسُلِهِ وَجِبْرِيلَ وَمِيكَالَ فَإِنَّ اللَّهَ عَدُوٌّ لِلْكَافِرِينَ

***“Kush është armik i Allahut, i engjëjve të Tij, i të dërguarve të Tij, i Xhibrilit dhe i Mikailit*** *(ai është jobesimtar).* ***Allahu pa dyshim se është armik i jobesimtarëve.”*** *(Bekare: 98)*

Ata që ishin armiq të Xhibrilit dhe të asaj që ai solli, ata janë edhe armiq të Allahut, xh.sh. E, ata që janë armiq të Allahut, xh.sh., janë edhe armiq të engjëjve, të pejgamberëve, të Xhibrilit e Mikailit. Duhet ditur se Allahu është armik i atyre që mohojnë në atë që thërret Allahu, xh.sh., për t’u be-

suar dhe për t'u adhuruar, e Ai është Allahu Një i Vetëm. Allahu, xh.sh., thotë në Kuran:

نَزَّلَ عَلَيْكَ الْكِتَابَ بِالْحَقِّ مُصَدِّقًا لِمَا بَيْنَ يَدَيْهِ وَأَنْزَلَ التَّوْرَاةَ وَالْإِنْجِيلَ

***"Ai ta ka shpallur ty Librin me të vërtetën e saktë, duke vërtetu ar shpalljet e mëparshme. Ai e ka zbritur Tevratin dhe Inxhi lin."*** *(Ali Imran: 3)*

Pra, Zoti, xh.sh., është Ai që e zbriti Kuranin te Muhamedi, a.s., drejtuar njerëzimit mbarë, si dhe e zbriti Tevratin e Inxhilin dhe tërë shpalljet e tjera hyjnore, dhe Allahu, xh.sh., ka dashur që këto shpallje (libra të shpallur) prej Tij të jenë në mesin e brezave të shumtë, në mesin e popujve të caktuar dhe vende të caktuara. Këto shpallje e fletush ka janë ruajtur e mësuar prej pjesëtarëve të shumtë në popujt ku ishin shpallur. Megjithatë, prapë vërehet se, bazuar në gjendjen dhe rrethanat e krijuara nëpër ato kohë të hershme, po edhe në problemet e shumta në mesin e shoqërive njerëzore, këto shpallje, me përjashtim të Kuranit, e humbën origjinalitetin e zbritjes. Besimi i disa pjesëve nga libri i Allahut, xh.sh., dhe mohimi i disa pjesëve të tjera jo vetëm që e nxjerr njeriun nga besimi, por ai njeri është edhe i kërcënuar se në botën tjetër do ta ketë një dënim të ashpër, ndërsa në këtë botë do të ketë nënçmim dhe poshtërim. Këto vepra i bënë izraelitët, e që Allahu, xh.sh., i kërcënoi. Mirëpo edhe besimtarët, nëse besimi i tyre në Kuran është i pjesshëm, do të vle rësohen njësoj.

...أَفَتُؤْمِنُونَ بِبَعْضِ الْكِتَابِ وَتَكْفُرُونَ بِبَعْضٍ فَمَا جَزَاءُ مَنْ يَفْعَلُ ذَلِكَ مِنْكُمْ إِلَّا خِزْيٌ فِي الْحَيَاةِ الدُّنْيَا وَيَوْمَ الْقِيَامَةِ يُرَدُّونَ إِلَى أَشَدِّ الْعَذَابِ وَمَا اللَّهُ بِغَافِلٍ عَمَّا تَعْمَلُونَ

***"...A besoni në një pjesë të librit, e tjetrën e mohoni?! Ç'mund të jetë ndëshkimi ndaj atij mes jush që punon ashtu përveçse posh tërim në këtë jetë, e në Ditën e Gjykimit ata hidhen në dënimin më të ashpër. Allahu nuk është i pakujdesshëm ndaj asaj që veproni."*** *(Bekare: 85).*

Madje, disa njerëz devijojnë duke thënë se edhe të tjerët janë besimtarë. Sidomos kur flasin për hebrenjtë dhe të krishterët, duke arsyetuar se edhe ata i besojnë pejgamberët siç i besojnë myslimanët, si Musain, a.s. (Moisiun) apo Isain, a.s. (Jezusin)! Mirëpo, duhet ditur se besimi i tyre nuk është i kompletuar edhe ndaj pejgamberëve të tjerë të Allahut, xh.sh., sepse ata i besojnë disa pejgamberë, e disa jo. Çifutët i besojnë pejgamberët deri te Musai, a.s., ndërsa nuk e besojnë Isain, a.s., e as Muhamedin a.s., si pejgamberë të Zotit, xh.sh., ndërsa të krishterët i besojnë pejgamberët deri tek Isai, a.s., ndërkaq e mohojnë pejgamberin e fundit, Muhamedin, a.s. Pra, dëshirojnë të bëjnë dalli me ndërmjet pejgamberëve, duke i besuar disa, dhe duke i mohuar disa të tjerë. Dhe kështu besimi i tyre i pjesshëm rezulton jo i plotë, përkatësisht mbeten jobesimtarë. Allahu, xh.sh., këtyre dhe të ngja shmëve u thotë:

إِنَّ الَّذِينَ يَكْفُرُونَ بِاللَّهِ وَرُسُلِهِ وَيُرِيدُونَ أَنْ يُفَرِّقُوا بَيْنَ اللَّهِ وَرُسُلِهِ
وَيَقُولُونَ نُؤْمِنُ بِبَعْضٍ وَنَكْفُرُ بِبَعْضٍ وَيُرِيدُونَ أَنْ يَتَّخِذُوا بَيْنَ
ذَلِكَ سَبِيلًا (١٥٠) أُولَئِكَ هُمُ الْكَافِرُونَ حَقًّا وَأَعْتَدْنَا لِلْكَافِرِينَ
عَذَابًا مُهِينًا (١٥١)

***"S'ka dyshim se ata që nuk e besojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij dëshirojnë të bëjnë dallim mes Allahut dhe të dërguarve të Tij, dhe thonë: "Ne i besojmë disa, e nuk i besojmë disa të tje rë." E mes këtij duam të marrin një rrugë. Të tillët janë jobesim tarë të vërtetë, e Ne kemi përgatitur dënim të fortë e nënçmues për jobesimtarët."*** *(Nisa: 150-151).*

Mosbesimi i njërit prej pejgamberëve të Allahut që është përmendur në Kuran, për besimtarin mysliman konsiderohet gabim, pra, ai bëhet jobesimtar, siç edhe u pa nga ajeti i lartpërmendur.

Kurani, si libri i fundit i shpallur prej Allahut, xh.sh., na lajmëroi edhe për shumë gjëra të zbritura në librat e mëparshëm, të cilat ose i larguan, ose i zëvendësuan me mendime e propozime prej tyre. Kështu vjen deri te përzierja e shprehjes hyjnore me mendimet e njerëzve të ndryshëm dhe librat e mëparshëm, siç na lajmëron Kurani, dhe e hu mbin origjinalitetin e zbritjes. Prandaj edhe sot ato shpallje që gjenden te besimtarët e besimeve të tjera, te pasuesit e librave, pavarësisht se cilës fe i takojnë, nuk mund të besohen prej myslimanëve si libra të shenjtë, ngase njerëzit kanë futur mendimet e tyre brenda atyre libra ve, e kanë devijuar fjalën e Allahut, xh.sh., dhe çfarë nuk u ka pëlqyer ata e kanë larguar nga libri, duke mos e ruajtur në formën origjinale të zbritjes.

Nëse pyetemi për librat e shenjtë, duhet të përgjigjemi në këtë mënyrë: Myslimani beson në librat dhe fletushkat e shpallura dhe të zbritura prej Allahut, xh.sh., pa kurrfarë dallimi në mes tyre. Pra, mys limani beson në librat që kanë zbritur, e jo në librat që sot konsiderohen të shenjtë (zbritur) dhe që gjenden në duart e të krishterëve dhe në duart e çifutëve, e që sipas tyre konsiderohen se janë ruajtur. Besimi në librat e shenjtë është një nga kushtet e besimit në fenë islame. Allahu, xh.sh., thotë:

يَا أَهْلَ الْكِتَابِ قَدْ جَاءَكُمْ رَسُولُنَا يُبَيِّنُ لَكُمْ كَثِيرًا مِمَّا كُنْتُمْ تُخْفُونَ
مِنَ الْكِتَابِ وَيَعْفُو عَنْ كَثِيرٍ قَدْ جَاءَكُمْ مِنَ اللَّهِ نُورٌ وَكِتَابٌ مُبِينٌ

***“O ithtarë të librit, te ju erdhi i dërguari Ynë, që jua sqaron shumë nga ato që fshihni nga libri, e për shumë nuk ju jep sqa rime. Te ju erdhi dritë dhe libër i qartë prej Allahut.”*** *(Maide: 15)*

Pra, Allahu, xh.sh., sikur thotë: O ju ithtarë të librave të mëparshëm, ju ithtarë të Tevratit e të Inxhilit, hebrenj e të krishterë, te ju ka ardhur i Dërguari Ynë i fundit, Muhamedi, a.s., i cili jua shpjegon shumë nga ato që i keni fshehur e devijuar nga librat e mëhershëm e të shpallur prej Allahu, xh.sh.! Te ju, prej Allahut, xh.sh., erdhi drita, e ajo dritë është Kurani, është Islami, është Muhamedi, a.s., që para jush e ndriçojnë rrugën e drejtë e të vërtetë, rrugën e udhëzimit e të ardhmërisë së sigurt. Prandaj, besoni në atë që porosit Allahu, xh.sh., dhe largohuni nga besimet e kota, ngase besimi apo mohimi i pjesshëm në Islam, i fjalës së Zotit, xh.sh., konsiderohet mosbesim!

## Përmbledhje

Mundësia e njeriut që i vetëm ta gjejë të vërtetën e të drejtën, si në besim ashtu edhe në adhurim, pa ndihmën e shpalljes, nuk është reale, për shkak të kufizimeve në kapacitetin intelektual që posedon njeriu.

Për të ardhur deri tek e vërteta, Zoti, xh.sh., e ndihmoi njeriun me pejgamberë dhe me shpallje, pejgamberë të cilët u dërguan te të gjithë popujt, për të dhënë mesazhe dhe porosi të qarta.

Mohimi shpeshherë është rezultat i arrogancës, i kryeneçësisë, i inatit dhe i refuzimit të fakteve e të dëshmive.

Mohim konsiderohet edhe besimi i pjesshëm. Kjo sepse patjetër duhet besuar tërësisht, se ndryshe besimi nuk vlen.

**Sabri BAJGORA**

# BANORËT E ZJARRIT DHE BANORËT E XHENETIT (Komentim i ajeteve 71-75 të sures Ez Zumer)[*]

وَسِيقَ ٱلَّذِينَ كَفَرُوٓاْ إِلَىٰ جَهَنَّمَ زُمَرًاۖ حَتَّىٰٓ إِذَا جَآءُوهَا فُتِحَتۡ أَبۡوَٰبُهَا
وَقَالَ لَهُمۡ خَزَنَتُهَآ أَلَمۡ يَأۡتِكُمۡ رُسُلٞ مِّنكُمۡ يَتۡلُونَ عَلَيۡكُمۡ ءَايَٰتِ رَبِّكُمۡ
وَيُنذِرُونَكُمۡ لِقَآءَ يَوۡمِكُمۡ هَٰذَاۚ قَالُواْ بَلَىٰ وَلَٰكِنۡ حَقَّتۡ كَلِمَةُ ٱلۡعَذَابِ عَلَى
ٱلۡكَٰفِرِينَ ﴿٧١﴾ قِيلَ ٱدۡخُلُوٓاْ أَبۡوَٰبَ جَهَنَّمَ خَٰلِدِينَ فِيهَاۖ فَبِئۡسَ مَثۡوَى
ٱلۡمُتَكَبِّرِينَ ﴿٧٢﴾ وَسِيقَ ٱلَّذِينَ ٱتَّقَوۡاْ رَبَّهُمۡ إِلَى ٱلۡجَنَّةِ زُمَرًاۖ حَتَّىٰٓ إِذَا
جَآءُوهَا وَفُتِحَتۡ أَبۡوَٰبُهَا وَقَالَ لَهُمۡ خَزَنَتُهَا سَلَٰمٌ عَلَيۡكُمۡ طِبۡتُمۡ
فَٱدۡخُلُوهَا خَٰلِدِينَ ﴿٧٣﴾ وَقَالُواْ ٱلۡحَمۡدُ لِلَّهِ ٱلَّذِي صَدَقَنَا وَعۡدَهُۥ
وَأَوۡرَثَنَا ٱلۡأَرۡضَ نَتَبَوَّأُ مِنَ ٱلۡجَنَّةِ حَيۡثُ نَشَآءُۖ فَنِعۡمَ أَجۡرُ
ٱلۡعَٰمِلِينَ ﴿٧٤﴾

**“E ata që nuk besuan,** (forcërisht) **do të shtyhen, grupe-grupe, drejt Xhehenemit dhe, kur të mbërrijnë aty, dyert e tij hapen dhe, rojat e tij do t’u thonë: “A nuk ju erdhën juve të dërguar nga mesi juaj, që t’ju lexonin shpalljet e Zotit tuaj, e t’ju tërhiqnin vërejtjen për ballafaqimin tuaj me këtë di-**

[*] Shkëputje nga komentimi ynë në dorëshkrim i sures *“Ez Zumer”*. (S.B.).

**të?" Po,** (patën ardhur), **thonë ata, por vendimi për dënimin e jobesimtarëve tashmë është bërë realitet! U thuhet: "Hyni në dyert e Xhehenemit, aty do të jeni përgjithmonë." Eh, sa vendbanim i shëmtuar që është ai për kryeneçët** (arrogantët)!" **Kurse ata që ishin të devotshëm ndaj Zotit të tyre,** (me nderime) **do të sillen te Xheneti, grupe-grupe, e kur mbërrijnë aty, dyert e tij i gjejnë të hapura dhe rojat e tij u thonë: "Selamun alejkum" - "Paqja qoftë mbi ju". Ju keni qenë** (njerëz) **të mirë, andaj hyni në të. Aty do të jeni përgjithmonë. Ata** (të Xhenetit) **thonë: "Falënderuar qoftë Allahu, që e përmbushi premtimin e Vet për ne, dhe na bëri trashëgimtarë të tokës së Xhenetit, që në të, të vendosemi aty ku të duam!" Sa i mrekullueshëm është shpërblimi i atyre që bënë punë të mira. E do t'i shohësh engjëjt të tubuar rreth Arshit, duke e madhëruar me falënderim Zotin e tyre. Mes tyre** (robërve) **do të gjykohet me drejtësi dhe do të thuhet** (nga të gjithë): **"Falënderimi qoftë për Allahun, Zotin e botëve!" -** (Ez Zumer, 71-75).

***

## Lidhja e këtyre ajeteve me ato paraprake

Meqë në ajetet paraprake, i Madhërishmi na e bën të ditur se në Ditën e Gjykimit, Nuri i Allahut do të ndriçojë në Tokën, në të cilën do të peshohen veprat e njerëzve, në atë Ditë, Drejtësia e Allahut është absolute, dhe secili do ta marrë atë që e ka merituar, në bazë të veprave të tij në këtë botë. Së pari do të merren në llogari të dërguarit e Allahut, të cilët ishin bartës të mesazhit hyjnor nëpër mote dhe shekuj, e pastaj dë-

shmorët-shehidët, që ranë për lartësimin e Fjalës së Allahut. Këto dy grupe, në fakt nuk do të merren në llogari sikurse pjesa tjetër e njerëzimit, sepse Xheneti për ta është premtuar nga Allahu i Lartmadhërishëm qysh në këtë botë, dhe tash vetëm se do t'u komunikohet verdikti i Allahut për vendqëndrimin e tyre në xhenetet më të larta.

Pra, secili prej këtyre grupeve të lartpërmendura do ta marrë shpërblimin dhe vendin meritor në Xhenet, e pastaj do të fillojë gjykimi i pjesës tjetër të njerëzimit. Ata që besuan dhe e shfaqën këtë besim në zemra dhe në vepra, i pret Xheneti dhe kënaqësia e pafund, e të cilët do të jenë në shoqëri të të dërguarve të tyre dhe engjëjve deri te dyert e Xhenetit, kurse ata që e mohuan, përgënjeshtruan dhe bënë padrejtësi mbi këtë Tokë, ata do ta meritojnë ndëshkimin në zjarrin e Xhehenemit, tek i cili do të tërhiqen zvarrë nga engjëjt e ndëshkimit.

Pikërisht për këto dy gjendje të njerëzve pas përfundimit të marrjes së tyre në pyetje, në Ditën e Gjykimit, flasin edhe ajete në vazhdim, të cilat do të jenë në fokus të komentimit.

## Xhehenemi - vendbanimi i mohuesve, i tiranëve dhe i njerëzve të ligj

*Koment:*

**71. E ata që nuk besuan do të shtyhen** (forcërisht) **grupe-grupe, drejt Xhehenemit, dhe, kur të mbërrijnë atje, dyert e tij hapen dhe, rojat e tij do t'u thonë: "A nuk ju erdhën juve të dërguar nga mesi juaj që t'ju lexonin shpalljet e Zotit tuaj, e t'ju tërhiqnin vërejtjen për ballafaqimin tuaj me këtë**

**ditë?" Po,** (patën ardhur), **thonë ata, por vendimi për dënimin e jobesimtarëve tashmë është bërë realitet!**

Pas përfundimit të llogarisë, ku ashtu siç thamë, Drejtësia e Allahut është absolute, ata që nuk besuan dhe mohuan me ngulm besimin në Allahun Një, ata që nuk e besuan këtë Ditë të Gjykimit pas ringjalljes, tashmë fati i tyre është vulosur përjetësisht. Për ta nuk ka më asnjë shpresë, pavarësisht klithmave dhe çirrjeve të tyre që i Madhërishmi t'i kthente edhe njëherë në jetën e kësaj bote që të besonin dhe të bënin vepra të mira. Sa e sa njerëz që bënë padrejtësi mbi këtë Tokë, që vranë dhe bënë krime, përgënjeshtruan të dërguarit, u tallën me fenë e Allahut që Ai e zgjodhi si fe të vetme për njerëzimin, dhe ngarendën pas feve të rreme e të shpikura, do të qëndrojnë në këtë Ditë me koka të ulura dhe të turpëruar para krejt njerëzimit.

Fjala *"sika"* në kontekst të këtij ajeti nënkupton tërheqjen zvarrë dhe forcërisht të banorëve të Xhehenemit, të lidhur me vargoj dhe me pranga të zjarrit, deri te vendbanimi i tyre i përjetshëm në skëterrat e Xhehenemit. Kurse fjala *"zumera"* ka kuptimin: grupe-grupe apo në turma, që do të thotë se xhehenemlitë do të sillen aty të përbuzur dhe të nënçmuar; idhujtarët me të ngjashmit me ta, tiranët dhe mohuesit me të ngjashmit me ta etj..

Sapo të kenë arritur te dyert e Xhehenemit, dyert e tij do të hapen menjëherë para tyre, sikur Xhehenemit nuk i pritet t'i gllabërojë këtë njerëz të prishur e t'i përpijë me flakët e tij përcëlluese, për t'i ndëshkuar. Kjo është një prej pamjeve më të shëmtuara të gjendjes së mohuesve të Njëshmërisë, duke u sjellë zvarrë për t'u hedhur në greminat e Xhehenemit. Rojat

e ashpra të Xhehenemit, do t'i pyesin këta njerëz të prishur: vallë, a nuk ju erdhën juve të dërguar nga Zoti Juaj, që t'ju lexonin Shpalljet hyjnore dhe t'ju tërhiqnin vërejtjen për takimin dhe ballafaqimin tuaj me këtë ditë të tmerrshme?! Kjo është pyetje qortuese, që nxjerr në pah faktin se ata nuk mohuan nga padija, por nga arroganca dhe neglizhenca me vetëdije të plotë. Ata, të turpëruar, do të përgjigjen: Po, është e vërtetë se na erdhën të dërguar nga Zoti, por ne i përgënjeshtruam dhe zgjodhëm kënaqësitë e përkohshme të dynjasë, duke harruar se një ditë do të dalim para Krijuesit.

Vetëm tash e kuptojnë se shejtani i mallkuar u kishte vënë perde para syve që të mos e shihnin të vërtetën, prandaj e pasuan atë të mallkuar, duke e humbur përjetësisht Ahiretin. Tash e pranojnë botërisht fajësinë, se kishin qenë në lajthitje dhe humbje të qartë, por është tepër vonë për pendim, sepse perdja e kësaj dynjaje ka rënë dhe ata gjenden në një botë dhe në një dimension krejtësisht tjetër, atë të botës së përhershme të Ahiretit. Fjalët e tyre të fundit, siç i përshkruan ajeti kuranor, janë pranim i fajësisë, duke qenë të vetëdijshëm se vendimi i Allahut për ndëshkimin e tyre, tashmë me plot të drejtë, do bëhet realitet dhe do të zbatohet.

Në lidhje me këtë pamje, se si banorët e Xhehenemit do të sillen para dyerve të skëterrës, flasin edhe shumë ajete të tjera kuranore të shpërndara nëpër sure të ndryshme, e ne këtu, sa për ilustrim, do t'i sjellim vetëm disa të tilla:

***"Ditën kur me rrëmbim shtyhen në zjarrin e Xhehenemit."*** - *(Et Tur, 13);*

***"Në Ditën e Kiametit, Ne i tubojmë ata duke i tërhequr rrëshqanas me fytyra përdhe, të verbër, memecë dhe të shurdhët. Vendi ti tyre është Xhehenemi, dhe sa herë***

***që të pushojë flaka Ne u shtojmë atyre flakën e zjarrit.”*** - *(El Isra’ë, 97);*

***“Kur*** *(mohuesve)* ***t’u vihen vargoj në qafë dhe të sillen me zinxhirë, në ujë të valë e pastaj të digjen në zjarr.”*** - *(Gafir, 71-72);* dhe

***“Sa herë që hidhet në të ndonjë turmë, roja i pyet: “A nuk ju pati ardhur juve ndonjë pejgamber*** *(qortues)?* ***Ata thonë: Po, na erdhi pejgamberi, por ne e përgënjeshtruam dhe ne u thamë: Allahu nuk shpalli asgjë, e ju nuk jeni tjetër vetëm së në një humbje të madhe! Dhe thonë: Sikur të kishim dëgjuar dhe pasur mend, ne nuk do të ishim ndër banuesit e zjarrit. Pra, i pranojnë mëkatet e veta; banuesit e zjarrit qofshin larg mëshirës”*** *(El Mulk, 6-11).*

**72. U thuhet: “Hyni në dyert e Xhehenemit, aty do të jeni përgjithmonë. Eh, sa vendbanim i shëmtuar që është ai për kryeneçët (arrogantët)!**

Pas pranimit të fajësisë së tyre, banorëve të Xhehenemit do t’u hapen portat e ferrit, nëpër të cilat do të hyjnë për të përjetuar ndëshkim pas ndëshkimi, për paudhësitë dhe ligësitë e tyre. Për ta, nuk ka më shpresë, sepse në Xhehenem, do të jenë vetëm ata që e mohuan Allahun, që i përgënjeshtruan të dërguarit e Tij, që e mohuan ringjalljen dhe Ditën e Gjykimit. Ata kurrë më nuk do t’i përfshijë mëshira e Allahut dhe Allahu nuk i shikon më ata me Syrin e mëshirës së Tij. Ata do të dergjen dhe do të digjen në flakërimat e zjarrit, duke përjetuar ndëshkime të rënda nga të cilat do të dëshironin të vdisnin njëherë e përgjithmonë, por jo... Më nuk ka vdekje,

por vetëm përjetim të ndëshkimeve me të gjitha shqisat dhe gjymtyrët e tyre.

## Xheneti - vendbanimi i njerëzve të mirë dhe të devotshëm

**73. "Kurse ata që ishin të devotshëm ndaj Zotit të tyre, (me nderime) do të sillen te Xheneti grupe-grupe, e kur arrijnë aty, dyert e tij i gjejnë të hapura dhe rojat e tij u thonë: "Selamun alejkum" - "Paqja qoftë mbi ju", Ju keni qenë** (njerëz) **të mirë, andaj hyni në të. Aty do të jeni përgjithmonë!"**

Tash jemi në një pamje krejtësisht tjetër nga ajo e banorëve të Skëterrës. Jemi në shoqëri të banorëve të Xhenetit, të cilët, të rrethuar nga engjëjt e mëshirës, me nderimet më të larta do të sillen deri te dyert e Xhenetit, parajsës së premtuar për besimtarët, të devotshmit, të ruajturit nga mëkatet, të sinqertët në besim, të ndershmit, dijetarët, dëshmorët dhe pejgamberët që Allahu i dërgoi mëshirë dhe udhëzim për popujt e ndryshëm në këtë Tokë.

Të njëjtat fjalë, të njëjtat shprehje për sjelljen e besimtarëve grupe-grupe te dyert e Xhenetit: *"sika"* dhe *"zumera",* janë përdorur edhe në këtë ajet, por tashmë në konotacion krejtësisht tjetër. Këta do të jenë njerëzit më fatlumë, të cilët do të shkrihen në kënaqësinë e pamjeve madhështore teksa ecin të respektuar, me dinjitetin e besimtarëve të papërkulur nga sfidat dhe joshjet e kësaj bote. Këta do të jenë të rrethuar nga engjëjt e Xhenetit, e para tyre shohin vetëm dritë dhe vezullima që të mahnitin dhe ta lumturojnë tërë qenien. Dhe,

kur të kenë arritur te dyert e Xhenetit, do t'i gjejnë ato të hapura, sepse Xheneti është përmalluar për banorët e tij, që sa më shpejtë të hyjnë në të e t'i shijojnë kënaqësitë e të Madhit Zot. Aty i pret i Dërguari më madhështor, i cili u dërgua mëshirë për krejt botët, Muhamedi a.s., të cilit në shenjë nderimi i janë hapur të gjitha dyert e Xhenetit, tetë sosh, që ta fusë nëpër to ymetin e tij të dashur.

Nga hadithet e të Dërguarit të Allahut, mësojmë se njeriut të parë të cilit do t'i lejohet ndërmjetësimi-shefati në Ditën e Gjykimit, do të jetë i Dërguari ynë, Muhamedi a.s., i cili po ashtu do të jetë i pari të cilit do t'i hapen dyert e Xhenetit, për ta futur në të ymetin e tij, e pas nesh, do të hyjnë në të ymetet e pejgamberëve të tjerë, që i besuan Allahut dhe Ditës së Gjykimit.

Rojat (engjëjt) e Xhenetit, i presin ata me mirëseardhje dhe me fjalët e paqes dhe të dashurisë ***"Selamun alejkum"*** - ***"Paqja qoftë mbi ju", Ju keni qenë*** *(njerëz) të* ***mirë, andaj hyni në të. Aty do të jeni përgjithmonë"***, që nënkupton se ata tash janë me një krijim krejtësisht tjetër fizik. Më nuk do të vdesin, as nuk do të sëmuren, dhe as nuk do të ndiejnë as dhimbje, por tash e tutje, përjetësisht, do t'i shijojnë kënaqësitë dhe shpërblimet e Allahut të Gjithëmëshirshëm. Vetë shprehja ***"Selamun alejkum"*** shpreh më së miri ndjesinë e paqes së tyre shpirtërore dhe fizike si banorë të Xhenetit, qysh në hyrje të tij. Engjëjt do t'i përgëzojnë me fjalët më të bukura se ju ishit vepërmirë, fjalëmirë dhe prej atyre që nuk e përlyen për asnjë çast, besimin e pastër në Zotin, me shiblat e shirkut dhe të hipokrizisë, andaj hyni në këtë Xhenet të premtuar nga i Madhërishmi, si shpërblim për durimin dhe mirësitë tuaja në jetën e dynjasë. Në të do të jeni përjetësisht

dhe amshueshëm. Një përgëzim i tillë nga engjëjt u pati ardhur këtyre fatlumëve, edhe në çastet e vdekjes së tyre, kur i Madhërishmi thotë: ***"S'ka dyshim se atyre që thonë: "Zoti ynë është Allahu", dhe pastaj qëndrojnë të palëkundur në këtë, do t'u zbresin engjëjt*** *(në prag të vdekjes e do t'u thonë):* ***"Mos u frikësoni, e as mos u pikëlloni, por gëzojuni Xhenetit që ju është premtuar. Ne jemi miqtë*** *(mbrojtësit)* ***tuaj, si në jetën e kësaj bote, ashtu edhe në botën tjetër, Atje do të keni çfarë t'ju dëshirojnë shpirtrat*** *(zemrat)* ***dhe gjithçka që kërkoni. Kjo është dhuratë nga Ai që është Falës dhe Mëshirëplotë!"*** - *(Fussilet, 30-32).*

**74. Ata** (të Xhenetit) **thonë: "Falënderuar qoftë Allahu, që e përmbushi premtimin e Vet për ne, dhe na bëri trashëgimtarë të tokës së Xhenetit, që të vendosemi në të, aty ku të duam! Sa i mrekullueshëm është shpërblimi i atyre që bënë punë të mira".**

Pas këtij përgëzimi, për përjetësi në Xhenet, banorët e Xhenetit, të lumtur dhe të mbushur plot gëzim, do ta lavdërojnë dhe falënderojnë Allahun Fuqiplotë, i Cili e mbajti premtimin e Vet ndaj tyre, duke i bërë trashëgimtarë të tokës së Xhenetit, për të shijuar kënaqësi pas kënaqësie, në çdo cep të tij, kënaqësi të cilat kurrë as nuk i kishin imagjinuar ndonjëherë në jetën e kësaj bote, sepse Xheneti është një dimension krejtësisht tjetër nga ai i jetës në këtë dynja. Begatitë e Xhenetit nuk shterojnë kurrë, sepse shpërblimi nga i Madhërishmi është i përjetshëm. I Madhërishmi në një hadith kudsij, të cilin e përcjell i Dërguari a.s. nga Zoti Fuqiplotë ka thënë: *"Kam përgatitur për robërit e mi të mirë, gjëra që syri kurrë*

*nuk i ka parë, veshi kurrë nuk i ka dëgjuar dhe gjëra që as në mendje nuk i ka vajtur kujt.”*

Përjetimi i kënaqësive dhe begative të Xhenetit është përmbushja e premtimit nga ana e Mëshirëplotit, të Cilit besimtarët në këtë botë, vazhdimisht i qenë lutur me fjalët: ***“O Zoti Ynë! Na e jep shpërblimin që na ke premtuar nëpërmjet të dërguarve Tu dhe mos na poshtëro në Ditën e Kiametit! Se Ti, me të vërtetë, nuk e shkel premtimin e dhënë!”*** *- (Ali Imran, 194).*

Besimtarët, vetëm tash do t’i shijojnë frytet e punëve të tyre të mira në këtë botë. Vuajtjet dhe sakrificat e tyre, që i shoqëruan në shtegtimin e tyre në këtë botë, tashmë po shpaguhen, sepse më nuk ka dhimbje, nuk ka ndarje, nuk ka lot e as vuajtje, por vetëm shkrirje në begatitë e paimagjinueshme të Xhenetit. Pallatet e tyre të stolisura me ar, argjend dhe me gurë të tjerë të çmuar, kopshtet përrallore dhe lumenjtë që rrjedhin poshtë tyre, tashmë janë prona të tyre, si dhuratë dhe shpërblim nga Krijuesi i Gjithëmëshirshëm, sepse imani, zemrat dhe veprat e tyre në dynja ishin vetëm për hir të Allahut.

**75. E do t’i shohësh engjëjt të tubuar rreth Arshit, duke e madhëruar me falënderim Zotin e tyre. Mes tyre** (robërve) **do të gjykohet me drejtësi dhe** (nga të gjithë) **do të thuhet: “Falënderimi qoftë për Allahun, Zotin e botëve!”**

Ajeti përmbyllës i sures *Ez Zumer*, flet për pamjet madhështore të Xhenetit, në të cilin përshkrim spikasin engjëjt fisnikë, të cilët do ta rrethojnë Arshin e të Madhërishmit me tesbih, madhërim dhe falënderim ndaj Tij, e këtyre madhëri-

meve, lavdërimeve dhe falënderimeve do t'u bashkëngjiten edhe banorët e Xhenetit, të cilët pas përfundimit të llogarisë së tyre, dhe pasi të kenë hyrë në Xhenet, nga lumturia që do ta ndjejnë, do të thonë njëzëri: **"Falënderimi qoftë për Allahun, Zotin e botëve!**, i Cili përmbushi premtimin e Vet dhe ma dhuroi begatitë dhe mirësitë e amshueshme të Xhenetit.

**Porositë e këtyre ajeteve:**

- *Dita e Gjykimit është e sigurt, dhe njerëzit në këtë Ditë do të ndahen në dy grupe: mohuesit, idhujtarët dhe të ngjashmit me ta, të cilët do të jenë banorë të Xhehenemit, kurse besimtarët dhe vepërmirët do të jenë banorë të Xhenetit.*
- *Jobesimtarët, tiranët dhe mohuesit, do të tërhiqen zvarrë drejt Xhehenemit, të përbuzur dhe të nënçmuar, të lidhur këmbë e duar me vargoj të zjarrit, dhe pastaj do të hidhen në Zjarr, në të cilin do të përjetojnë dënim pas dënimi, pafundësisht.*
- *Mendjemadhësia, arroganca dhe refuzimi i së vërtetës çojnë në humbje të pashmangshme dhe në shkatërrim të përhershëm.*
- *Në anën tjetër, besimtarët e sinqertë të Njëshmërisë, do të përcillen grupe-grupe deri te Xheneti, e tetë dyert e Xhenetit do t'i gjejnë të hapura, për t'i mirëpritur të gjithë ata vepërmirë, me zemra të pastra, si shpërblim nga ana e Mëshirëplotit.*
- *Përshëndetja e parë e engjëjve ndaj banorëve të Xhenetit do të jetë fjala "Selamun alejkum", për t'ua bërë të ditur këtyre zemërbardhëve, se tashmë jeni të shpëtuar*

*nga çdo mangësi, sëmundje a vuajtje, sepse tash nuk ka më as vdekje, por përjetësi e pafundme në Xhenet, si dhuratë nga Zoti Bujar e Mëshirëplotë.*

- *Frika nga Zoti (devotshmëria) dhe veprat e mira janë çelësi për shpëtimin e përjetshëm.*
- *Besimtarët e vërtetë e falënderojnë Zotin - Krijuesin e tyre për çdo mirësi e sukses, e kurrsesi veten, sepse pa ndihmën e Allahut, nuk mund të arrihet asgjë.*

**Dr. Ajni SINANI**

# KARAKTERISTIKAT KRYESORE TË SË DREJTËS ISLAME

E drejta islame filloi me hazreti Ademin a.s., ndërsa me hazreti Muhamedin a.s. u përmbyll dhe u dha në një formë gjithëpërfshirëse, të plotë dhe të përkryer. Në kohën ndërmjet h. Ademit a.s. dhe h. Muhamedit a.s. pati ndryshime të caktuara në këtë të drejtë, mirëpo parimet dhe vlerat themelore dhe bazike mbeten të pandryshuara.

Islami është mënyrë komplete e jetës. Ai urdhëron jo vetëm besimin, por edhe rregullat shoqërore të sjelljes. Krahas kësaj, ai kujdeset për praktikimin dhe funksionin e ligjit të vet.[1]

Njeriu është njësi e trupit dhe e shpirtit. Zhvillimi jo i barabartë i këtyre dy elementeve çon drejt çrregullimit të ekuilibrit, pasojat e të cilit mund të jenë katastrofale për qytetërimin. E drejta islame vuri theksin në korrektivitetin e të drejtave dhe të obligimeve, jo vetëm në marrëdhëniet ndërmjet njerëzve, por edhe në marrëdhëniet e njeriut me Krijuesin e tij. Kur flitet ekskluzivisht për "të drejtat e njeriut", duhen theksuar njëkohësisht edhe detyrat dhe obligimet e tij,

[1] Dr. Muhamed Hamidullah, *Hyrje në Islam*, Tiranë 1993, f. 109.

përndryshe ai mund të shndërrohet në një egërsi, ose në një ujk.[2]

Qëllimi i ligjit islam është sendërtimi i dobisë njerëzore dhe ruajtja e interesave të përgjithshme të tyre. Sipas dijetarit Muhamed et Tahir b. Ashuri, “objektivat e ligjit islam janë kuptimet dhe synimet e urta nga ana e Ligjvënësit, që mund të dallohen në shumicën e situatave në të cilat ligji vihet në zbatim, apo në të tëra ato, të tilla që nuk mund të shihen apo të zbatohen ekskluzivisht për një lloj të veçantë dispozite...”[3]

Dr. Ahmed er Rejsuni përfundon se objektivat e përgjithshme të ligjit islam të përmendura nga Ibën Ashuri janë: ruajtja e rendit, arritja e dobisë dhe parandalimi i dëmit apo i prishjes, vendosja e barazisë ndërmjet njerëzve, duke e bërë ligjin të jetë i nderuar, i zbatuar dhe i efektshëm, dhe duke i dhënë mundësi ymetit të bëhet i fuqishëm, i respektuar dhe me vetëbesim.[4]

Kurse autori Alal el Fasi, pas vështrimit të një numri ajetesh kuranore, që vënë në dukje objektivat e ligjit hyjnor, ka thënë: “Këto ajete e bëjnë plotësisht të qartë në tërësinë e tyre se, qëllimi për të cilin u dërguan pejgamberët, dhe për të cilin u shpallën ligjet hyjnore, është t’i drejtojë krijesat njerëzore në atë që do të sigurojë mirëqenien dhe virtytshmërinë e tyre dhe t’ua mundësojë atyre t’i përmbushin përgjegjësitë që u janë përcaktuar.”[5]

---

[2] Po aty, f. 140.

[3] Ahmed er Rejsuni, “*Objektivat e ligjit islam, teoria e imam Shatibiut mbi Sheriatin*”, Logos-A, Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2015, f. 26.

[4] Po aty, f. 26.

[5] Po aty, f. 28.

Karakteristikat themelore të së drejtës së Sheriatit janë: **shenjtëria** (sakraliteti), **përsosmëria dhe universaliteti.**

**Shenjtëria** (sakraliteti) e së drejtës sheriatike pasqyrohet në burimet e saj dhe në sanksionimin e saj. E drejta sheriatike ka origjinë hyjnore, ngaqë Zoti i ka dhënë në Kuran parimet bazë mbi të cilat do të ndërtohet shoqëria e re, më e mirë dhe më e moralshme. Ai e ka garantuar këtë rend juridik me sanksionim të dyfishtë: dënimin në këtë botë dhe dënimin në botën e ardhshme. Nga kjo arrihet deri në përfundimin se në Islam, në mes fesë dhe së drejtës, ka një ligjshmëri të ngushtë.[6]

**Përsosmëria** e së drejtës sheriatike buron nga origjina e saj hyjnore. Në këtë sistem juridik mund të gjenden dhe të nxirren zgjidhje për të gjitha mosmarrëveshjet që ndodhin në shoqëri. Gjykatësit janë të detyruar ta gjykojnë çdo mosmarrëveshje që iu sillet për zgjidhje.[7]

**Universaliteti** i së drejtës sheriatike buron nga fakti se mësimi islam nuk kufizohet në popuj të veçantë dhe në kohë të caktuar, porse është shpallur dhe ka të bëjë me mbarë njerëzimin dhe për të gjitha kohët. Zbatimi i kësaj të drejte nuk mund të kufizohet as sipas kohës, as sipas vendit dhe as sipas lëndës. E drejta islame, si e drejtë fetare, mund të zbatohet vetëm për myslimanët, ajo nuk mund të ndryshojë dhe nuk i nënshtrohet evolucionit.[8]

---

[6] Dr. Mehmed Begoviq, "*E drejta martesore sheriatike, me një ndërhyrje të shkurtër në studimin e së drejtës sheriatike*", Alsar, Tiranë, 2020, f. 30.

[7] Po aty, f. 30.

[8] Po aty, f. 31.

# Dallimi ndërmjet të drejtës islame dhe të drejtës njerëzore

E drejta islame bazohet në shpalljen e Zotit, kurse të drejtat njerëzore janë të rrënjosura në jetën dhe vetëdijen njerëzore. Juristi mysliman, Mevlana Emin Ahsan Islahi, i rendit ndryshimet ndërmjet këtyre dy të drejtave.[9]

E para, sipas së cilës dallohet Sheriati nga të gjitha ligjet njerëzore, është se ai është hyjnor. Kur e themi këtë, atëherë ne kuptojmë dy gjëra: *origjinën hyjnore* dhe *qëllimin hyjnor* të tij.

**Prejardhjen hyjnore** e kuptojmë duke pasur parasysh se dispozitat dhe parimet e Sheriatit nuk janë rezultate njerëzore, që u nënshtrohen mangësisë dhe pafuqisë; faktorëve ndikues të kohës dhe të mjedisit; situatës dhe kulturës, pastaj ndikimeve të trashëgimisë, të temperamentit, të pasionit dhe të ndjeshmërisë. Përkundrazi, Ligjvënës në këtë rast është Ai që krijon, Ai të Cilit i nënshtrohet çdo gjë në univers. Është Ai që i krijoi njerëzit dhe e di saktësisht se ç'është më e dobishme dhe parësore për ta, se çfarë është me vlerë për ta dhe se çfarë u bënë mirë atyre:[10] ***"Po si nuk e di Ai që ka krijuar, kur dihet se Ai depërton në thellësi të sekreteve dhe i njeh hollësitë?!"*** *(El Mulk, 14).*

**Qëllimi hyjnor** i të gjitha këtyre normave ligjore është sendërtimi i mirësisë në jetën njerëzore. Dispozitat e këtij

[9] Shih: *Šerijat, bilješke uz jedno novo djelo o islamskom pravu*, Fikret Karčić, Islamska misao, viti V, nr. 54, Juni, 1983, Sarajevë, f. 49.

[10] Shih: Jusuf el Kardavi, "Sheriati islam, aktualiteti gjithëkohor dhe gjithëhapësinor i tij", Logos-A, Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2013, f. 26.

ligji hyjnor janë rrënjosur në zemrat e myslimanëve dhe sekreti se pse ata e respektojnë këtë ligj, se pse veprojnë sipas tij dhe i nënshtrohen atij, është se ato janë dispozita të Zotit:[11] ***"... E kush gjykon më mirë se Allahu për një popull që bindshëm beson?!"*** *(El Maide, 50).*

1. Statusi ligjor i të drejtës njerëzore varet nga fakti nëse ajo gëzon sanksionimin e shoqërisë njerëzore të organizuar, apo jo. Nëse e drejta njerëzore nuk ka sanksionim e shoqërisë, një tërësi e tillë normash nuk e gëzon statusin e ligjit. Ndërkaq, statusi ligjor i të drejtës islame nuk varet nga ky faktor. Sheriati është Ligji që vjen nga Zoti. Dhe nëse disa pjesë të shoqërisë njerëzore nuk e zbatojnë atë, me këtë, ata nuk e dëmtojnë statusin e së drejtës islame, por i sjellin dëm vetes së tyre. Zoti, në Kuranin fisnik, thotë: ***"Që ithtarët e Inxhilit të gjykojnë sipas asaj që Allahu e zbriti në të. E kush nuk gjykon sipas asaj që Allahu e zbriti, të tillët janë mëkatarë."*** *(El Maide, 47).*
2. E drejta njerëzore nuk është e lidhur me fenë dhe nuk ka ndonjë karakteristikë të shenjtërisë. Ndërsa e drejta islame është pjesë themelore e besimit të çdo myslimani dhe konsiderohet e shenjtë. Myslimani e di se Sheriati vjen nga Allahu i Lartësuar dhe se kënaqësia e Tij nuk mund të arrihet pa zbatimin e Ligjit të Tij.
3. Roli i së drejtës njerëzore është i vendosur në mënyrë negative: ajo duhet ta parandalojë agresionin dhe tiraninë e njeriut mbi njeriun. Qëllimi i së drejtës islame

[11] Po aty, f. 26- 28.

është ta udhëheqë dhe ta ndriçojë jetën e njeriut. Prandaj, ajo përmban forma të respektit për Zotin dhe norma të nevojshme për të arritur pastrimin njerëzor.

4. E drejta njerëzore e ka burimin në zakonet dhe konventat shoqërore. Nuk ka lidhje ndërmjet të kaluarës dhe të ardhmes. Ndryshe nga kjo, e drejta islame bazohet në shpalljen e Zotit dhe universalitetin e natyrës njerëzore. Zakonet dhe konventat luajnë një rol të kufizuar, kurse marrëdhëniet ndërmjet të kaluarës dhe të tashmes janë të ruajtura.[12]

Shpeshherë Sheriatit i jepet një kuptim i ngushtë, kështu që ai reduktohet në ato dispozita, që rregullojnë marrëdhëniet në bashkësinë islame dhe shtrihen në veprat dhe veprimet e njerëzve, e jo edhe në anën shpirtërore dhe besimin e tyre. Pra, Sheriati nënkupton tërë sistemin ligjor, që është vendosur me besimin islam.[13]

M. Islahi e ekspozon natyrën e ndryshimeve në strukturën e së drejtës islame. E drejta njerëzore ndryshon krahas me ndryshimet shoqërore. Nga ana tjetër, e drejta islame nuk i nënshtrohet tërësisht ndryshimeve të rrethanave sociale. Në Islam, ndryshimet shoqërore i nënshtrohen të drejtës, edhe pse ka elemente të së drejtës, që ndryshojnë me ndryshimin e vendit dhe kohës. Kjo natyrë unike e bën të drejtën islame

---

[12] Shih: *Šerijat, bilješke uz jedno novo djelo o islamskom pravu*, vep. cit., f. 49.

[13] Shih: Parathënien e librit H. Muradbegović, *Tumač šerijatskih propisa*, sipas Džemalutin Latić dhe Seid Smajkić, *Šerijat i njegov današnji značaj za Bošnjake*, Glasnik Rijaseta Islamske zajednice u Bosni i Hercegovini, nr. 1-2, Januar-februar, 1997, Sarajevë, f. 50.

njëkohësisht statike dhe dinamike, konservatore dhe progresive. Ajo inkurajon përparimin në shoqëri, por në të njëjtën kohë vepron si kujdestari i saj.[14]

## Dallimi ndërmjet të drejtës islame dhe asaj romake

Dijetari i shquar Muhamed ebu Zehre, shkruan se, është e çuditshme që disa njerëz të painformuar dhe injorantë ndaj të vërtetës tentojnë ta ndërlidhin të drejtën islame me të drejtën romake. Mirëpo, këto tentativa janë të pasuksesshme, duke marrë parasysh faktin se e drejta romake rrjedh nga kultura pagane, ndërsa e drejta islame buron nga Kurani fisnik dhe Suneti i Pejgamberit a.s..[15]

Ekspertët e së drejtës, kur krahasojnë Sheriatin dhe të drejtën romake, nxjerrin në pah se Sheriati nuk ka ndjekur rrugën drejt së cilës ka ecur e drejta romake. E drejta romake "ka filluar me traditat dhe është zhvilluar dhe ka përparuar me anë të proceseve dhe veprimit procedural". E drejta islame, ndërkaq, ka filluar si Libër dhe Shpallje e dorëzuar nga Zoti, ndërkohë është zhvilluar dhe ka përparuar me anë të analogjisë logjike dhe rregullave objektive.[16]

Profesori J. N. Anderson, thekson se veçoria kryesore e së drejtës islame, në raport me të drejtën evropiane, është se në esencë, e drejta islame ka karakter fetar. Ndërkaq, e drejta

---

[14] Shih: *Šerijat, bilješke uz jedno novo djelo o islamskom pravu*, vep. cit., f. 49.

[15] Muhammed Ebu Zehra, *"Marrëdhëniet ndërkombëtare në Islam",* Shkup, Furkan ISM, 2013, f. 16.

[16] Jusuf el Kardavi, vep. cit., f. 132.

romake, në traditat e së cilës bazohet e drejta evropiane, paraqet të drejtën e testamentuar nga njeriu njeriut. Prandaj, e drejta evropiane mund të ndryshohet nëse e kërkojnë rrethanat, njashtu sikurse edhe është formuluar.[17]

E drejta te romakët është shprehje e vullnetit të njeriut, ndërsa e drejta islame bazohet në vullnetin e Zotit, që i është shpallur Pejgamberit a.s.. Madje, dallimi thelbësor midis sistemit juridik islam dhe atij romak është fakti se bazë e fikhut është besimi në Zotin Një dhe të Vetëm, ndërsa e drejta romake ka për bazë besimin politeist. Nga kjo bazë e ndryshme, mugullojnë dhe degëzohen dallimet në çështjet e shumta midis këtyre dy sistemeve.[18]

Pra, ekzistojnë dallime thelbësore midis të drejtës islame dhe asaj romake. Për sa i përket kuptimit të së drejtës: romakët e quajnë të drejtën e tyre *ius*, që do të thotë *"e drejtë",* ndërsa myslimanët e quajnë të drejtën e tyre *fikh*, që do të thotë *"njohuri, kuptim"* (të njohurit për të drejtat dhe obligimet e një personi - siç e ka definuar Imam Ebu Hanife). Në paraqitjen e dispozitave praktike në koleksionet juridike, romakët i ndajnë librat e tyre në tri pjesë: persona, gjëra dhe padi, ndërkohë që avokatët myslimanë i ndajnë veprat e tyre në kapitujt e ibadetit (adhurime), muamelat (marrëdhënie pronësore) dhe ukubat (dënime).[19]

---

[17] Fikret Karciq, "*Histori e së drejtës së Sheriatit*", Prizren, 1994, f. 11.

[18] Muhamed Hamidullah, *"Ndikimi i të drejtës romake mbi fikhun",* sipas Fikret Karciq, *"Studime për të drejtën e sheriatit dhe institucionet",* Logos-A, Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2015, f. 360.

[19] Shih: Muhamed Hamidullah, "*Ndikimi i të drejtës romake mbi fikhun*", sipas: Fikret Karciq, "*Studime për të drejtën e Sheriatit dhe institucionet*", Logos-A Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2015, f. 361.

Dispozitat të cilat përcaktohen me emrin *"e drejta romake"* nuk janë vetëm me prejardhje romake. Autori anglez Post, në hyrje të veprës *Institucionet e Gajit* (f. 24-25) ka thënë: "E drejta romake do të ishte në thjeshtësi edhe më e pazhvilluar, sikur të mos vinte në kontakt me viset lindore." (Po aty, f. 15.) E drejta romake ka pasur ndikim nga Afrika Veriore, Siria dhe Azia e Vogël. Shkencëtari Collinet dhe të tjerët, pas verifikimit të zellshëm, erdhën në përfundim se e drejta e cila quhet romake, në fakt, ka qenë nën ndikimin e vendeve lindore. Përveç kësaj edhe Gaji, juristi më i madh romak, ka qenë me prejardhje nga Lindja – Azia e Vogël.[20]

Njëri nga dijetarët më të mëdhenj të shekullit XX, Muhamed Hamidullah, lidhur me mundësinë e ndikimit të së drejtës romake mbi fikhun, ka thënë: "Nuk ka kurrfarë kujtese për ekzistimin e njohësve të së drejtës romake në mesin e bashkëkohësve apo shokëve të Pejgamberit a.s.. Në bazë të kësaj, thënë më së buti, e refuzojmë pohimin se një pjesë e fikhut, e nxjerrë nga Kurani dhe Hadithi, ka pësuar çfarëdo lloj ndikimi nga e drejta romake."[21]

## Fikhu dhe kanuni

Fikhu është e drejtë fetare (sakrale), kurse kanuni është drejtë e përbotshme (sekulare). Fikhu ka karakter të shenjtë, ngaqë bazohet në burimet hyjnore: Kuran dhe Sunet, dhe prandaj konsiderohet e drejtë e pacenueshme dhe e pazëvendësueshme. Kanuneve që janë e drejtë sekulare, nuk u pra-

---

[20] Po aty, f. 359.
[21] Po aty, f. 351.

nohet ky status. Kanunet i nxjerrin sundimtarët myslimanë që mund t'i ndryshojnë sipas rrethanave dhe nevojave të shoqërisë. E drejta fetare ka karakter universal dhe duhet zbatuar në mbarë botën myslimane, ndërsa kanunet kanë karakter lokal dhe zbatohen vetëm në territorin e shtetit që i nxjerr ato.[22] Kanunet nuk duhet të jenë në kundërshtim me fikhun.

E drejta që mund të gjendet në veprat klasike nga sfera e fikhut, që në dekadat e mëparshme është zhvilluan pa ndërhyrjen e shtetit, është quajtur e drejtë e sheriatit, kurse ajo që është formuar me urdhrat e sulltanit dhe të fermanëve, është emëruar e drejta zakonore. Kështu që, e drejta osmane, në bazë përbëhet nga Sheriati dhe zakonet. E drejta zakonore është zhvilluar gjatë kohës krahas me të drejtën e sheriatit.[23]

Për dallim nga e drejta e sheriatit, që u zhvillua me anë të interpretimit juridik të burimeve të Sheriatit, e drejta zakonore u formua në një mënyrë krejt ndryshe. Shteti nuk ka pasur një rol të madh në zhvillimin e doktrinës të së drejtës sheriatike, për dallim nga e drejta zakonore, e njohur si *urf osmani*, e cila u bë me anë të sjelljes së dekreteve të ndryshme nga ana e sulltanëve osmanlinj. Miratimi i ligjeve të bazuara në të drejtën zakonore rrjedh nga fakti se e drejta e sheriatit ia njeh të drejtën sundimtarit që me anë të *sijase sher'ije*s t'i rregullojë ato çështje, që nuk janë rregulluar me dispozitat e Sheriatit.[24]

---

[22] Dr. Mehmed Begoviq, vep. cit., f. 10.

[23] *Historija Osmanske države i civilizacije I,* përgatiti: Ihsanoglu, E. (Ekmeledin), Orijentalni institut u Sarajevu, Sarajevo, 2004, f. 516.

[24] Husein Kazanović, *Dvije kodifikacije šerijatskog porodičnog prava*, El Kalem, Sarajevo, 2012/1433, f. 55.

E drejta zakonore është formuar sipas ligjeve të cilat i sollën sulltanët, dhe jo përmes interpretimeve shkencore të juristëve. Zakonet që ka sjellë sulltani, në parim, ishin të vlefshme aq kohë sa ishte sulltani gjegjës në pushtet. Gjatë sjelljes së tyre, janë marrë parasysh traditat, zakonet ekzistuese dhe kushtet lokale, veçanërisht në lidhje me të drejtën e tokës dhe të taksave. Arsyeja kryesore që sulltani sillte zakone, që përmblidheshin përgjithësisht në *kanunname*, ishte që të pengohej dhënia e pavarur e dënimeve nga ana e ushtarakëve dhe e administratorëve të tyre, si dhe vendosja e taksave dhe grumbullimi i dënimeve me para, sipas hamendjes vetjake dhe sjellje e veprime të ngjashme.[25]

Kanunnama (*kanunname*) është një shprehje që, në përdorimin osman, nënkuptonte në përgjithësi urdhrin e sulltanit, i cili përmbante dispozita ligjore për një çështje të caktuar. Kanunnama i ngjante çdo kanuni normal në kuptimin që urdhri i sulltanit mund t'i jepte asaj forcën e ligjit.[26]

*Kanunnamet*, dekretet e sulltanit, mbulonin fushën e së drejtës publike, organizatat dhe administratën shtetërore, sistemin tatimor të së drejtës penale dhe *hisben*. Aktet ligjore që përmbanin dispozita për veprimet politike quheshin *"sijasetname",* kurse ato që rregullonin mbledhjen e taksave, organizimin qeveritar, të drejtat e statusit dhe të ngjashme u quajtën *kanunname*.[27]

[25] *Historija Osmanske države i civilizacije I,* vep. cit., f. 520-521.

[26] Nerkez Smailagić, *Leksikon islama*, vep. cit., f. 12.

[27] Husein Kazanović, *Dvije kodifikacije šerijatskog porodičnog prava*, vep. cit., f. 55-56.

## Përfundimi

E drejta islame është e pavarur dhe fetare në esencën e saj. Ajo është zhvilluar në mënyrë autonome brenda botës islame. Imamët Ebu Hanife, Maliku, Shafiu etj., nuk njihnin fare të drejtën romake, ata ndërtuan sistemin e tyre nga burimet fetare dhe praktikat e sahabëve. Juristët myslimanë nuk kopjuan sistemin romak.

**Resul REXHEPI**

# SHPENZIMI I PASURISË PËR QËLLIME BAMIRËSIE

قال رسول الله صلى الله عليه و سلم: "إِنَّ الصدقةَ لتُطفئُ عن أهلِها حرَّ القبورِ، وإنما يستظلُّ المؤمنُ يومَ القيامةِ في ظِلِّ صدقتِه"

Pejgamberi a.s., me një rast, ka thënë:

*"Vërtet, sadakaja (bamirësia) shuan për të zotët e saj nxehtësinë e varreve dhe se besimtari, në Ditën e Kiametit do të jetë nën hijen të cilën do t'ia bëjë sadakaja (bamirësia) e tij."*

## Hyrje

Feja islame, çështjes së pasurisë dhe të mirave materiale në përgjithësi, i ka kushtuar vend meritor, madje atë e ka konsideruar si një prej begative më të mëdha që i Madhi Zot ia ka dhuruar njeriut. Pasuria, pra, nuk është veçse një amanet prej Allahut të Gjithëmëshirshëm, por gjithsesi, edhe një sprovë për njeriun. Ajo nuk përbën qëllim në vetvete, por shërben si mjet për ta arritur kënaqësinë e Zotit dhe për t'i ndihmuar krijesat e Tij. Njeriu nuk është zotërues absolut i pasurisë që ka, por vetëm një kujdestar i saj për aq kohë sa jeton në këtë botë. Prandaj, mënyra se si ai e përdor pasurinë e tij është tregues i besimit, moralit dhe ndërgjegjes së tij.

Pasuria, në fakt, është mjet i fuqishëm dhe varësisht se si përdoret, ajo mund të bëhet mirësi e madhe, ose edhe në të kundërtën, mund të bëhet shkak i devijimeve dhe padrejtësive. Prandaj, mënyra më e mirë dhe më fisnike e shfrytëzimit të pasurisë është shpenzimi i saj për qëllime bamirësie, sepse bamirësia është një nga veprimet më fisnike që një njeri mund ta bëjë. Përmes kësaj, njeriu tregon ndjeshmëri, bujari, humanizëm dhe përgjegjësi ndaj të tjerëve që kanë aq shumë nevojë. Por, a ka vepër më të mirë dhe më të dashur te Zoti sesa t'ua lehtësosh vuajtjet dhe t'ua përmirësosh jetën njerëzve në nevojë?! Duhet theksuar se e Drejta Islame – Sheriati, këtë aspekt tejet të rëndësishëm social e ka përfshirë në një sërë formash të dhënies (shpenzimeve) fetare, të cilat janë: zekati, sadakatu'l fitri, kurbani, lëkurat e kurbaneve, fidja, kefareti dhe sadakaja.

Në terminologjinë tonë, të përdorur në kuadër të institucioneve islame, këto zakonisht njihen me emërtimin "dhënie fetare". Këto janë disa forma përmes të cilave myslimanët e pasur obligohen të kontribuojnë në zgjidhjen sa më efikase të çështjeve social-ekonomike brenda bashkësisë islame. Ato përfaqësojnë shprehje të mirëfillta të altruizmit fetar, dhe secila prej tyre përbën një kapitull më vete, që meriton trajtim të veçantë. Megjithatë, meqë për to tashmë është shkruar gjerësisht në shtypin tonë islam, mund të thuhet se për shumicën e besimtarëve tanë këto nuk janë koncepte të panjohura.

Duhet kuptuar drejt se, parimi themelor i bamirësisë nuk qëndron vetëm në aktin e zemërgjerësisë apo në shprehjen e bujarisë, por, mbi të gjitha, në vendosmërinë për të jetësuar dhe zbatuar normat dhe parimet islame. Këto, përveçse për-

faqësojnë një detyrim fetar, janë njëherazi edhe shprehje e mirësisë dhe përgjegjësisë ndaj shoqërisë.

Shpenzimi i pasurisë për të ushqyer njerëzit në nevojë, për të ndihmuar të sëmurët, për t'i shkolluar fëmijët pa mundësi, apo për të ndërtuar institucione që i shërbejnë komunitetit, përbën një investim që nuk matet me përfitim material, por me vlera njerëzore dhe shpirtërore.

Në vijim do të trajtojmë shpenzimin e pasurisë në rrugën e Allahut (el infāku fī sebīlillāh), si një nga shtyllat më të larta të moralit dhe solidaritetit në Islam.

## Çfarë është, në të vërtetë, shpenzimi në rrugën e Zotit?

Kjo sintagmë, e përmendur në shumë vende në Kuranin famëlartë, paraqet kuptimin më të gjerë të sadakasë. Ajo nuk kufizohet vetëm në dhënien e zakonshme apo në aktet individuale të bamirësisë, por shtrihet përtej tyre, duke synuar bamirësinë gjithëpërfshirëse në shërbim të mbarë bashkësisë islame.

Pikërisht për këtë arsye, në burimet themelore të Islamit, në Kuran dhe Sunet, ky koncept është trajtuar me një emërtim të veçantë: shpenzim i pasurisë në rrugën e Zotit.

Ky lloj shpenzimi përfshin jo vetëm ndihmën materiale ndaj individëve në nevojë, në formën e lëmoshës apo mbështetjes direkte, por edhe kontributin për të mirën e përgjithshme të bashkësisë, veçanërisht për bashkësinë islame, e cila përbën rrafshin e parë të përgjegjësisë morale dhe fetare të besimtarit.

Kjo bamirësi ose sakrificë materiale shfaqet përmes shpenzimit të pasurisë në dobi të të tjerëve. Ky shpenzim duhet të

ketë natyrë të qëndrueshme dhe të përhershme, gjë që përfshin edhe themelimin e institucioneve me karakter të përhershëm. Pikërisht kjo qëllimësi dhe qëndrueshmëri përbën thelbin e shpenzimit të pasurisë në rrugën e Zotit.

Mirëpo, që në fillim, duhet theksuar se kjo bamirësi e përgjithshme ndaj bashkësisë nuk arrihet vetëm përmes sakrificës materiale dhe ngritjes së nivelit ekonomik të saj, edhe pse ky është një kusht elementar. Ajo mund të realizohet gjithashtu edhe në forma të tjera, sidomos përmes ngritjes së nivelit kulturo-arsimor të bashkësisë, për shembull duke shkruar dhe lënë pas vete libra dhe punime shkencore, që do t'u shërbejnë gjeneratave të ardhshme.

Megjithatë, kjo lloj veprimtarie në masë të konsiderueshme varet, para së gjithash, nga mundësitë materiale të bashkësisë. Ky aktivitet shoqëror, pra sakrifikimi për mirëqenien e bashkësisë, sipas haditheve të Pejgamberit a.s. mund të konsiderohet edhe si "sadakatun xharije" (sadaka e vazhdueshme), për të cilën shpërblimi i Allahut shkon jo vetëm sa është gjallë individi në këtë botë, por edhe pas kalimit të tij në Ahiret.

Me një fjalë, sevapet i shkojnë atij aq gjatë sa të vazhdojë ajo sadaka të prodhojë frytet e saj. Kjo është vërtetuar në hadithin e Pejgamberit a.s., të transmetuar nga Ebu Hurejreja:

عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ ﷺ أَنَّ رَسُولَ اللهِ ﷺ قَالَ إِذَا مَاتَ الْإِنْسَانُ انْقَطَعَ عَنْهُ عَمَلُهُ إِلَّا مِنْ ثَلَاثَةٍ: إِلَّا مِنْ صَدَقَةٍ جَارِيَةٍ، أَوْ عِلْمٍ يُنْتَفَعُ بِهِ، أَوْ وَلَدٍ صَالِحٍ يَدْعُو لَه

Transmeton Ebu Hurejre se Pejgamberi a.s. ka thënë: *"Kur vdes njeriu, i ndërpriten të gjitha veprat e tij (nuk i shkojnë as sevapet, as gjynahet), përveç se në tri raste: nëse pas vetes ka lënë sadaka të rrjedhshme*

*(sadakatun xharijetun), ose ndonjë vepër nga e cila njerëzit kanë dobi, ose ka lënë pas fëmijë, i cili i lutet Allahut dhe bënë dua për prindërit e tij."*[1]

Meqë hadithi i sipërpërmendur përfshin një gamë të gjerë mënyrash për të cilat besimtari mund të ofrojë kontributin e tij, Pejgamberi a.s., e ka shpjeguar konceptin e *"sadakasë së vazhdueshme"* me disa shembuj konkretë, të cilët do t'i trajtojmë më poshtë:

فعن أنس ﷺ قال : قال رسول الله ﷺ سبعٌ يجري للعبد أجرهن وهو في قبره بعد موته : من علَّم عِلْماً ، أو أجرى نهراً ، أو حَفَر بئراً ، أو غرس نخلاً أو بنى مسجداً ، أو ورَّث مصحفاً ، أو ترك ولداً يستغفر له بعد موته

Transmetohet nga Enesi se Pejgamberi a.s., ka thënë: *"Në shtatë raste, sevapet vazhdojnë t'i rrjedhin njeriut edhe pas vdekjes së tij, dhe, edhe sa ai është në varrin e tij, dhe atë: kush ka mësuar dituri dhe atë e përhapë* (nga e cila të tjerët kanë dobi), *nëse ndërton një çezme, ose hapën një pus*

[1] Transmeton Muslimi. Me fjalën e Pejgamberit a.s. *(sadakatun xharije)* kuptohen: objektet, parcelë toke, xhamia, ndërtesa, spitale, çezmat, pu-set, kanalizimet për ujitje ose çfarëdo objekti tjetër që e ka lënë për hajrat..., ose institucionet e ndryshme të bamirësisë, veprat e shkruara - librat fetar dhe shkencor të dobishëm për shoqërinë. Kështu që, sado që të ketë dikush dobi nga ajo vepër bamirësie, atij sevapet i shkojnë deri sa ai objekt të jetë aktiv dhe njerëzit të kenë dobi nga ai. Gjithsesi në kë-të kategori hyjnë edhe dhënia e parave për të ndërtuar objekte bamirësie ose për të shtypur libra dhe vepra të tjera të ngjashme. Më gjerësisht: Vehbija Hodzic te "Glasnik" i Kryesisë Supreme të Bashkësisë Islame-Sarajevë, nr. 9-10, f. 453-462, 1970.

(nga i cili njerëzit pinë ujë), *nëse mbjellë pallmë* (ose pemë të tjera të dobishme anash rrugës për njerëzit), *nëse ndërton xhami, nëse pas veti lë Mus'haf* (ose edhe libër tjetër nga i cili pasardhësit e tij ose njerëzit e tjerë që e lexojnë do të kenë dobi), *dhe nëse lë fëmijë të edukuar në frymën islame, i cili do t'i lutet Zotit për prindërit e tij që Ai t'i falë e t'i mëshirojë."*[2]

Nga sa kuptohet nga hadithet e sipërpërmendura, ky lloj i aktivitetit fetar, para së gjithash ka të bëjë me ndërtimin e objekteve dhe ngritjen e institucioneve me rëndësi të gjerë dhe të qëndrueshme dhe gjithsesi të vlefshme për bashkësinë, siç janë:

1. Institucionet sociale: jetimoret, mysafirhanet (bujtja pa pagesë e udhëtarëve që i ka zënë nata në rrugë), imaretet (kuzhinat ushqimore pa pagesë ose furrat për të varfër dhe bonjakë), organizatat dhe entet e ndryshme etj.;
2. Institucionet arsimore: medresetë dhe shkollat në përgjithësi, bibliotekat, shtypshkronjat për shtypjen e librave shkencore-fetare, gjegjësisht të holla për shtypjen e librave me përmbajtje fetare dhe shkencore;
3. Institucionet fetare: xhamitë, mesxhidet, mejtepet etj.;
4. Institucionet shëndetësore: spitalet, kopshtet e fëmijëve etj.;
5. Objektet e shfrytëzuara nga shoqëria: çezmat, rrjeti i ujësjellësit, puset, kanalet për ujitje, urat, rrugët, pemishtet pranë rrugëve për kalimtarë të rastit dhe të ngjashme;

[2] Transmeton Bejhekiu.

6. Trashëgimlënia e paluajtshmërive (vakëfeve) për mirëmbajtjen e objekteve të sipërpërmendura e të ngjashme.

Besimtarët, sipas këshillave dhe porosive të Kuranit, janë udhëzuar të sakrifikojnë pasurinë e tyre duke e dhuruar për qëllime të dobishme, dhe Kurani thekson se ata që veprojnë kësisoj janë besimtarë të vërtetë. Të tillët janë objekt respekti dhe nderimi, sepse veprat e tyre sjellin hair-dua për gjenerata të tëra në këtë botë, dhe mëshira e të Madhit Zot do t'i shoqërojë edhe në jetën tjetër.

Lum ai që arrin ta fitojë kënaqësinë e Zotit dhe respektin e njerëzve për veprat e tij. Të tillët veprojnë, para së gjithash, në emër të Allahut dhe për kënaqësinë e Tij, dhe Allahu nuk do t'ua mbajë borxh, por do t'i shpërblejë shumëfish, ashtu siç theksohet në Kuran:

وَمَا أَنفَقْتُم مِّن شَيْءٍ فَهُوَ يُخْلِفُهُ وَهُوَ خَيْرُ الرَّازِقِينَ

***“Çfarëdo që të shpenzoni ju për hir të Allahut** (për bashkësinë tuaj), **Ai do t'ju zëvendësoj** (shumëfishë) **atë. Ai është më i miri Furnizues.”***[3]

Kurse me një hadithi kudsij, Allahu xh.sh., përmes Muhamedit a.s., ka thënë:

قال الله تعالى. إِنْفَقْ أُنْفِقْ

*Allahu i Lartësuar ka thënë:* ***“Shpenzo, dhe Unë do të shpenzoj për ty.”***

Kuptimi i këtij hadithi kudsij është se kur besimtari dhuron pasurinë e tij në rrugën e Zotit dhe në bamirësi, Allahu

[3] Es Sebe, 39.

do ta shpërblejë me dhunti të panumërta në këtë botë dhe në botën tjetër (Xhenet). Ai tregon se bamirësia dhe shpenzimi i pasurisë nuk mbeten pa shpërblim, përkundrazi, Allahu i Lartësuar do t'ia kthej shumëfish.

Besimtarët e tillë, bamirësit që veprojnë me motiv të fuqishëm fetar dhe gjithmonë për hir të Zotit, kur shpenzojnë pasurinë e tyre në rrugën e Allahut dhe për ta përkrahur materialisht bashkësinë islame, janë në gjendje të sakrifikojnë çdo gjë. Për ta, as pasuria, as fëmijët, madje as vetë jeta nuk kanë rëndësi kur bëhet fjalë për vullnetin dhe urdhrin e Zotit. Ata e dinë mirë se gjithçka që zotërojnë është dhuratë nga Allahu i Lartësuar, dhe çdo shpenzim në rrugën e Tij do t'u kthehet shumëfish.

## Bamirësia në dritën e Kuranit dhe të Sunetit

Feja islame, bamirësinë e konsideron një vlerë të lartë morale dhe shpirtërore, dhe brenda këtij kuadri, zekati është renditur si një prej shtyllave themelore të fesë islame. Për më tepër, shpenzimi i pasurisë në bamirësi shërben edhe si një mburojë kundër egoizmit dhe lakmisë. Ai i kujton njeriut se pasuria është kalimtare dhe se vlera e saj e vërtetë qëndron në ndikimin që ajo ka te të tjerët. Shumë besimtarë të devotshëm, edhe nëse nuk kanë qenë figura të mëdha historike, kanë lënë gjurmë të dukshme për bujarinë dhe përkushtimin ndaj fesë së tyre të shtrenjtë, duke kontribuar në përmirësimin e jetës së shoqërisë.

Fundja, ajo që mbetet nga pasuria nuk është ajo që kemi konsumuar për vete, por ajo që kemi ndarë me të tjerët. Një

botë më e drejtë, më humane dhe më e barabartë ndërtohet nga ata që e kuptojnë se pasuria ka vlerë të vërtetë vetëm kur ajo kthehet në mirësi.

Kur është fjala te zekati, i Madhi Zot, i ka përcaktuar në Kuran kategoritë të cilave duhet dhënë zekatin dhe ato janë:

1. Të varfërve (fukarenjve);
2. Nevojtarëve që kanë pak, por jo mjaftueshëm (mesakinë);
3. Ata që punojnë në tubimin e zekatit (amiline);
4. Atyre që duhen përfituar zemrat (muel-lefetu-l-kulub);
5. Lirimin e skllevërve (rikab);
6. Të mbingarkuarve me borxhe (garimin);
7. Atyre që luftojnë dhe atyre që punojnë në rrugën e Zotit (fi sebilil-lahi); dhe
8. Të ngelurit në rrugë (ibnus-sebil).[4]

Gjatë 60-70 vjetëve të fundit, në vendin tonë, të gjitha kategoritë e sipërpërmendura janë lanë anash, përveç kategorisë së shtatë e që është puna në rrugën e Zotit (fi sebilil-lah). Sikur të gjithë myslimanët që janë të ngarkuar me dhënien e zekatit, ta jepnin atë rregullisht, atëherë të gjitha problemet e natyrës materiale nuk do të ekzistonin, ndërkaq bashkësia jonë do të shkëlqente në çdo aspekt, e në veçanti në aspektin fetar, kulturor dhe arsimor.[5]

---

[4] Et Tevbe, 60.

[5] Grup autorësh, *Islami nëpërmjet haditheve*, “Kryesia e Çështjeve fetare të Turqisë-Dijaneti”, bot. i dytë, Ankara, 2017.

Feja islame, nuk është kufizuar vetëm me kategoritë e sipërpërmendura, por myslimanët i ka urdhëruar në mënyrë imperative (i ka obliguar moralisht) që, pavarësisht nga gjendja e tyre materiale, të japin kontribute materiale (donacione, testamente etj.) për bashkësinë e tyre për qëllime bamirësie (fi sebilil-lahi) duke mos u caktuar lartësinë dhe natyrën e të njëjtave.

Kurani, pikërisht për shkak të rëndësisë që ka bamirësia dhe për shkak të ndikimit të saj pozitiv në shoqëri, këtë çështje e ka përmendur shumë herë, si në ajetet:

مَّثَلُ الَّذِينَ يُنفِقُونَ أَمْوَالَهُمْ فِي سَبِيلِ اللَّهِ كَمَثَلِ حَبَّةٍ أَنبَتَتْ سَبْعَ سَنَابِلَ فِي كُلِّ سُنبُلَةٍ مِّائَةُ حَبَّةٍ وَاللَّهُ يُضَاعِفُ لِمَن يَشَاءُ وَاللَّهُ وَاسِعٌ عَلِيمٌ.

***“Shembulli i atyre të cilët e shpenzojnë pasurinë e tyre në rrugën e Allahut, i përngjanë kokrrës së grurit, nga e cila mbijnë shtatë kallinj dhe çdo kalli ka njëqind kokrra. Allahu ua shton shumëfish kujtdo që Ai dëshiron. Dhe Allahu është i Gjithëmjaftueshëm për të përmbushur nevojat e krijesave të Tij, i Gjithëditur.”***[6]

Nga ky ajet i Kuranit kuptohet se bamirësia nuk e zvogëlon pasurinë, përkundrazi, ajo e shton atë, shpesh në mënyra që njeriu nuk mund t’i imagjinojë. Çdo dhënie për hir të Allahut të Lartësuar kthehet në sevape dhe bereqet, si në këtë botë ashtu edhe në botën tjetër.

[6] El Bekare, 261. Ajetet e kësaj natyre ose me këtë përmbajtje në Kuranin fisnik janë të shumtë, p.sh. El Bekare, 262; El Hadid, 10; El Enfal, 60 e shumë të tjerë.

Allahu i Gjithëmëshirshëm, në Kuranin fisnik, në një ajet tjetër, duke e ditur se njeriu shpesh nuk vepron në kohën e duhur dhe se ndonjëherë pendohet duke thënë: “Ah, sikur të kisha pasur kohë për të dhënë sadaka,” thotë:

وَأَنفِقُوا۟ مِن مَّا رَزَقْنَـٰكُم مِّن قَبْلِ أَن يَأْتِىَ أَحَدَكُمُ ٱلْمَوْتُ فَيَقُولَ
رَبِّ لَوْلَآ أَخَّرْتَنِىٓ إِلَىٰٓ أَجَل قَرِيب فَأَصَّدَّقَ وَأَكُن مِّنَ ٱلصَّـٰلِحِينَ

***“Dhe shpenzoni** (në bamirësi) **nga ajo me të cilën Ne ju kemi furnizuar, para se ndonjërit prej jush t’i vijë vdekja e të thotë: “Zoti im! Veç sikur të më jepje fare pak kohë** (sa të kthehesha në jetën e dynjasë), **se do të jepja sadaka dhe do isha prej njerëzve të mirë!”***[7]

Dhe, gjithashtu, kjo dëshmohet edhe në këtë ajet të Kuranit:

الَّذِينَ يُنفِقُونَ أَمْوَالَهُم بِاللَّيْلِ وَالنَّهَارِ سِرًّا وَعَلَانِيَةً فَلَهُمْ أَجْرُهُمْ
عِندَ رَبِّهِمْ وَلَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ

***“Ata të cilët e shfrytëzojnë pasurinë e tyre** (për hir të Allahut) **natën e ditën, fshehurazi e hapur, këta do ta kenë shpërblimin te Zoti i tyre dhe për ta nuk do të ketë as frikë dhe as nuk do të pikëllohen.”***[8]

Disa njerëz, mendojnë se pasuria që kanë arritur është vetëm fryt i punës së tyre dhe se askush tjetër nuk ka asnjë të drejtë mbi të, duke harruar se mëshira e Allahut kurrë nuk u ka munguar. Prandaj, ata që tregohen dorështrënguar ndaj dhuntive të Zotit, do të pendohen në Ditën e Llogaridhënies, ashtu si e thekson Kurani:

---

[7] El Munafikun, 10.

[8] El Bekare, 274.

وَلَا يَحْسَبَنَّ الَّذِينَ يَبْخَلُونَ بِمَا آتَاهُمُ اللَّهُ مِن فَضْلِهِ هُوَ خَيْرًا لَّهُم
بَلْ هُوَ شَرٌّ لَّهُمْ سَيُطَوَّقُونَ مَا بَخِلُوا بِهِ يَوْمَ الْقِيَامَةِ وَلِلَّهِ مِيرَاثُ
السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَاللَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ خَبِيرٌ.

***"Le të mos mendojnë ata të cilët me zili mbajnë dhe nuk japin nga ato gjëra që u ka dhuruar Allahu nga begatitë e Tij, se kjo është mirë për ta. Përkundrazi, do të jetë akoma më keq për ta, gjërat që ata nga zilia nuk i japin, do t'u varen si kular në qafë në Ditën e Ringjalljes. Allahut i përket trashëgimia e qiejve dhe e Tokës. Allahu është mirë i njoftuar me gjithçka ju veproni."***[9]

Ka momente kur njerëzit vetëdijesohen dhe, me kokë të përulur para Allahut, luten që t'i kthejë në këtë jetë për të kryer vepra të mira, por atëherë është vonë:

وَلَوْ تَرَىٰ إِذِ الْمُجْرِمُونَ نَاكِسُو رُءُوسِهِمْ عِندَ رَبِّهِمْ رَبَّنَا أَبْصَرْنَا
وَسَمِعْنَا فَارْجِعْنَا نَعْمَلْ صَالِحًا إِنَّا مُوقِنُونَ

***"Sikur të shihje kur mëkatarët me koka të përulura para Zotit të tyre*** *(duke thënë):* ***"Zoti ynë! Tani pamë dhe dëgjuam, na rikthe sërish në dynja se do të bëjmë mirësi e drejtësi. Vërtet se ne jemi plotësisht të bindur."***[10]

Njeriu duhet të ketë gjithmonë parasysh se sadakaja, apo dhënia për të tjerët, është një mënyrë për ta fituar kënaqësinë e Allahut dhe për të hyrë në mëshirën e Tij. Në një hadith kudsij, Allahu thotë:

---

[9] Ali Imran, 180.

[10] Es Sexhde, 12.

يابْنَ أٰدَمَ أنْفِقْ أُنْفِقْ عَلَيْكَ

*"O biri i Ademit, shpenzo (duke dhënë për të tjerët) në mënyrë që edhe Unë të shpenzojë për ty."*[11]

Në një hadith tjetër, Pejgamberi a.s., ka thënë:

كُلُّ مَعْرُوفٍ صَدَقَةٌ

*"Çdo vepër e mirë është sadaka."*[12]

Nga ky hadith sherif kuptohet se veprat e besimtarit, edhe pse në dukje mund të duken të vogla ose modeste, si buzëqeshja, një fjalë e mirë, apo një ndihmë e vogël, janë të gjitha forma të sadakasë dhe shpërblehen nga i Madhi Zot. Prandaj, duke qenë se këto vepra mund të duken të papërfillshme në syrin e njeriut, ato nuk duhet të nënçmohen, sepse Allahu i Madhërishëm u jep vlerë dhe shpërblim të madh.

Me një rast tjetër, Pejgamberi a.s., kishte bërë një krahasim shumë praktik, duke thënë:

إِنَّ الصَّدَقَةَ تُطْفِئُ الْخَطِيئَةَ كَمَا يُطْفِئُ الْمَاءُ النَّارَ

*"Sadakaja i shlyen mëkatet sikurse uji që e shuan zjarrin."*[13]

Ky hadith tregon fuqinë e bamirësisë në kuptimin më të gjerë, duke përfshirë sadakanë dhe të gjitha dhëniet në rrugën e Zotit, të cilat shërbejnë për t'i fshirë mëkatet e njeriut, po ashtu si uji që e shuan zjarrin. Kjo metaforë e qartë tregon se veprat e mira kanë ndikim të drejtpërdrejtë në pastrimin shpirtëror.

---

[11] Transmeton Muslimi.

[12] Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi (me tekst të përngjashëm).

[13] Transmeton Tirmidhiu.

Nga rastet e përmendura më sipër, ku u diskutua sadakaja-lëmosha, kuptohet se ajo ka një kuptim shumë më të gjerë. Ajo përfshin një gamë të gjerë veprash, që synojnë mirëqenien e përgjithshme të bashkësisë islame, duke u karakterizuar nga vazhdimësia dhe qëndrueshmëria. Pikërisht për këtë arsye, në burimet islame (Kuran dhe Sunet) kjo formë bamirësie ka marrë një emërtim të veçantë: "Shpenzimi i pasurisë në rrugën e Zotit". Me këtë shprehje nënkuptohet se jo vetëm bamirësia ndaj individëve, e shprehur në formën e ndihmës materiale (sadaka), por edhe bamirësia ndaj bashkësisë, dhe në rend të parë ndihma për bashkësinë islame, është e dobishme dhe konsiderohet si sadaka.

## Praktika e Pejgamberit a.s. dhe e sahabëve

Nga sa u tha më sipër, lirisht mund të konkludohet se forma më e lartë e vetëdijes islame është shpenzimi i pasurisë në rrugën e Allahut dhe duke ua zbutur gjendjen e rëndë edhe bashkësisë, por edhe individëve në nevojë. Pejgamberi a.s. ka qenë shembulli më i mirë i bujarisë, i altruizmit dhe i përkushtimit ndaj Allahut, fesë së Tij dhe shoqërisë. Ai, jo vetëm që ishte shembulli më i mirë, por i nxiste edhe të tjerët. Me një rast pati thënë:

إِتَّقُوا النَّارَ وَ لَوْ بِشِقِّ تَمْرَةٍ

*"Ruajuni nga zjarri, qoftë edhe me (dhënien) e gjysmës së një hurme."*[14]

---

[14] Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi.

Kjo ka qenë praktikë e Pejgamberit a.s., i cili tërë pasurinë e tij e ka vakëfnuar në të mirë të shoqërisë. Pejgamberi a.s. dhe shokët e tij e konsideronin pasurinë një mjet për ta fituar kënaqësinë e Zotit dhe për t'i ndihmuar nevojtarët, e jo një qëllim në vetvete. Dora e majtë e Pejgamberit a.s. kurrë nuk e ka ditur se ç'po jep dora e djathtë e tij, sepse këtë ai e ka bërë për hir të Allahut dhe për ta arritur kënaqësinë e Tij.

Ndërkaq, rasti i shokut më të ngushtë të Pejgamberit a.s., Ebu Bekrit r.a., është shumë specifik, sepse ai ka qenë rast unik në këtë botë. Historia ka shënuar se Ebu Bekri r.a., gjithmonë e ka sakrifikuar pasurinë e tij për të mirën e bashkësisë, të cilën Pejgamberi a.s. kishte filluar ta ndërtonte.

Ebu Bekri r.a., i solli tërë pasurinë e tij Pejgamberit a.s. kur ai kërkoi ndihmë për një ekspeditë ushtarake. Kur Pejgamberi e pyeti se çfarë kishte lënë për familjen, ai u përgjigj: *"E kam lënë Allahun dhe të Dërguarin e Tij."*

Omeri r.a., në të njëjtin rast, e kishte sjellë gjysmën e pasurisë së tij duke shpresuar se do t'ia kalonte Ebu Bekrit r.a. në këtë vepër madhështore, por u habit kur pa se ai ia kishte sjellë tërë pasurinë e tij. Gjithashtu, shembull të mirë kanë treguar edhe shokët e tjerë, si Othmani, Aliu e shumë të tjerë. Këta janë shembuj të besimit të gjallë, që nuk ndalet te fjalët, por konkretizohet me vepra, me sakrificë, përkushtim dhe sinqeritet.

Kjo praktikë ka vazhduar gjithmonë, gjeneratë pas gjenerate, deri në ditët tona. Më herët ka pasur bamirës të mëdhenj, të cilët kanë ndarë sasi të konsideruar nga pasuria e tyre, madje aq sa emri i tyre kurrë nuk është harruar, përkundrazi gjithmonë janë përmendur me pietet. Vetëm falë bamirësisë së tyre, me të cilën e kanë ngritur lart pozitën materiale të ba-

shkësisë islame, edhe puna dhe aktivitetet e saj fetare kanë qenë më lehtë të realizuara. Kjo ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë që zhvillimi i jetës fetare të jetë më i suksesshëm, e kjo ka rezultuar edhe me kënaqësinë e vetë popullit. Prandaj, altruizmi është çelësi i lumturisë së shoqërisë dhe individëve.

Myslimanët e pasur të shoqërisë tonë do të duhej ta vërenin se ka trokitur koha e fundit që ata të shkojnë hapave të pararendësve tanë të famshëm, dhe rishtazi ta forcojnë fondin vakëfnor me testamentet e tyre, me se emrin e tyre do ta bënin të pavdekshëm dhe do të fitonin hair-dua deri në Kiamet, kurse nga Allahu do të fitonin shpërblimet më të mëdha.

Lidhur me këtë që u tha më sipër, po e përmendim vetëm një mendim të hasreti Isait a.s., i cili me një rast kishte thënë: *"Atë që e ke dhënë është e jotja, kurse ajo që e ke ndalë për veti, është e huaj."*

## Grumbullimi i pasurisë

Një kategori e njerëzve, e nënvlerësojnë urdhrin e Allahut, i harrojnë këshillat e Tij për t'i ndihmuar ata që kanë nevojë, qoftë përmes bashkësisë së tyre, qoftë drejtpërsëdrejti, por pasurinë e tyre e grumbullojnë. Natyrisht, të tillëve iu vjen momenti kur do ta kuptojnë se kjo që kanë bërë, nuk është e mirë, por atëherë është vonë, madje tepër vonë. Për më tepër, ata do e shijojnë dënimin e merituar në zjarr:

**فَذُوقُوا بِمَا نَسِيتُمْ لِقَآءَ يَوْمِكُمْ هذَا إِنَّا نَسِيْنَاكُمْ وَ ذُوقُوا عَذَابَ الْخُلْدِ بِمَا كُنْتُمْ تَعْمَلُوْنَ**

***"Prandaj, shijoni ju*** *(vuajtjet e zjarrit)* ***për shkak se ju e patët harruar takimin tuaj në këtë Ditë, e edhe Ne***

***tash do t'ju harrojmë juve, andaj, për shkak të asaj që keni vepruar, shijoni dënimin e përjetshëm."***[15]

Ta ritheksojmë sërish se myslimani gjithmonë duhet ta ketë parasysh se besimi i sinqertë në Allahun, bamirësia në emër të Allahut, janë themel i çdo vepre të mirë. Në të kundërtën, nëse kemi vepruar për motive të tjera (që të tregohemi formalisht bujar, p.sh. ose sa për sy e faqe të njerëzve), ose nëse sinqeriteti na ka munguar, kot kemi vepruar, sepse as që do të merren parasysh. Kjo është shfaqje e dyfytyrësisë, qëllimi i së cilës është fitimi i ndonjë dobie të kësaj bote.

Allahu i Madhëruar, në Kuranin fisnik, na porosit kështu:

وَالَّذِينَ يُنْفِقُونَ أَمْوَالَهُمْ رِئَاءَ النَّاسِ وَلَا يُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَلَا بِالْيَوْمِ الْآخِرِ وَمَنْ يَكُنِ الشَّيْطَانُ لَهُ قَرِينًا فَسَاءَ قَرِينًا

***"Edhe ata që shpenzojnë nga pasuria e tyre sa për sy e faqe të botës, e nuk besojnë në Allahun as në Ditën e mbrëmë. E ai që e zgjedh shejtanin shok, sa shok i tmerrshëm është ai."***[16]

Në qoftë se dëshirojmë ta kuptojmë drejt, atëherë duhet ta dimë se pasuria, siç u potencua më sipër, është dhuratë e Zotit, me të njeriu është në sprovë: do ta fitoj Xhenetin apo Xhehenemin? Prandaj, është në dorën e njeriut të zgjedh: e donë Zotin dhe fenë e Tij, apo e donë lavdërimin para njerëzve në këtë botë?!

[15] Es Sexhde, 14.

[16] En Nisa, 38.

Pejgamberi a.s. na këshillon:

نِعْمَ ٱلْمالُ الصالِحُ فِي يَدِ رَجُلٍ صالِحٍ

*"Sa e mirë është pasuria e mirë në dorën e njeriut të mirë."*

## Në vend të përfundimit

Shpenzimi i pasurisë për qëllime bamirësie është, para së gjithash, zbatim dhe jetësim në praktikë i urdhrit të Allahut të Gjithëmëshirshëm. Kjo, jo vetëm që ndihmon të tjerët, por pasuron edhe shpirtin e atij që jep. Në një shoqëri ku njerëzit ndihmojnë njëri-tjetrin, sundon më shumë paqja, dashuria dhe drejtësia. Dhurata gjithmonë e rritë dashurinë dhe miqësinë në mes të njerëzve.

Pejgamberi a.s., me një rast, ka thënë:

مَا نَقَصَتْ صَدَقَةٌ مِنْ مَالٍ

*"Sadakaja nuk e pakëson pasurinë."*[17]

E, pra, nga ky hadith kuptohet qartë se njeriun duhet vlerësuar nga sa ai jep pasuri, e jo sa merr, sepse atë që e merr dhe e grumbullon, një ditë do ta lë krejtësisht dhe se në varr do të shoqërohet vetëm nga ajo që e ka dhënë.

Prandaj, shpenzimi i pasurisë në bamirësi gjithsesi se duhet të jetë jo vetëm një akt formal, por sinqeritet i vërtetë, një përkushtim që vjen nga zemra, me ndërgjegje, me dijeni dhe me besim. Le të kujtojmë se ne do të pyetemi për çdo pasuri që Allahu na ka dhënë: si e kemi shpenzuar, a e kemi përdorur për të mirë, apo...

[17] Transmeton Muslimi.

Pejgamberi a.s., në një hadith tregon duke thënë se me një rast më erdhi Xhibrili dhe më tha:

وَاعْمَلْ مَا شِئْتَ فَإِنَّكَ مُجْزِيٌّ بِهِ

*"...dhe puno ç'të duash por (dije se ti) do të japësh llogari për çdo gjë (në Ditën e Llogaridhënies)."*

Dijetarët na kanë lënë shembuj që virtyti nuk matet me madhësinë e pasurisë, por me sinqeritetin, koherencën dhe përkushtimin ndaj Allahut dhe ndaj njeriut.[18]

Siç u tha edhe më sipër, pasuria është një dhuratë që sjell përgjegjësi. Shpenzimi i saj në rrugën e Allahut dhe për dobi të njerëzve dhe të bashkësisë, është forma më e lartë e shprehjes së falënderimit ndaj Allahut të Gjithëpushtetshëm. Në një botë të përballur me varfëri, padrejtësi dhe vuajtje, bamirësia nuk është vetëm një vlerë morale, por një domosdoshmëri (urdhër nga Zoti) fetare dhe shoqërore. Le të jemi ndër ata që e përdorin pasurinë si mjet për ta fituar mëshirën e Allahut dhe si urë drejt Xhenetit, e jo si pengesë drejt tij.[19]

Për ta përmbyllur këtë temë kaq me rëndësi dhe me qëllim për të trokitur në ndërgjegjen, sidomos të atyre që Allahu iu ka dhënë pasuri, sjellim këtë ajet të Kuranit:

---

[18] Ekipi i Studimeve Akademike, *Udhërrëfyesi i një myslimani II*, Prizmi, 2010, Tiranë.

[19] Abdurrahman el Xhuzejri, "*Kitabul fik'hi alel medhahibil erbeati*", Darul Menar, Kajro.

لَن تَنَالُوا الْبِرَّ حَتَّى تُنفِقُوا مِمَّا تُحِبُّونَ وَمَا تُنفِقُوا مِن شَيْءٍ فَإِنَّ اللَّهَ بِهِ عَلِيمٌ

***"Kurrsesi nuk do të arrini devotshmërinë e vërtetë derisa të jepni nga ajo që e doni. Çfarëdo që të jepni, Allahu e di mirë atë."*** [20]

Dhe këtë hadith të Pejgamberit a.s.:

*"Dora që jep është më e mirë se sa ajo që merr."*

[20] Ali Imran, 92.

**Dr. Ejup HAZIRI**

# RËNDËSIA E QETËSISË (PUSHIMIT) NË NAMAZ

## Hyrje

Namazi ka një vlerë të madhe dhe të rëndësishme tek Allahu. Ai është lidhja kryesore mes robit dhe Krijuesit. Namazi konsiderohet shtylla e dytë e Islamit, menjëherë pas dëshmisë islame. Përveç që e ofron robin karshi Krijuesit të tij, ai e lartëson dhe e gradon atë, si dhe është njëri ndër adhurimet që ndikon në pastrimin nga gjynahet dhe në gradimin e robit në botën tjetër. Përgjegjësia e kryerjes së tij është jo edhe e vogël, ngase dihet se namazi do të jetë ndër pyetjet e para që do t'i bëhet robit në Ditën e Gjykimit.

Nga secili besimtar kërkohet që namazin ta kryejë në formën më të mirë të mundshme, me frikërespekt, me qetësi absolute, me përulje dhe me përkushtim të madh, përndryshe, nëse këto mungojnë, atëherë edhe namazi do të jetë i mangët.

## Çka nënkupton qetësia në namaz?

Qetësia në namaz do të thotë stabilitet dhe pushim në secilën prej shtyllave të namazit, veçmas në ruku dhe sexhde, derisa gjymtyrët e namazfalësit të jenë të qëndrueshme dhe në pozicionin e tyre të kërkuar.

Qetësia apo pushimi në namaz (الطمأنينة في الصلاة), nënkupton përkushtimin dhe qetësinë maksimale përgjatë namazit. *Et Tume'nineh* الطمأنينة , në kuptimin sheriatik nënkupton qetësinë e pjesëve trupore, ku secila pjesë e trupit duhet të pushojë në vendin e vet për aq sa bëhet së paku një madhërim.[1]

Qetësia apo pushimi në namaz kërkohet nga fillimi i namazit e deri në fund të tij, mirëpo kjo qetësi dhe pushim theksohet më tepër në ruku, gjatë ngritjes prej saj, në sexhde dhe gjatë pushimit mes dy sexhdeve, para se të kalohet në lëvizjen tjetër. Pra, në këto vende kërkohet që ne të jemi më tepër të kujdesshëm në namazet tona. Kjo në fushën e fikhut njihet si *ta'dilul erkan*, ku gjymtyrët e trupit pushojnë në ato pozicione derisa të kalohet në lëvizjen e radhës.[2]

Në praktikë, *tumanineh*-qetësia do të thotë të qëndrosh për një moment të shkurtër dhe të qetë në:

- **Ruku** (përkulja),
- **Qëndrimin pas rukusë,**
- **Sexhde,**
- **Uljen mes dy sexhdeve.**

---

[1] El Xhuzejri, *El fikhu ale-l medhahibi-l erbeah*, v.I, f.212; Buhuti, *Munteha-l Iradat*, v. I, f. 217. Zejleiu në"Tebjinu-l Hakaik sherh Kenzud Dekaik ve Hashijetush Shilbij," bot. I-rë, El Matbeatu-l Kubra el Emirijeh, Kajro, 1313h, v. I, f. 277.

[2] Ibën Abidin, *Reddu-l Muhtar ale-d Durri-l Muhtar,* bot. II-të, Daru-l Fikër, Bejrut-Liban, 1412-1992, v. I, f. 464.

# Pse është qetësia-pushimi i rëndësishëm në namaz?

## 1. Pushimi është obligim-vaxhib

Qetësia (pushimi) në namaz (ruku e sexhde) konform medhhebit hanefi është vaxhib, së paku sa një madhërim që bëhet.[3] Kur themi së paku sa një madhërim, është për qëllim minimumi, që edhe pse lejohet, nuk preferohet një gjë e tillë, ngase si në ruku, ashtu edhe në sexhde, duhet të bëhen tri madhërime, ashtu siç njihet botërisht kjo çështje. Sikurse qetësia, gjegjësisht pushimi në ruku, ashtu edhe në sexhde është e njëjta dispozitë.

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا ارْكَعُوا وَاسْجُدُوا وَاعْبُدُوا رَبَّكُمْ ...﴿٧٧﴾

***"O ju që besuat, falni namazin me ruku e sexhde dhe vetëm Zotin tuaj adhurojeni…"***[4]

Urdhri për ruku dhe sexhde është i përgjithshëm. Rukuja nënkupton një përkulje, përderisa sexhdeja një rënie dhe ulje. E kur namazfalësi përkulet (në ruku) dhe ulet (në sexhde), atëherë ai veç ka respektuar dhe konkretizuar atë që e nënkupton emërtimi (ruku dhe sexhde).[5]

---

[3] Samerkandi, *Tuhfetu-l Fukaha,* bot. II-të, Daru-l Kutub el Ilmijetu, Bejrut-Liban, 1414-1994, v. I, f.133; Kasani, *Bedaius Sanaiu fi tertibish sherai*, bot. II-të, Daru-l Kutub el Ilmijetu, Bejrut-Liban, 1406-1986, v. I, f. 342; El Babertij, *El Inajeh sherhul Hidajeh*, pa vit dhe vend botimi, Darul Fikër, v. I, f. 300.

[4] El Haxh, 77.

[5] Kasani, *Bedaius Sanaiu*, v. I, f. 509.

## 2. Tregon përulësi dhe respekt ndaj Allahut

Njeriu që falet me qetësi dhe përkushtim, tregon dashuri dhe nënshtrim të sinqertë ndaj Krijuesit. Përkushtimi në namaz është një nga cilësitë më të larta shpirtërore që një besimtar mund të arrijë. Ai nënkupton praninë e zemrës, mendjes dhe shpirtit gjatë faljes, duke e bërë atë një akt të thellë adhurimi dhe lidhjeje të sinqertë me Zotin. Përkushtimi në namaz është gjendja kur njeriu shkëputet nga jeta e përditshme dhe çdo gjë tjetër, vetëm e vetëm për t'u përqendruar plotësisht te Zoti i tij. Është një çast reflektimi, qetësie dhe dorëzimi i plotë. Zemra mbushet me përulësi, ndërsa mendja pastrohet nga hutimi dhe përqendrohet vetëm në madhështinë dhe mëshirën e Allahut.

Besimtari që falet me përkushtim, e ndien çdo fjalë që shqiton, e përjeton çdo lëvizje dhe e shijon afërsinë me Krijuesin. Ai nuk e sheh namazin si një detyrë të zakonshme, por si një takim të shenjtë që i jep paqe, forcë dhe drejtim në jetë.

## 3. Nxit përqendrimin (khushuu') në namaz

Lëvizjet e shpejta e bëjnë namazin të duket si një ushtrim fizik, ndërsa qetësia ndihmon në lidhjen shpirtërore me Allahun.

Përulësia dhe përkushtimi i zemrës (*khushu*) është shpirti i vërtetë i adhurimit. Është ajo ndjenjë thellësisht shpirtërore kur një besimtar qëndron përballë Allahut me nënshtrim, përulësi dhe dashuri të sinqertë. Pa *khushu*, namazi mund të bëhet thjesht një ushtrim fizik, ndërsa me të, namazi bëhet një lidhje e gjallë dhe e fuqishme me Zotin.

*Khushu* është gjendja e përqendrimit të zemrës dhe trupit në namaz, ku çdo mendim tjetër largohet dhe zemra mbushet me vetëdijen se je përballë Allahut. Është kur syri ulet, zemra përkulet, dhe trupi ndjek me bindje çdo lëvizje të namazit. Allahu i Madhëruar, në lidhje me këtë, thotë:

قَدْ أَفْلَحَ الْمُؤْمِنُونَ ﴿١﴾ الَّذِينَ هُمْ فِي صَلَاتِهِمْ خَاشِعُونَ ﴿٢﴾

***"Është e sigurt se kanë shpëtuar besimtarët: ata të cilët janë të përulur dhe janë të kujdesshëm gjatë faljes së namazit."***[6]

Pra, shpëtimi i besimtarit është shumë i ndërlidhur me praninë e tij shpirtërore në namazin e tij dhe me përkushtimin e tij maksimal ndaj adhurimit që bën.

## 4. Është sunet i Pejgamberit Muhamed a.s.

I Dërguari i Allahut a.s. e falte namazin me qetësi dhe urdhëroi të tjerët ta kryejnë namazin sikurse ai falej. Zaten ai i porosiste të tjerët që të falen ashtu siç ai falej, andaj edhe thoshte: ***"Faluni ashtu siç më keni parë duke u falur!"***[7]

Ai falej ngadalë, duke ia dhënë hakun secilës pjesë të namazit, si rukusë, ashtu edhe sexhdes, por edhe pjesëve të tjera, duke u falur në mënyrën më të mirë të mundshme, pa u ngutur, me frikërespekt dhe me përqendrimin më të madh.

Ai kur shihte dikë që falej pa përkushtim, e këshillonte që namazin ta përsëriste dhe ta kuptonte drejt se namazi është

---

[6] El Muminune, 1-2.

[7] Buhariu në Sahih, nr.6008; Muslimi në Sahih, nr. 674.

përkushtim dhe kërkohet përqendrim maksimal në të, ashtu siç ka ardhur në hadithin e njohur si keqfalësi i namazit:

أَنَّ النَّبِيَّ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ دَخَلَ المِسْجِدَ، فَدَخَلَ رَجُلٌ، فَصَلَّى، ثُمَّ جَاءَ، فَسَلَّمَ عَلَى النَّبِيِّ صلّى الله عليه وسلم فَرَدَّ النَّبِيُّ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ عَلَيْهِ السَّلاَمَ، فَقَالَ: «ارْجِعْ فَصَلِّ فَإِنَّكَ لَمْ تُصَلِّ»، فَصَلَّى، ثُمَّ جَاءَ، فَسَلَّمَ عَلَى النَّبِيِّ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ فَقَالَ: «ارْجِعْ فَصَلِّ، فَإِنَّكَ لَمْ تُصَلِّ» ثَلاَثًا، فَقَالَ: وَالَّذِي بَعَثَكَ بِالحَقِّ، فَمَا أُحْسِنُ غَيْرَهُ، فَعَلِّمْنِي، قَالَ: «إِذَا قُمْتَ إِلَى الصَّلاَةِ، فَكَبِّرْ، ثُمَّ اقْرَأْ مَا تَيَسَّرَ مَعَكَ مِنَ القُرْآنِ، ثُمَّ ارْكَعْ حَتَّى تَطْمَئِنَّ رَاكِعًا، ثُمَّ ارْفَعْ حَتَّى تَعْتَدِلَ قَائِمًا، ثُمَّ اسْجُدْ حَتَّى تَطْمَئِنَّ سَاجِدًا، ثُمَّ ارْفَعْ حَتَّى تَطْمَئِنَّ جَالِسًا، ثُمَّ اسْجُدْ حَتَّى تَطْمَئِنَّ سَاجِدًا، ثُمَّ افْعَلْ ذَلِكَ فِي صَلاَتِكَ كُلِّهَا»

*"I Dërguari i Allahut a.s. hyri në xhami. Pastaj hyri një njeri u fal dhe erdhi e përshëndeti të Dërguarin e Allahut. I Dërguari ia ktheu selamin dhe i tha:* **"Kthehu dhe falu përsëri, sepse ti nuk je falur** *(siç duhet)!" Ai u fal dhe erdhi tek i Dërguari i Allahut, të cilin e përshëndeti me selam. I Dërguari i Allahut i tha përsëri:* **"Kthehu dhe falu përsëri, sepse ti nuk je falur** *(siç duhet)!" Kështu i tha tri herë, ndërsa ai ia ktheu: "Pasha Atë që ty të dërgoi me të vërtetën, nuk di përveç asaj mënyrë (që u fala), prandaj më mëso." I Dërguari i Allahut i tha:* **"Kur të hysh për namaz, shqiptoje tekbirin, pastaj lexo diç nga Kurani që të vjen më lehtë, e më pas shko në ruku derisa** *(gjymtyrët*

*e trupit)* ***të qetësohesh plotësisht, pastaj ngrihu*** *(nga rukuja)* ***derisa të drejtohesh plotësisht, e më pas lëshohu për në sexhde derisa të qetësohesh*** *(e të drejtohesh)* ***plotësisht. Ngrihu nga sexhdeja dhe qëndro ulur derisa të drejtohesh plotësisht, e më pas lëshohu prapë për në sexhde derisa të qetësohesh*** *(e të drejtohesh)* ***plotësisht, e kështu vepro gjatë tërë namazit."***[8]

I Dërguari i Allahut e pa këtë person teksa falej dhe namazi i tij çalonte, andaj pasi që ai e përfundonte namazin, i thoshte ta përsëriste atë, sepse namazi i tij nuk ishte në rregull. Njeriu u fal tri herë, ashtu siç dinte të falej, por i Dërguari i Allahut vërente diçka nga namazi i tij. Ndoshta njeriu e falte shpejt namazin, ndoshta rukunë dhe sexhden nuk i bënte siç duhej, ndoshta ishte i pakujdesshëm ndaj namazit të tij, andaj edhe i Dërguari i Allahut i thoshte të kthehej edhe një herë, sepse nuk ishte falur si duhet.

Refuzimi që i Dërguari i Allahut a.s. i bëri namazit të personit në fjalë, duke mos e ndërprerë namazin e tij, por duke e urdhëruar që të falej përsëri, ku ai falej dhe vinte prapë tek i Dërguari, e ky ia refuzonte faljen dhe e urdhëronte që prapë ta përsëriste, mund të ketë disa mundësi:

*E para*: Ndoshta njeriu ishte i pakujdesshëm ndaj veprimit të tij apo mund të ketë harruar disa veprime të namazit, andaj i Dërguari i Allahut në mënyrë të përshkallëzuar deshi ta informojë atë dhe ta largojë pakujdesinë e tij. Në këtë mënyrë i Dërguari i Allahut a.s. mund ta ketë zgjedhur një

[8] Buhariu në Sahih, nr. 793; Muslimi në Sahih, nr. 602.

rrugë mësimi, pa i thënë se vepro kështu e kështu, por përmes refuzimit t'ia kujtoj atij veprimet e namazit.

*E dyta*: Refuzimi i namazit të tij mund të jetë edhe si shkak i madhështisë së namazit, duke u munduar ta zgjojë mprehtësinë nga namazfalësi, gjersa kishte kohë nga kalimi i kohës së namazit.[9]

## Qetësia prej ngritjes nga rukuja dhe mes dy sexhdeve

Për dallim nga rukuja dhe sexhdeja, në të cilat është vaxhib qetësia në to (Ebu Jusufi mendon se qetësia në ruku dhe sexhde është farz), gjatë ngritjes prej saj dhe pushimi mes dy sexhdeve, qetësia konsiderohen sunet, gjë që ndryshon nga rukuja dhe sexhdeja. Edhe pse pushimi prej ngritjes nga rukuja dhe mes dy sexhdeve konsiderohet sunet, kjo assesi nuk nënkupton që duhet ta braktisim qetësinë në këto dy vende.

Në lidhje me këtë, Merginani, ka thënë: *"...Pushimi nga ngritja prej rukusë dhe pushimi mes dy sexhdeve konsiderohet sunet te te dytë (Ebu Hanife dhe Muhamedi)."*[10] Ngjashëm me këtë shprehet edhe autori i *"El Bahrurr Rraik"*, kur thotë: *"Pushimi në ngritjen prej rukusë dhe mes dy sexhdeve*

---

[9] Ibën Haxher el Askalani, *Fet'hu-l Bari sherh Sahihi-l Buhari*, v. II, f. 281.

[10] Merginani, *El Hidajeh sherh Bidajetu-l Mubtedi'*, me recensim të Ahmed Xhad, Darul Hadith, Kajro-Egjipt, v. I, f. 85.

*është sunet tek Ebu Hanife dhe Muhamedi, e kjo është çështje kompaktuale.”*[11]

Në anën tjetër, Ebu Jusufi, është i mendimit se qetësia në namaz gjatë ngritjes prej rukusë dhe mes dy sexhdeve është farz. Mendimi i tij për qetësinë në këto dy vende të namazit është i njëjtë sikurse në dy vendet paraprake, ruku dhe sexhde. Në këtë kontekst, autori i *“El Hidaje”*, shprehet: *“Ebu Jusufi parasheh që, (pushimi) në të gjitha këto vende është farz. Opinioni i tij është sikurse opinioni i Shafiut.”*[12] Sipas Ebu Jusufit, lënia e ngritjes prej rukusë apo pushimi mes dy sexhdeve, e prish namazin, për dallim nga Ebu Hanife dhe Muhamedi.[13]

Nuk ka dyshim se çështja e qetësisë apo pushimit në namaz është e një rëndësie të posaçme, sepse namazi nuk është lodhje, por çlodhje. Në çdo pjesë të namazit duhet pasur kujdes dhe nuk duhet përshpejtuar, e në këto katër vende që i kam shpjeguar, kujdesi duhet të jetë edhe më i madh. Kjo për faktin se për shkak të lëvizjeve nëpër ato vende, një pjesë e namazfalësve janë totalisht të pakujdesshëm, si në ruku dhe në ngritjen prej saj, ashtu edhe në sexhde dhe në pushimin mes tyre.

---

[11] Ibën Nuxhejmi, *El Bahrurr Rraik sherh Kenzud Dekaik*, bot. II-të, Darul Kitab el Islamij, v. I, f. 317.

[12] Merginani, El Hidajeh sherh Bidajetu-l Mubtedi’, v. I, f.84.

[13] Ahmed ibën Ismail et Tahtavi, *Hashijetut Tahtavi ala Meraki-l Felah sherh Nuru-l Idah*, El Matbeatul Kubra el Emirijetu, Bulak-Egjipt, 1318, f. 233.

## Si ta praktikosh qetësinë në namaz?

- Shko në ruku ngadalë, qetë dhe pa u ngutur, si dhe thuaj qetësisht "Subhane Rabbijel Adhim",
- Pas rukusë, qëndro drejt dhe thuaj: "Rabbena lekel hamd" me qetësi,
- Në sexhde, thuaj: "Subhane Rabbijel A'la" me përqendrim dhe përkushtim,
- Mos e bëj namazin si një garë shpejtësie, por si një takim të shenjtë dhe shumë të rëndësishëm me Allahun.

## Çfarë ndodh nëse mungon qetësia në namaz?

- Në rast se qetësia dhe përqendrimi i namazfalësit mungojnë, atëherë namazi mund të jetë i pavlefshëm, ose së paku shpërblimi i namazit mund të mungojë. Qetësia nuk është opsionale, ajo është shtyllë e vlefshmërisë së namazit. Qetësia dhe përkushtimi janë thelb i adhurimit, e jo detaje anësore.
- Njeriu humb dobitë shpirtërore të namazit. Që të përfitojmë nga namazi, ai duhet falur me qetësi, përqendrim dhe përulësi. Kur humbet qetësia dhe përkushtimi, dobitë shpirtërore të namazit zvogëlohen ose humbasin fare. Realisht, në momente të tilla, falja shpesh kryhet me nxitim dhe pa qetësi, pa përkushtim të duhur në ruku dhe sexhde. Lëvizjet mund të jenë të pamatura dhe të çrregullta, duke munguar përqendrimi i zemrës dhe i mendjes. Si pasojë, ndodh që njeriu të falet vetëm në mënyrë formale, ndërsa mendja e tij të jetë e shpërqendruar dhe e zhytur në çështje të tjera jashtë namazit.

Kjo tregon mungesë respekti ndaj madhështisë së këtij adhurimi. Namazi është takimi më i madh ditor ndërmjet njeriut dhe Allahut. Është kulmi i adhurimit dhe përuljes, prandaj kërkon respekt të plotë - me trup, mendje dhe zemër.

- Namazfalësi qëndron përballë Allahut dhe ka hyrë në namaz me emrin e Allahut të Madhërishëm, që simbolizon se ai është lidhur me Allahun dhe çdo gjë tjetër përveç Tij, është e pavlefshme.
- Nuk arrihet qëllimi i namazit. Mungesa e qetësisë është ajo që pengon arritjen e qëllimit të namazit, sepse namazi pa qetësi bëhet i nxituar dhe sipërfaqësor; zemra nuk merr pjesë në adhurim, por vetëm trupi; shpërqendrimi e dobëson ndikimin e namazit në jetën reale.

## Si ta arrish qetësinë dhe përqendrimin më të mirë në namaz?

**Pastroje qëllimin** - Kujtoje veten se po falesh për Allahun, jo për rutinë. Pastrimi i qëllimit (nijetit) do të thotë që namazin ta falësh vetëm për Allahun, me vetëdije të plotë se Ai po të sheh. Ti po qëndron përballë Tij dhe se Ai është i vetmi që e meriton adhurimin tënd.

**Kupto fjalët që lexon në namaz** - Kjo rrit vetëdijen dhe lidhjen me çdo fjalë që shqipton.

Kuptimi i fjalëve që shqipton në namaz është një nga mënyrat më të fuqishme për të arritur përqendrim dhe qetësim në namaz, për lidhje të fuqishme shpirtërore me Allahun dhe njëherazi një veprim i tillë është dashuri dhe respekt për adhurimin tënd që e bën.

**Ngadalëso lëvizjet dhe zërin** - Mos nxito, jepi kohë çdo pjese të namazit. Namazi nuk është thjesht një sërë lëvizjesh fizike, ai është bisedë e qetë dhe përulëse me Krijuesin e Plotfuqishëm. Prandaj, ngadalësimi i lëvizjeve dhe zërit është mënyra më e mirë për ta bërë namazin të gjallë, aktiv dhe të dobishëm.

**Lutu me zemër, jo thjesht me gjuhë** - Bëje lutjen reale, si një bisedë me Zotin tënd. Kur lutemi në namaz, duhet ta bëjmë me zemër të përulur dhe të vetëdijshme, jo vetëm me gjuhë që shqipton fjalë pa ndjenja. Namazi është përjetim dhe duhet të përjetohet me tërë qenien.

**Ndërro mendimin për namazin** - Mos e shiko si detyrë, por si kënaqësi dhe takim personal me Allahun. Shumë njerëz e shohin namazin si një detyrë të vështirë, një përgjegjësi që thjesht duhet "kryer". Por, e vërteta është se namazi është një dhuratë nga Allahu, dhe jo një barrë.

Namazi është çasti kur i hedh poshtë të gjitha shqetësimet e kësaj bote dhe i dorëzohesh Atij që kontrollon çdo gjë. Namazi është takim me Allahun pesë herë në ditë. Në çdo namaz, ti ngrihesh përballë Zotit të gjithësisë. S'ka takim më të madh.

## Përfundimi

Qetësia në namaz është zemra e adhurimit, është ajo që e dallon një namaz të gjallë nga një lëvizje boshe. Nuk është thjesht ndalesë fizike, por një ndjenjë e thellë përulësie, pranimi dhe afërsie me Allahun. Në namaz, trupi qëndron i qetë, pa nxitim dhe pa ngutje; zemra është e lidhur me Krijuesin, pa shpërqendrime dhe shpërfytyrime; fjalët shqiptohen me ndjenja dhe përjetime, e jo pa menduar rreth tyre.

Qetësia në namaz është ajo që i jep vlerë çdo rukuje, çdo sexhdeje, çdo fjale, secilës lëvizje dhe çdo lutjeje. Pa të, namazi është si një trup pa shpirt. Me të, namazi bëhet dritë, mburojë dhe pastrim për shpirtin. Namazi pa qetësi është si një letër pa fjalë, një takim pa përqendrim, një adhurim pa jetë. Po,r kur falesh me qetësi, zemra flet, mendja përqendrohet dhe shpirti përjeton afërsinë me Allahun.

Namazi është përjetim, përndryshe nëse nuk përjetohet me zemër dhe shpirt, mbetet i ngurtë dhe i pakuptimtë. Prandaj, për të qenë namazi në nivelin e duhur, qetësia dhe përkushtimi janë të domosdoshme.

**Dr. Muhamed STUBLLA**

# ROLI I KOHËS NDËRMJET LLOGARITJES KALENDARIKE DHE ADHURIMEVE

Një ndër gjërat më të vlefshme që posedon njeriu është *koha.* Prandaj, aq sa është e rëndësishme jeta, po aq e rëndësishme është edhe koha. Kush e ka shfrytëzuar kohën, e ka shfrytëzuar jetën, ndërsa kush e ka humbur kohën, e ka humbur dhe nuk e ka shijuar jetën. Përdorimi i drejtë i kohës kushtëzohet me orientimin e saj në përputhje me mësimet e Zotit dhe porositë pejgamberike. Përndryshe, rezultati i llogaridhënies për kohën nuk mund të jetë i këndshëm. Koha që kalon nuk kthehet më kurrë, ajo shpenzohet njësoj si fryma e harxhuar. Çdo gjë tjetër mund të kompensohet, qoftë ajo pasuria, shëndeti apo edhe shumë procese të tjera, por *jo edhe koha-jeta.* Dëshmia më e mirë për këtë është hadithi i Resulullahut a.s., në të cilin ka thënë:

قَالَ رَسُولُ اللهِ ﷺ: لَا تَزُولُ قَدَمَا عَبْدٍ يَوْمَ الْقِيَامَةِ حَتَّى يُسْأَلَ عَنْ عُمُرِهِ فِيمَ أَفْنَاهُ...

*"Nuk do të lëvizë këmba e njeriut në Ditën e Kiametit derisa të pyetet për jetën e tij, se si e ka kaluar..."*[1]

---

[1] Et Tirmidhij, Muhamed ibën Isa, *El Xhamia el Kebir Sunen et Tirmidhij*, (Bejrut, Dar el Garb el Islami. 1996), 4/217. Hadith hasen es sahih, i sakt.

Njeriu nuk do të mund të largohet nga vendi i llogaridhënies pa u pyetur për kohën dhe mënyrën se si e ka shfrytëzuar atë. Ai e planifikon jetën e vet, dhe ky planifikim nuk mund të jetë i suksesshëm pa planifikimin e drejtë të kohës. Njeriu, sa më mirë ta menaxhojë dhe zhvillojë jetën e tij, aq më e ndritur do të jetë e ardhmja dhe jeta e tij në këtë dhe botën tjetër. Ibën Omeri r.a., ka thënë:

إِذَا أَمْسَيْتَ، فَلَا تَنْتَظِرِ الصَّبَاحَ، وَإِذَا أَصْبَحْتَ فَلَا تَنْتَظِرِ الْمَسَاءَ.

وَخُذْ مِنْ صِحَّتِكَ لِمَرَضِكَ، وَمِنْ حَيَاتِكَ لِمَوْتِكَ.

*"Kur të biesh në gjumë, mos e prit mëngjesin, dhe kur të zgjohesh, mos e prit mbrëmjen. Shfrytëzo shëndetin para se të sëmuresh dhe jetën para se të të vijë vdekja."*[2]

Për shkak të rëndësisë së madhe që ka koha, Zoti xh.sh., e ka përmendur atë shumë herë në forma të ndryshme. Nga një hulumtim i shkurtër kuptohet se Zoti xh.sh., në Kuran, përdor shprehje që lidhen me kohën më shumë se *850 herë.* Ndër termat më të përdorur janë: *dita* dhe sinonimet e saj, *nata, mëngjesi, mbrëmja, koha, viti, muaji, stina, afati kohor* dhe *momenti.* Allahu xh.sh. *betohet në kohën në nëntë vende në Kuran.* Kjo është dëshmi e qartë se Zoti xh.sh. e vlerëson jashtëzakonisht shumë kohën, përndryshe, nuk do të betohej në të. Koha është një *mirësi e madhe.* Ibën Abasi r.a., ka transmetuar se Pejgamberi a.s., ka thënë:

[2] El Buhari, Muhamed ibën Ismail, *Sahih el Buhari*, (Damask, Dar Ibën Kethir dhe El Jemameh, 1993), 5/2358.

عَنِ ابْنِ عباس رضي الله عنهما قَالَ :قَالَ النَّبِيُّ ﷺ: نِعْمَتَانِ مَغْبُونٌ فِيهِمَا كَثِيرٌ مِنَ النَّاسِ: الصِّحَّةُ وَالْفَرَاغُ

*"Dy begati, shumë prej njerëzve nuk i vlerësojnë derisa t'ju mungojnë: shëndetin dhe kohën e lirë."*[3]

Shembulli më i përsosur në të gjitha aspektet e jetës është *Pejgamberi Muhamed a.s..* Ai e organizonte dhe e shfrytëzonte kohën në mënyrën më të mirë, pa e humbur kot asnjë çast. Aisheja r.a., kur e ka shpjeguar jetën e *Muhamedit a.s., pati thënë se ai e përmendte Allahun në çdo gjendje dhe se asnjëherë nuk ishte i pavëmendshëm ndaj madhërimit të Zotit.* Megjithatë, disa kohë i dallonte nga të tjerat, në disa ndalonte namazin vullnetar, në disa pushonte apo flinte, ndërsa në disa shtonte adhurimin. Ai agjëronte, por edhe ushqehej; kujdesej për familjen dhe shoqërohej me sahabët, i këshillonte dhe i mësonte ata. Pejgamberi a.s. e *shfrytëzonte kohën në mënyrën më të vlefshme dhe të balancuar.* Në këtë rrugë ecën edhe shokët e tij. Për një periudhë shumë të shkurtër, ata arritën ta stabilizojnë dhe ta zgjerojnë shtetin islam, të vendosin drejtësinë dhe ta përhapin dritën hyjnore. Kjo arritje e madhe u realizua në pak vite, sepse ata ishin thellësisht të përkushtuar në *devotshmëri, dije dhe punë.* Ata edukuan breza të tërë dhe përparuan në aspektin shpirtëror dhe shkencor, në një mënyrë që nuk ishte parë më parë. Për disa nga asketët e brezave të hershëm është thënë: *Nëse do t'u thuhej: Nesër do të vdisni, ata nuk do të kishin çfarë të shto-*

---

[3] El Buhari, *Sahih el Buhari*, 5/2357.

*nin në veprat e tyre të mira.*[4] Kjo sepse ata e jetonin çdo ditë sikur të ishte dita e fundit e jetës së tyre. Nëse edhe ne e shfrytëzojmë kohën me këtë vetëdije, duke menduar se kjo është mundësia jonë e fundit, do të arrijmë suksese më të mëdha se ata që kanë kohë, apo jetë më të gjatë. Nëse e shikojmë historinë fetare, letrare dhe shkencore, vërejmë se shumë personalitete të mëdha nuk kanë jetuar gjatë, por kanë lënë pas një *kontribut të jashtëzakonshëm.* Arsyeja është e qartë, ata *e kanë shfrytëzuar kohën me kujdes, disiplinë dhe vetëdije të lartë.* Mënyra se si njeriu e shfrytëzon kohën është *tregues i lidhjes së tij me Zotin* dhe i shkallës së dashurisë hyjnore ndaj tij. Kur Zoti të përdorë për punë të mira, Ai dëshiron të të pastrojë. Pavarësisht se sa të kujdesshëm jemi në shfrytëzimin e kohës, gjithmonë ekziston *hapësirë për përmirësim dhe organizim më të mirë* të saj dhe, të jetës sonë në përgjithësi. Për të përparuar në menaxhimin e kohës, duhet ta *ndryshojmë mënyrën e organizimit* të saj. Nuk është e mundur që të përdorim të njëjtën formë të shfrytëzimit dhe të presim rezultate më të mira. Zoti xh.sh. thotë:

﴾...إِنَّ اللَّهَ لَا يُغَيِّرُ مَا بِقَوْمٍ حَتَّىٰ يُغَيِّرُوا مَا بِأَنفُسِهِمْ...﴿

***"Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli derisa ai popull të mos e ndryshojë vetë gjendjen e tij."*** *(Er Rrad, 1).*

[4] El Malikij, Ahmed ibën Mervan, El Mexhelisetu ve Xhevahir el Ilm, (Bharejn, Xhemijetu Et Terbijetu El Islamijeh/ Bejrut, Dar Ibën Hazëm, 1997) 1/197.

# Roli i kohës në saktësinë dhe pranueshmërinë e adhurimeve

Islami përbëhet prej dy komponentëve themelorë: Komponenti shpirtëror, që lidhet me besimin (imanin), i cili duhet të jetë gjithmonë i pranishëm, i shëndoshë dhe i qëndrueshëm në zemrën e çdo besimtari dhe komponenti praktik, që përfshin adhurimet - kushtet e Islamit. Përveç dëshmisë së besimit (shahadetit), të gjitha adhurimet e tjera janë të përcaktuara dhe të lidhura me intervale të caktuara kohore.

- Namazi, që është një ndër detyrimet më qendrore dhe të përditshme të besimtarit, përfaqëson një formë të vazhdueshme të lidhjes hyjnore. Ai falet në intervale të përcaktuara kohore, pesë herë në ditë.

Përmes këtij adhurimi, besimtari ruhet nga mëkatet dhe veprat e këqija. Në rast se njeriu bie në gabime, namazi shërben si mekanizëm pastrimi shpirtëror, që e pastron zemrën nga njollat e mëkatit, ashtu sikurse uji që e pastron trupin nga ndotjet. Është me rëndësi të theksohet se namazi është i vetmi adhurim që iu bë obligim Pejgamberit a.s. në qiell, gjatë ngjarjes së Israsë dhe Miraxhit. Kjo tregon madhështinë dhe lartësinë që e arrin njeriu përmes faljes së namazit. Megjithatë, pavarësisht nga shkalla e obligueshmërisë, rëndësisë dhe ndikimit të namazit, ai mbetet i detyrueshëm vetëm brenda intervaleve të caktuara kohore. Koha është kriteri themelor për vlefshmërinë e tij. Zoti xh.sh., në Kuranin fisnik, ka përcaktuar kufijtë kohorë të faljes së namazit, dhe këta kufij nuk mund të ndryshohen përveçse me një tekst të ngjashëm në rrugën e transmetimit dhe qartësisë së shprehjes. Allahu xh.sh. thotë:

﴿... إِنَّ الصَّلاَةَ كَانَتْ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ كِتَابًا مَوْقُوتًا﴾

*"Vërtet, namazi është obligim për besimtarët në kohën e caktuar." (En Nisa, 103).*

Në anën tjetër, Zoti xh.sh. na ka urdhëruar që të jemi ***të vëmendshëm dhe të kujdesshëm,*** duke mos e vonuar apo shtyrë namazin ***jashtë kohës së tij të përcaktuar.*** Falja e namazit brenda kohës është ***shenjë e disiplinës shpirtërore dhe e sinqeritetit në adhurim,*** ndërsa vonimi i tij pa arsye të justifikuar përbën ***neglizhencë ndaj obligimit hyjnor.*** Allahu xh.sh. thotë:

﴿فَوَيْلٌ لِلْمُصَلِّينَ. الَّذِينَ هُمْ عَنْ صَلاتِهِمْ ساهُونَ﴾

***"Shkatërrim është për ata që falen, të cilët ndaj namazit të tyre janë të pakujdesshëm."*** *(El Maun, 4–5).*

Ajetet e Kuranit janë fjalë të Allahut, dhe çdo fjalë e Tij mbart shumë kuptime. Një nga kuptimet e këtij citati është *paralajmërimi për një përfundim të keq për ata që falen jashtë kohës së përcaktuar.*[5] Prandaj, namazi nuk pranohet dhe nuk lejohet të falet jashtë kohës së vet. Po ashtu, nuk lejohet bashkimi i dy namazeve në një kohë. Namazi mund të falet në fillim të kohës ose të vonohet deri në afërsi të përfundimit të saj, por jo përpara dhe as pas saj. Të gjitha transmetimet që duket se e lejojnë faljen e namazit jashtë kohës së përcaktuar, nuk janë më të fuqishme se ajetet e Kuranit, sepse shumë prej tyre mund të interpretohen në më shumë se një mënyrë. Kuptimi i tyre duhet të harmonizohet me tekstin kuranor, pasi shpallja kuranore dhe hadithet profetike kanë të njëjtin burim, Allahun xh.sh.. Natyrisht dhe pa asnjë diskutim, nuk

---

[5] Ebu el Hasen, Mukatil ibën Sulejman, *Tefsir Mukatil ibën Sulejman*, (Bejrut, Dar Ihja et Turath. 1423 h.) 4/871.

mund të ketë kundërthënie në mes të fjalës të së Gjithëdijshmit. Veçanërisht, nëse këtë e vërtetojnë edhe hadithet autentike që tregojnë se Pejgamberi a.s. e ka falur çdo namaz vetëm në kohën e vet. Në shumë koleksione të hadithit gjendet transmetimi i njohur nga ceremonia e haxhit, ku njëri prej sahabëve më të afërt dhe ndër të parët që i besuan Muhamedit a.s., ka thënë: "Pejgamberi a.s. nuk i ka bashkuar kurrë namazet, përveçse në Arafat, ku drekën dhe ikindinë i fali në kohën e drekës, dhe në Muzdelife, ku akshamin e fali bashkë me jacinë."[6] Ky bashkim nuk lidhet me udhëtimin, por me rregullat e veçanta të ceremonisë së haxhit, sepse edhe banorët e Mekës, të cilët nuk ishin udhëtarë, kanë vepruar në të njëjtën mënyrë. Pra, namazi falet vetëm në kohën e përcaktuar nga Allahu xh.sh..

- Zekati, kushti i dytë i Islamit, adhurim shpirtëror dhe material.

Ai përfaqëson harmoninë ndërmjet shpirtit dhe trupit, duke reflektuar natyrën e krijimit të njeriut, i cili është formuar nga materia dhe shpirti. Kjo përputhje dëshmon për përsosmërinë absolute të Islamit, i cili e trajton njeriun si një qenie të plotë, duke i dhënë rëndësi si dimensionit shpirtëror, ashtu edhe atij material. Allahu xh.sh. thotë:

﴿خُذْ مِنْ أَمْوَالِهِمْ صَدَقَةً تُطَهِّرُهُمْ وَتُزَكِّيهِمْ بِهَا...﴾

***"Merr nga pasuria e tyre zekat, që t'i pastrosh dhe t'i begatosh me të."*** *(Et Tevbe, 103).* Përmes zekatit arrihet këna-

[6] Muslim, Muslim ibën el Haxhaxh, *Sahih Muslim* (Turqi, Dar et Tibaah el Amirah, 1334) 4/76. Ky është njëri nga tekstet e sakta që flasin për këtë temë.

qësia dhe shpërblimi i Dhuruesit, si dhe pastrohet pasuria dhe shpirti nga koprracia dhe lakmia. Dhurimi i zekatit është shprehje e mirënjohjes ndaj Allahut xh.sh. për mirësitë e shumta që Ai ia ka dhënë njeriut. Dhënia e zekatit nuk është vetëm një akt bamirësie, ajo është një formë e solidaritetit praktik me nevojtarët. Përmes tij, rritet respekti dhe dashuria mes njerëzve, shuhen apo zvogëlohen xhelozitë dhe pabarazia shoqërore. Sigurimi i jetesës së dinjitetshme për çdo individ është një obligim kolektiv në Islam, dhe për këtë arsye, feja nuk e ka lënë ndihmën ndaj të varfërve në dëshirën e individit, por e ka bërë detyrim të përcaktuar. Në aspektin fetar-juridik, zekati duhet të jepet në kohën e caktuar. Pra, zekati është i lidhur ngushtë me kohën, dhe dhënia e tij nuk është në vullnetin apo dëshirën e të pasurve. Ai bëhet obligim në momentin që pasuria e arrin nisabin dhe kalon një vit hixhri. Aisheja r.a. tregon se ka dëgjuar Resulullahun a.s., duke thënë:

عَنْ عَائِشَةَ، قَالَتْ: سَمِعْتُ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ يَقُولُ: لَا زَكَاةَ فِي مَالٍ، حَتَّى يَحُولَ عَلَيْهِ الحَوْلُ

*“Nuk ka zekat në pasuri derisa të kalojë një vit (hënor) mbi të.”*[7]

Pra, *zekati duhet të jepet çdo vit hënor,* nëse plotësohen kushtet e obligueshmërisë së pasurisë. Ky është një *konsensus ndër shekullor* që nga koha e Pejgamberit a.s..[8] Ky parim

[7] Ibën Maxheh, Muhamed ibën Jezid, *Sunen ibën Maxheh*, (Bejrut, Dar err Rrisaleh el Alemijeh, 2009) 3/112. Shejh Shuajbi, Allahu e mëshiroftë ka thënë: hadith sahih ligajrihi, i pranuar.

[8] Esh Shejbani, Muhamed ibën el Hasen, *El Alsel*, (Bejrut, Dar Ibën Hazëm, 2012) 2/92.

është i vlefshëm për arin, argjendin, të hollat, mallin tregtar dhe blegtorinë, ndërsa zekati i kulturave bujqësore jepet në kohën e vjeljes ose të korrjes. Allahu xh.sh., thotë:

﴿...كُلُوا مِن ثَمَرِهِ إِذَا أَثْمَرَ وَآتُوا حَقَّهُ يَوْمَ حَصَادِهِ﴾

***“Hani prej frutave të tyre*** *(kulturave bujqësore)* ***kurdo që të prodhojnë, dhe jepni atë që është detyrë në ditën e vjeljes së tyre!”*** *(El En’amë, 141).*

Pra, obligushmëria e zekatit është e ndërlidhur ngushtë me kohë.

- Agjërimi i Ramazanit, njëri nga kushtet e Islamit, konsiderohet një nga mundësitë dhe ofertat më të çmuara sezonale për besimtarin. Ai është një trajnim për shpirtin dhe trupin, pasi i pastron ato nga gjërat jo të mira që ndikojnë negativisht mbi to.

Agjërimi është një filtrues i dendur, që zgjat për një muaj, dhe besimtari nuk duhet të dalë prej tij përveçse i pastër nga çdo njollë shpirtërore dhe fizike. Ai përfshin ngjarje, kohë dhe mundësi të veçanta, të cilat ia shtojnë madhështinë muajit Ramazan. Synimi i agjërimit është që njeriu të kalitet, duke u larguar nga veprimet e ndaluara dhe duke u privuar për një kohë edhe nga disa gjëra, që zakonisht janë të lejuara. Agjërimi i Ramazanit duhet të rrisë ambiciet e besimtarit, duke e orientuar drejt sinqeritetit, vëmendjes ndaj veprave dhe devotshmërisë për hir të Allahut. Njëkohësisht, ai duhet të ndikojë në mirësjellje, duke bërë që besimtari të flasë dhe të veprojë vetëm mirë. Nëse këto objektiva nuk arrihen, atëherë agjërimi ka ngecje dhe nuk arrin të plotësojë ndikimin e tij shpirtëror dhe social. Njashtu, edhe pse agjërimi është kaq

madhështor, ai është i kufizuar në ditët e caktuara të muajit Ramazan. Allahu xh.sh., thotë:

﴿أَيَّامًا مَعْدُودَاتٍ ۚ فَمَنْ كَانَ مِنْكُمْ مَرِيضًا أَوْ عَلَىٰ سَفَرٍ فَعِدَّةٌ
مِنْ أَيَّامٍ أُخَرَ...﴾

*“(Agjëroni)* ***ditë të caktuara! E kush prej jush është i sëmurë ose në udhëtim*** *(dhe nuk agjëron),* ***atëherë le të agjërojë më vonë aq ditë…”*** *(El Bekare, 184).*

Ky ajet tregon se agjërimi është obligim, që ndërtohet mbi bazën kohore të caktuara. Allahu xh.sh. e ka bërë të qartë se ditët e agjërimit nuk janë të rastësishme, por përbëjnë një muaj hënor të plotë, gjatë të cilit besimtarët duhet të përmbushin këtë adhurim.

﴿شَهْرُ رَمَضَانَ الَّذِي أُنْزِلَ فِيهِ الْقُرْآنُ هُدًى لِلنَّاسِ وَبَيِّنَاتٍ مِنَ
الْهُدَىٰ وَالْفُرْقَانِ ۚ فَمَنْ شَهِدَ مِنْكُمُ الشَّهْرَ فَلْيَصُمْهُ ۖ...﴾

***“Muaji Ramazan është ai në të cilin*** *(filloi)* ***zbritja e Kuranit, që është udhërrëfyes për njerëzit dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues*** *(i të vërtetës nga gënjeshtra).* ***E kush prej jush e përjeton këtë muaj, le të agjërojë.”*** *(El Bekare, 185).*

Por, jo vetëm ditët të cilat përbëjnë muajin Ramazan, por të caktuara janë edhe çastet e fillimit dhe përfundimit të agjërimit në ditët përkatëse. Allahu xh.sh. thotë:

﴿...وَكُلُوا وَاشْرَبُوا حَتَّىٰ يَتَبَيَّنَ لَكُمُ الْخَيْطُ الْأَبْيَضُ مِنَ الْخَيْطِ
الْأَسْوَدِ مِنَ الْفَجْرِ ۖ ثُمَّ أَتِمُّوا الصِّيَامَ إِلَى اللَّيْلِ...﴾

***“Hani dhe pini derisa të dalloni fijen e bardhë*** *(bardhësinë)* ***e agimit nga fija e zezë*** *(errësira e natës),* ***pas-***

***taj plotësoni agjërimin deri në perëndim të diellit.”*** *(El Bekare, 187).*

Nga ky ajet shihet qartë se agjërimi i Ramazanit është një nga adhurimet për të cilat kushtet e kohës trajtohen me saktësi të lartë. Fillimi dhe përfundimi i agjërimit të muajve dhe ditëve përkatëse është përcaktuar drejtpërdrejt nga Allahu, xh.sh..

- Haxhi është adhurimi i pestë në renditjen e kushteve të Islamit, duke përmbushur kështu të gjitha kushtet e Islamit.

Me termin haxh nënkuptohet vizita e Qabesë, kodrës së Arafatit dhe vendeve përcjellëse, në kohën e caktuar, duke kryer rituale të veçanta. Pra, haxhi, përveçqë është i kushtëzuar nga vendi, ai është edhe i lidhur ngushtë me kohën në vendet përkatëse. Ky adhurim përbëhet nga kushtëzimet shpirtërore dhe mundësitë materiale. Pavarësisht rëndësisë dhe peshës së madhe që ka haxhi në Islam, ai fillon në kohë të caktuar dhe përfundon në ditët e përcaktuara. Allahu xh.sh., thotë:

﴿الْحَجُّ أَشْهُرٌ مَعْلُومَاتٌ...﴾

***“Haxhi është në muajt e caktuar...”*** *(El Bekare, 127).*

Përderisa haxhi kryhet përmes komponentëve shpirtërorë dhe materialë, kuptohet qartë se ai pastron shpirtin, trupin dhe pasurinë. Madhështinë e haxhit e bëjnë edhe veprimet dhe adhurimet që kryhen gjatë kohës dhe në vendet e përcaktuara të tij. Ndër këto adhurime theksojmë: veshja e ihramit, tavafi, ecja mes kodrave Safa dhe Merva, vlera e lutjeve kur shihet Qabeja dhe kur pihet uji zemzem, qëndrimi në Arafat,

qëndrimi në Muzdelife, në Mina, gjuajtja e gurëve, qethja, prerja e hedjit (kurbanit të haxhit) etj.. Këto veprime apo shumica e tyre, përveçse kryhen në pozicione dhe vende të ndryshme, janë edhe të lidhura, dhe në disa raste të kushtëzuara me kohë të caktuar. Përderisa këto adhurime, kushte të Islamit janë të ndërlidhura ngushtë me kohën, kuptohet se koha është pjesë e pandashme e Islamit.

## Format e llogaritjes së kohës për përcaktimin e kohës së adhurimeve

Mësimet islame vazhdimisht i thërrasin njeriut të mësojë dhe studiojë, duke e nxitur zhvillimin e tij dhe zbulimin e gjërave të dobishme. Për çdo zbulim të tillë, zbuluesit i premtohet shpërblim i plotë për çdo përdorim të dobishëm të atij zbulimi. Njëkohësisht, kërcënohen ata që sjellin praktika të këqija dhe të dëmshme. Veprat ndahen në dy lloje: a) Adhurime që janë të synuara si qëllime në vetvete, me të cilat adhurohet Zoti (مقصودة بذاتها); b) Veprat që shërbejnë si mjete për arritjen e objektivave hyjnore, por nuk janë qëllim në vetvete (غير مقصودة بذاتها), të quajtura edhe rrugë ose mjete (وسيلة). Rrugët mund të ndryshojnë, sepse ato përdoren sipas mundësive të shoqërive dhe kushteve të ndryshme. Ndërsa qëllimet hyjnore, nuk ndryshojnë. Pra, adhurimet dhe kushtet e Islamit janë objektiva të pandryshueshme, të cilat duhet të realizohen në kohë të caktuar. Prandaj, çdo rrugë e sigurt dhe e disponueshme mund të përdoret për të përcaktuar kalendarin e veprimit të atyre adhurimeve. Ndër metodat dhe rrugët përmes të cilave mund të kuptohen ndryshimet dhe lëvizja e

kohës, muajve, ditëve dhe orëve, që janë përdorur në historinë islame, përfshihen:

**a. Përmes shikimit të Hënës.** Duke vëzhguar ndryshimet e Hënës, kuptohen etapat e lëvizjes së saj dhe ndryshimi i muajve hënorë. Agjërimi i Ramazanit bëhet obligim me hyrjen e muajit Ramazan, respektivisht me përfundimin e muajit Shaban, i cili mund të zgjasë 29 ose 30 ditë. Pejgamberi a.s., ka thënë: "*Agjëroni atëherë kur ta shihni hënën, dhe përfundoni agjërimin atëherë kur ta shihni atë...*"[9] Pra, nëse **në ditën e 29 shihet hëna,** të nesërmen fillohet agjërimi. Gjithashtu, Pejgamberi a.s., ka thënë: ***"Mos agjëroni derisa ta shihni hënën, dhe qëndroni agjerueshëm derisa ta shihni atë..."***[10]

Nga këto hadithe kuptohet qartë se shikimi i hënës është një nga format e pranueshme për të filluar dhe përfunduar adhurimet, në këtë rast agjërimin e Ramazanit. Megjithatë, kuptimi i teksteve duhet të bëhet sipas përmbajtjes së fjalëve, jo vetëm sipas shkakut të thënies. Për pranimin dhe vendimin mbi dukshmërinë e hënës, duhet të ndiqen dy procedura kryesore:

- Verifikimi i informacionit për shikimin e hënës. Verifikimi i dukshmërisë së hënës bëhet nga autoriteti kompetent në vendin përkatës.

Ky proces merr parasysh numrin e shikuesve të hënës, i cili mund të jetë relativ. Nëse qielli është i turbulluar, mjafton një person-dëshmitar, i cili duhet të plotësojë kushtet e dëshmisë. Ndërsa, kur qielli është i pastër dhe hëna mund të

---

[9] El Buhari, *Sahih*, 2/574, nr. 1810.

[10] Muslimi, *Sahih*, 2/759, nr. 1080.

shihet lehtësisht, duhet të jenë të paktën dy dëshmitarë, në mënyrë që të vërtetohet saktësia e shikimit të hënës. Në situatën kur qielli është i pastër, dëshmia e vetëm një individi konsiderohet e dyshimtë, sepse më shumë se një person do të duhej ta shihte hënën. Në këtë rast, refuzohet dëshmia e vetëm një dëshmitari, dhe atij i ndalohet të thërrasë njerëzit për të agjëruar Ramazanin, pasi një veprim i tillë shkakton çrregullime në shoqëri.

- Vendimi për fillimin apo përfundimin e hënës duhet të merret nga institucioni kompetent.

Ky institucion, qoftë shtetëror apo i licencuar nga shteti për organizimin e çështjeve përkatëse, është ai që e pranon apo refuzon dëshminë e dëshmitarëve për dukshmërinë e hënës. Pranimi ose refuzimi bëhet në bazë të: besueshmërisë së dëshmitarëve, përpikërisë së vëzhgimit, rrethanave klimatike dhe indikatorëve të tjerë që lidhen me procesin e vëzhgimit. Është e rëndësishme të theksohet se një normë juridike për fillimin apo përfundimin e adhurimit nuk fillon apo mbaron derisa institucionit kompetent nuk e dekreton atë vendim. Pra, në këtë rast, agjërimi shpallet nga autoriteti kompetent, dhe jo sipas vlerësimit individual për dukshmërinë apo jo të hënës.[11] Pejgamberi a.s., për fillimin e agjërimit në Ramazan, nuk kërkonte që secili të vepronte sipas gjykimit të tij personal. Ai ka thënë: *"Vërtet, ezani i Bilalit është natën, hani dhe pini derisa të dëgjoni ezanin e Ibën Umi Mektumit."*[12]

[11] Err Rrazi, Husamudin, *Hullasatu ed Delail ve Tenkih el Mesail fi Sherh el Kuduri*, (Jordan-Aman, Dar el Fet'h, 2016) 1/ 573-574.

[12] Muslimi, *Sahih*, 2/768, nr.1092.

Pra, Muhamedi a.s., si udhëheqës fetar dhe shtetëror, organizonte informimin për fillimin e agjërimit. Sot, kjo kompetencë fetare dhe juridike është e rezervuar për institucionin ose autoritetin kompetent. Në rastin konkret të vendit tonë, autoriteti i vetëm kompetent është Bashkësia Islame e Republikës së Kosovës, dhe vendimet apo shpalljet e saj e përcaktojnë obligueshmërinë ose mosobligueshmërinë e adhurimeve.

**b. Duke plotësuar muajin paraprak tridhjetë ditë.** Nëse adhurimet ndërlidhen me fillimin apo përfundimin e muajit, njëra prej formave të përcaktimit të ndryshimeve të muajve është plotësimi i muajit paraprak.

Gjithherë, ndryshimi nga një gjendje në tjetrën kërkon argument, dhe përderisa ai mungon, ajo vazhdohet në gjendjen paraprake. Pra, nëse nuk duket Hëna në përfundim të ditës së 29-të, respektivisht në natën e ditës së 30-të, pasi që në kalendarin hënor nata i paraprinë ditës, atëherë plotësohen 30 ditë të muajit paraprak, dhe pas asaj dite me automatizëm fillon muaj tjetër. Muhamedi a.s., në një hadith tjetër ka thënë: *"...ndërsa nëse hëna nuk duket, plotësojeni muajin Shaban tridhjetë ditë."*[13] Kështu veprohet për përfundimin e muajve, ku natyrshëm fillon muaji tjetër, ky ndryshim i muajve ka ndikim juridik të veçantë në muajt e haxhit dhe në Ramazan.

**c. Llogaritja astronomike,** shikimi apo verifikimi i përfundimit ose fillimit të muajve bëhet përmes ndryshimit të

[13] Muslimi, *Sahih*, 2/759, nr. 1080.

etapave të hënës. Këtu për qëllim është arritja e informacionit të saktë për ato ndryshime. Gjithherë po flasim për llogaritjen kalendarike hënore.

Astronomia është shkencë që studion trupat qiellorë dhe proceset e tyre. Në studimet e saj, përdoren metoda shkencore shumë të avancuara. Ndërsa, në të kaluarën, shkenca e astronomisë kishte ngecur për një kohë të gjatë, pasi Kisha ndalonte ose ndiqte shkencëtarët që sillnin rezultate të ndryshme nga botëkuptimet e saj. Në periudhën e mesjetës, studiuesit kryesorë të astronomisë ishin myslimanë, të cilëve as feja dhe as shteti nuk ua pengonte studimin e kësaj fushe, edhe pse rezultatet e tyre shpesh nuk pranoheshin, për shkak të nivelit të ultë të saktësisë apo dyshimeve të larta në saktësinë e studimeve të tyre. Kjo pasi që në atë kohë, astronomia nuk ishte zhvilluar mjaftueshëm për t'i bindur dijetarët myslimanë për saktësinë e rezultateve të saj. Pas shpalljes së fundit, nëse do të kërkohej nga myslimanët përcaktimi i muajve, ditëve dhe kohëve të namazit përmes llogaritjeve astronomike, kjo do të vështirësonte ose paralizonte kryerjen e adhurimeve që ndërlidhen me kohë të caktuar. Edhe nëse do të kishte njohës të astronomisë, përhapja e njohurive në çdo vend dhe familje ishte e vështirë, për shkak të vështirësive të komunikimit në atë kohë.[14]

[14] Vëmendje: Shkenca e astronomisë nuk duhet ngatërruar me astrologjinë apo me pseudo-shkencat të cilat mundohen të zbulojnë fatin e njerëzve përmes vrojtimit të lëvizjeve të trupave qiellorë. Astrologjia nuk ka baza apo rregulla shkencore, prandaj më shumë i ngjan metodës së falltarëve, gjë e cila është e ndaluar.

Sot, astronomia është një shkencë e rregulluar me ligje, metoda, institucione dhe universitete arsimore të mirëfillta. Rezultatet e llogaritjeve të lëvizjeve të trupave qiellorë dhe planetëve janë jashtëzakonisht të sakta. Preciziteti i këtyre llogaritjeve është i tillë, sa mund të parashikojë ditën, orën dhe minutën e një eklipsi dhe cilën pjesë të Tokës do të përfshijë, edhe pas dhjetëra vitesh. Në mënyrë praktike, këto llogaritje tregojnë me saktësi lëvizjen e Hënës dhe Tokës, përfshirë kohën e lindjes dhe perëndimit të ditës, shumë më saktë se përpjekja për shikimin e Hënës me sy.

Imam Es Subkiju, Allahu e pastë mëshiruar, i cili vdiq në vitin 756 hixhri, rreth 691 vjet më parë, ka thënë: “Saktësia e llogaritjes astronomike është e prerë, ndërsa dëshmia e dëshmitarëve është e diskutueshme. Diçka që është e diskutueshme nuk mund të ketë prioritet para asaj të pa diskutueshme, dhe assesi nuk i jepet përparësi. Prandaj, nëse dikush thotë kam parë hënën dhe llogaritja astronomike tregon të kundërtën, apo anasjelltas, mbështetemi dhe vendosim sipas llogaritjes astronomike.”[15] Nëse Imam Es Subkiju e tha këtë para shtatë shekujve, çfarë do të thoshte sot, duke parë zhvillimin gjigant të astronomisë dhe teknologjisë moderne, e cila dëshmon rezultatet e saj me prova të padiskutueshme? Saktësia e metodave shkencore në astronomi dëshmohet nga rezultatet e argumentuara, nga studiuesit myslimanë dhe jomyslimanë.

Dijetari jonë, Shuajb el Arnauti, Allahu e pastë mëshiruar, në njërën prej ligjëratave të tij ka thënë: “Kam parë një

[15] Es Subkij, Tekijudin, *Fetava es Subkij*, (Egjipt, shtëp. bot.: El Mearif) 1/209.

shqiptar nga Siria, i cili kishte përgatitur një kalendar për rreth 400 vjetët e ardhshme, me një precizitet të jashtëzakonshëm. Fatkeqësisht, ky kalendar dhe studimi i tij u shkatërruan nga njerëzit, me pretendimin se kjo dituri ishte e dëmshme dhe nuk duhej përdorur."[16] Megjithatë, nëse një hulumtim individual, me mjete primitive, është kaq i saktë, sa do të jetë preciziteti i rezultateve të astronomisë moderne, e cila përdor satelitë që vazhdimisht vëzhgojnë dhe regjistrojnë çdo lëvizje të kozmosit?

Gjithashtu, dijetari ynë Ahmed el Xhemali, Allahu e pastë mëshiruar, tregon se një marinar mysliman i devotshëm i kishte thënë se preciziteti i kohëve është me sekonda, kjo dëshmi është e rëndësishme, pasi puna dhe përvoja e tyre ndërlidhet ngushtë me kohën.[17] Sot, llogaritjet astronomike për përcaktimin e kohëve pranohet nga shumica e dijetarëve bashkëkohorë. Hadithet që udhëzojnë për shikimin e hënës ose për plotësimin e muajve paraprak me 30 ditë, nëse hëna nuk shihet, nuk e ndalojnë përdorimin e metodave shkencore, nëse profesionistët e fushës konfirmojnë se janë të sakta. Zoti xh.sh., thotë:

﴿...فَاسْأَلُواْ أَهْلَ الذِّكْرِ إِن كُنتُمْ لاَ تَعْلَمُونَ﴾

***"...pyetini njerëzit e dijshëm, nëse ju nuk dini."*** *(En Nahl, 43).*

Nëse dijetarët islamikë janë unifikuar për një normë juridike, mbyllet mundësia e diskutimit të saj. Mendimet që e

---

[16] Jordan, Aman, në shtëpinë e tij, viti 2015.

[17] El Hamevij, Ahmed el Xhemal, *El Ihbar Bivakt el Imsak Biliftar* (Jordan-Aman, Dar Linesher ve et Tveziu, 2014), f. 53-54.

sfidojnë këtë konsensus nuk konsiderohen dhe pranimi i tyre është i pamundur. Por, nëse konsensusi lidhet me një shkak të ndryshueshëm, ndryshimi i këtij shkaku mund të bëjë që çështja të rishikohet dhe norma juridike të ndryshojë. Kjo është një rregull e padiskutueshme në jurisprudencën islame. Shkaku historik i mospranimit të llogaritjes astronomike ka qenë pamjaftueshmëria e saktësisë së saj. Ndërkaq, sot, saktësia e arritjeve shkencore në astronomi është e pakontestueshme, dhe për këtë arsye, përdorimi i saj dhe mbështetja përmes saj është gjithashtu i pakontestueshëm. Llogaritja shkencore nuk është më e dyshimtë, përkundrazi, është më e saktë se shikimi i njeriut, i cili mund të gabojë ose të mashtrohet nga ndryshimet vizuale në horizont.

Shqetësimi i zakonshëm: Nëse llogaritja astronomike është kaq e saktë, pse ndodh që studiuesit e astronomisë të thonë se ka filluar muaji i ri hënor, edhe pse shikimi i hënës është i pamundur? Prof. dr. Sheref el Kudah, në një punim shkencor, e shpjegon këtë në mënyrë të ilustruar, e përmbledhja e këtij punimi është si vijon: Saktësia e llogaritjes astronomike është e pakontestueshme sipas konsensusit të njohësve të astronomisë. Hëna nuk mund të shihet me sy deri të paktën 15 orë pas lindjes së saj, dhe kjo mund të zgjasë deri në 30 orë. Përmes teleskopit, shikimi mund të ndihmohet, por nuk mund të duket para 12 orëve pas lindjes së Hënës. Kur Hëna ndodhet në pozicion ku rrezet e Diellit nuk e arrijnë, për shkak të pengesës që krijon Toka, nuk mund të shihet. Kur Hëna devijon dhe rrezet e Diellit arrijnë në Hënë

dhe ato reflektojnë në Tokë, atëherë bëhet e dukshme.[18] E njëjta situatë ndodh edhe në fund të muajit, kur disa orë para përfundimit, Hëna nuk mund të shihet. Pra, saktësia e llogaritjes nuk mungon, por pamundësia e shikimit fizik të Hënës nuk e ndryshon këtë saktësi. Ndërsa sa i përket hadithit pejgamberik: *"Ne jemi popull analfabet, nuk dimë të shkruajmë dhe as të llogarisim, muaji është njëzet e nëntë apo tridhjetë ditë"*[19]*,* themi se pretendimet se Muhamedi a.s. ka ndaluar llogaritjen astronomike me këtë hadith janë spekulime dhe keqkuptime. Kuptimi i këtij hadithi duhet të analizohet në dritën e disa parimeve: Të shpjegohet në përputhje me Kuranin, të merren parasysh rrethanat dhe gjendja në të cilën është thënë hadithi, të kuptohet kuptimi real gjuhësor i fjalëve, të analizohen objektivat dhe qëllimi i tekstit, etj.. Andaj, mbi bazën e këtyre parimeve konkludojmë se: Ky hadith pasqyron gjendjen e arabëve në atë kohë, ku shumica e myslimanëve ishin analfabetë. Allahu xh.sh. thotë: ***"Allahu është Ai që u solli analfabetëve një të Dërguar nga gjiri i tyre…"*** *(El Xhumua, 2).*

Kur analizojmë këtë gjendje, nuk kuptohet se myslimanët duhet të mbeten në atë gjendje. Përkundrazi, Zoti xh.sh., e ka potencuar rëndësinë e diturisë në shumë ajete, duke filluar që me ajetin e parë të shpalljes, i cili urdhëron për lexim dhe mësim. Pejgamberi a.s., në mundësinë e parë, investoi në dituri, përmes lirimit të robërve të luftës me kusht që t'ua më-

---

[18] El Kudah, Prof. dr. Sheref, *Mexheletu Dirasat, El Xhama el Urdunijeh*, 26/17-18, nr. 2, 1999.

[19] Buhariu, *Sahih*, 2/ 575, nr. 1814. Muslim, *Sahih*, 2/ 761, nr.1080.

sonin dhjetë myslimanëve shkrimin.[20] Në vlerë monetare, kjo ishte një shumë mjaftë e madhe, pasi dhuronte lirinë dhe jetën, edhe pse ata mësues nuk ishin myslimanë, i kundërshtonin dhe luftonin myslimanët. Qëllimi i këtij hadithi ishte të udhëzojë myslimanët, përderisa ishin një shoqëri analfabete, të përcaktonin kohët e adhurimeve me shikimin e Hënës ose me plotësimin e muajve 30 ditë. Kjo ishte një lehtësim, duke përdorur metodat që ishin në dispozicion të tyre në atë kohë. Hadithi nuk ndalon mësimin, as llogaritjen astronomike. Zoti xh.sh. thotë: ***“Allahu e ka bërë Diellin burim drite, kurse Hënën e ka bërë të shkëlqejë, që ju të dini numrin e viteve dhe matjen e kohës…”*** *(Junus, 5).*

Pra, llogaritja kohore është e kërkuar. E gjithë trashëgimia është e ndërtuar mbi numra dhe llogaritje. Si mund të ndalohej llogaritja? Ajo që kërkohet është që llogaritja të jetë e saktë, nëse saktësia është e garantuar, atëherë duhet të shfrytëzohet kjo mundësi për përcaktimin e kohës dhe organizimin e adhurimeve. Fjala رؤية – رأى në gjuhën e Kuranit ka kuptimin e shikimit, njohjes dhe kuptimit, të cilat arrihen përmes zemrës, mendjes dhe syrit. Zoti xh.sh. thotë:

﴿أَلَمْ تَرَ كَيْفَ فَعَلَ رَبُّكَ بِأَصْحَابِ الْفِيلِ﴾

***“A nuk e ke parë çfarë bëri Zoti yt me poseduesit e elefantëve?”*** *(El Fil, 1).*

Folja تَرَى që vjen nga رؤية – رأى në këtë kontekst do të thotë: “*A nuk e ke parë? A nuk e ke dëgjuar?*” Kurse ne e dimë se Muhamedi a.s. lindi pikërisht në të njëjtin vit të kësaj

[20] Hanbel, Ahmed bin, *Musned*, (Bejrut, shtë.bot. Er Rrisaleh, 2001) 4/92. 2216. Hadithi i saktë.

ngjarjeje…, d.m.th., a nuk e ke kuptuar informacionin aq qartë sa të ishte si të shihje me sy se si veproi Zoti me poseduesit e elefantëve. Pra, fjala "*parë*" ka për objektiv kuptimin dhe njohjen, jo vetëm shikimin fizik.[21] Gjithashtu, në një nga transmetimet e haditheve të përmendura më lart thuhet: *"Nëse Hëna nuk duket për shkak të turbullirës së qiellit, përcaktoni atë."*[22] Kjo do të thotë se përcaktimi përfshin edhe llogaritjen. Pra, për të përcaktuar fillimin e Ramazanit, rruga që përdoret duhet të jetë shkencore dhe e saktë, në mënyrë që të mos gabohen kohët. Muhamedi a.s., në disa raste, vepronte sipas mendimeve të sahabëve për çështje jo fetare, si p.sh.: Në betejën e Bedrit, veproi sipas fjalës së El Habab ibën el Mundhirit për pozicionet e luftës. Në betejën e Hendekut, veproi sipas fjalës së Selman el Farisiut për hapjen e hendekut. Ai a.s., ka thënë: *"Ju jeni më të ditur se unë për çështje që nuk janë fetare."*[23] Kjo tregon se përpjekja dhe organizimi i jetës, si dhe përdorimi i mundësive, mbeten në kompetencën tonë. Pra, për përcaktimin e muajit hënor dhe fillimit të adhurimeve, ekzistojnë tri forma të llogaritjes kalendarike, të cilat institucioni kompetent mund t'i përdorë: a) Përmes shikimit të Hënës, b) Duke plotësuar muajin paraprak me 30 ditë dhe c) Përmes llogaritjes astronomike. Vendimi i institucionit kompetent që të përzgjedh apo veprojë me cilëndo apo me disa nga këto mënyra të verifikimit të kohës, është e drejtë e pakontestueshme dhe e vetme e pranuar. Një rregull juridik i

---

[21] En Nesefij, Abdullah bin Ahmed, *Medarik et Tenzil ve Hakaik et Tevil,* (Bejrut, El Kalem et Tajib 1998), 3/580.

[22] Muslimi, *Sahih*, 2/ 759, nr. 1080.

[23] Muslimi, *Sahih*, 4/ 336, nr. 2363.

cila buron nga shumë tekste fetare dhe në të cilën dakordohen dijetarët islamë thotë:

حُكْمُ الحَاكِمِ يَرْفَعُ الخِلَافَ

*"Vendimi i hakimit, (udhëheqësit të institucionit) eliminon divergjencat, në praktikë."*[24]

Pra, në vendin tonë, institucioni më i lartë fetar është Bashkësia Islame e Republikës së Kosovës, vendimet dhe përzgjedhja e mendimeve nga BIK-u janë të detyrueshme. Përndryshe, do të krijohej huti, e ndoshta edhe përçarje në praktikimin e adhurimeve, të cilat në fakt duhet të na bashkojnë, e jo të na ndajnë. Mosrespektimi i kohëve të përcaktuara nga autoriteti institucional shkakton turbullira dhe çrregullime shoqërore, të cilat kanë depërtuar madje edhe në familje dhe shoqëri, çrregullime këto që nuk na duhen aspak. Kjo ndodh kur disa falen apo agjërojnë, ndërsa të tjerët jo, duke thënë se ende ka kohë ose koha ka kaluar. Një fitne e tillë nuk mund të shuhet, përveçse duke iu përmbajtur vendimeve të institucionit kompetent. Pretendimet se secili mund ta përcaktojë vetë kohën, duke ndjekur hënën sipas vlerësimit personal, janë të gabuara dhe të rrezikshme, një keqkuptim i qartë i fesë. Është e çuditshme se si disa njerëz guxojnë të veprojnë në këtë mënyrë dhe madje t'i thërrasin edhe të tjerët që t'i pasojnë. Veprimi i tyre lë të kuptohet sikur ata posedojnë dije që të tjerët nuk e kanë.[25] Pejgamberi a.s. ka thënë:

---

[24] El Hamevij, Abuddin el Husejni, *Gamz Ujun el Besair fi Sherh el Eshbeh en Nedhair*, 3/113.

[25] El Hamevij, Ahmed el Xhemal, *El Ihbar Bivakt el Imsak Biliftar* (Jordan-Aman, Dar Linesher ve et Tveziu, 2014), f. 67.

*"...Ai që ruhet nga të dyshimtat, e ka ruajtur pastërtinë e fesë dhe nderit të vet, ndërsa ai që bie në të dyshimta, rrezikon të përfundojë në haram..."*[26] Në një hadith tjetër thuhet: "*Lëri gjërat e dyshimta dhe përqendrohu në ato që nuk janë të dyshimta.*"[27] Prandaj, pyete zemrën tënde, si duhet të veprosh? Ta pasosh institucionin dhe të sigurosh saktësinë e adhurimeve, apo të mbështetesh në teori dhe pretendime individuale, të cilat zakonisht qarkullojnë nëpër shoqëri pa studim, pa analizë dhe pa referencë, qasje që shumica absolute e dijetarëve e refuzojnë?! Vëmendje: Nëse haset ndonjë transmetim nga gjeneratat e para që duket se e kundërshton këtë koncept, ai nuk mund të jetë më i fuqishëm se argumentet e përmendura, ose duhet të shpjegohet në frymën e ajeteve dhe hadittheve të tjera. Në asnjë mënyrë nuk lejohet të vihet në kundërshtim me shpalljen hyjnore, sepse në të nuk ka përplasje. Në këtë mënyrë arrihet uniteti i shoqërisë, qëllim ky që e dëshiron shumë i Madhi Zot.

[26] Muslimi, *Sahih*, 3/219, nr. 1599.
[27] Buhariu, *Sahih*, 2/ 724, nr. 1946.

**Prof. ass. dr. Rexhep SUMA**

# KURANI - UDHËZUES PËR MORALIN E BUKUR

Morali ka qenë një nga temat qendrore në traditën islame. Kurani, si libër i shenjtë, ofron udhëzime të qarta për formimin e karakterit të besimtarit, duke theksuar vlerat e drejtësisë, mëshirës, durimit dhe respektit ndaj të tjerëve. Përmes tregimeve të pejgamberëve dhe ajeteve të drejtpërdrejta, Kurani bëhet burimi kryesor i vlerave dhe moralit në Islam, duke ofruar një metodë të plotë për përmirësimin e individit dhe të shoqërisë.

Megjithatë, përkushtimi ndaj moralit kuranor nuk kufizohet vetëm në mësimin dhe kuptimin e ajeteve, siç mendojnë disa, por bazohet kryesisht në zbatimin e tyre në jetën e përditshme. Pikërisht këtu shfaqet hendeku, që vërehet te shumë njerëz. Përvetësimi i moralit të Kuranit kërkon një harmoni të qëndrueshme ndërmjet njohurisë dhe veprës.

Kurani, jo vetëm që udhëzon, por edhe frymëzon besimtarët për të kultivuar një moral të lartë në jetën e tyre të përditshme.[1] Ai është i mbushur me ajete që na udhëzojnë drejt virtyteve më të larta, në mënyrë që myslimani të qëndrojë në

[1] Mevdudi, Abul A'la. *Tafhim el Kur'an*, vëll. I, Lahore: Islamic Publications, 1980, p. 25.

rrugën e drejtësisë dhe të ngrihet me moralin e tij, derisa zemra e tij të qëndrojë e drejtë, gjymtyrët e tij të jenë të drejta dhe të bëhet një rob i vërtetë i Zotit.

Morali i lartë e ngre njeriun dhe i jep atij një pozitë të nderuar mes njerëzve, duke fituar respekt dhe vlerësim. Kur Allahu i Madhëruar na ka urdhëruar të meditojmë mbi Librin e Tij, Ai ka thënë:

> ***"Ky është Libër i begatshëm që Ne ta shpallëm ty, që t'i studiojnë argumentet e tij dhe që të marrin mësim prej tij ata që kanë mend."***[2]

Vlerat themelore në Islam janë të qëndrueshme dhe universale. Ato nuk ndryshojnë me kalimin e kohës apo me ndryshimin e vendeve, sepse janë të përshtatshme për çdo kohë dhe rrethanë. Etika, besimi dhe ligji hyjnor nuk janë krijim i njeriut, për këtë arsye ato mbeten të pandryshuara, pavarësisht ndryshimeve të kohës dhe mjedisit.

Morali i lartë është pjesë thelbësore e akides, sepse besimi i shëndoshë nuk mund të jetë i plotë pa moral. I Dërguari i Allahut i ka edukuar shokët e tij në virtyte të larta të moralit me metoda të ndryshme. Ai a.s. ua lexonte atyre shpalljet kuranore, dhe kur ata i dëgjonin dhe i meditonin, vepronin sipas udhëzimeve të tyre. Kush mediton në ajetet mekase, e gjen Kuranin të mbushur me thirrje për virtyte të larta, për pastrimin e shpirtit dhe për largimin nga çdo gjë që e pengon ecjen drejt Allahut të Lartësuar.

---

[2] Es Sad, 29.

I Dërguari i udhëzimit është shembulli më i përsosur dhe edukatori më i sinqertë i ymetit. Për të, Allahu i Madhëruar ka thënë: ***“Vërtet, ti je mbi një moral të madh.”***[3]

Kuptimi i ajetit është i qartë: gjithçka që ai urdhëronte ishte nga urdhrat e Allahut, dhe gjithçka që ndalonte ishte nga ndalesat e Allahut. Pra, “*ti je mbi moralin me të cilin Allahu të ka dalluar në Kuran.*”

I Dërguari a.s., në edukimin e shokëve të tij mbi moralin fisnik, ka ecur sipas metodës kuranore. Morali në Islam është gjithmonë i lidhur ngushtë me adhurimin dhe akiden, sepse lidhja ndërmjet moralit dhe besimit është e qartë në Librin e Allahut të Madhëruar. Ai ia ka sqaruar të Dërguarit të Tij dhe besimtarëve etikën e besimit, me të cilën duhet të karakterizohen ata që thonë **La ilahe il-l’Allah.** Ai gjithashtu i ka paralajmëruar për moralin pagan, të cilin besimtari duhet ta braktisë.

Në të vërtetë, qortimi i moralit pagan ka filluar që në çastet e para të shpalljes, bashkë me qortimin e prishjes së besimeve të tyre, dhe ka vazhduar deri në fund. Kështu, edukimi ka një rol vendimtar në zhvillimin ose në rënien e jetës së ymetit. Islami mëson se kërkimi i diturisë duhet të shoqërohet gjithmonë me praktikën. Sipas këndvështrimit islam, edukimi nuk është thjesht mësim teorik apo fjalë që mbeten pa zbatim në jetën reale. Përkundrazi, Islami është një ushtrim praktik, në të cilin mishërohen vlerat etike dhe urtia. Tek

[3] El Kalem, 4.

edukatori mishërohet shembulli më i denjë, ndërsa te nxënësi shfaqet dëgjueshmëria e vëmendshme dhe përkushtimi.[4]

Morali nuk është diçka dytësore në këtë fe, as nuk kufizohet vetëm në një fushë të caktuar të sjelljes njerëzore, përkundrazi, ai është një nga shtyllat themelore të saj dhe përfshin tërë sjelljen e njeriut. Të gjitha shfaqjet e sjelljes njerëzore që bartin një ngjyrë të qartë morale janë përkthimi praktik i besimit dhe i imanit të drejtë. Sepse imani nuk është vetëm ndjenjë e fshehur në ndërgjegje, por është edhe veprim i dukshëm dhe praktik.

Kështu, kur nuk shohim këtë sjellje praktike, ose shohim të kundërtën e saj, me të drejtë lind pyetja: Ku është atëherë imani? Çfarë vlere ka ai, nëse nuk shndërrohet në sjellje?

Kurani e lidh moralin me besimin në mënyrë të fuqishme, dhe shembujt për këtë janë të shumtë. Ndër ta, Allahu i Madhëruar thotë: ***"Vërtet, kanë shpëtuar besimtarët: Ata që janë të përulur në namazin e tyre, dhe ata që i shmangen të kotës*** *(fjalë ose vepra),* ***dhe ata që japin rregullisht zekatin, dhe ata që e ruajnë nderin e tyre*** *(në çështjet e jetës intime),* ***përveç ndaj grave të tyre*** *(me kurorë)* ***dhe ndaj atyre që i kanë në pronësi, për këto nuk qortohen. E kush kërkon përtej tyre, të tillët janë ata që e kanë shkelur kufirin. Dhe ata që me kujdes i ruajnë amanetet dhe premtimet e dhëna, dhe ata që i kushtojnë rëndësi kohëve të namazit të tyre. Të tillët janë mu ata trashëgimtarët, që do të trashëgojnë Firdevsin; aty do të qëndrojnë përgjithmonë."***[5]

---

[4] Seid Ismail Ali, *Bazat e edukimit islam*, Logos-A, Shkup, 2021, f.61.

[5] El Muminun, 1–11.

Kështu, kjo sure fillon me pohimin e shpëtimit për besimtarët, me theksimin: ***“Me të vërtetë kanë shpëtuar besimtarët.”*** Pas kësaj, ajo i përshkruan këta besimtarë në mënyrë të hollësishme dhe të detajuar, duke i kushtuar vëmendje të veçantë aspektit moral të tyre. Këtu bëhet e qartë se këto virtyte morale, nga njëra anë, janë fryt i besimit, ndërsa imani, nga ana tjetër, është shprehje e jashtme e besimit të brendshëm.

Së pari, ata përshkruhen si të përulur dhe të përqendruar në faljet e tyre. Kjo është shenja e parë dalluese e besimtarit të sinqertë: që namazi i tij, çasti kur qëndron me përulësi përpara Zotit të vet, duke e rikujtuar Atë në zemër dhe duke u lidhur me Të në shpirt, të jetë një adhurim i mbushur me devotshmëri dhe përkushtim. Një namaz i tillë dëshmon për sinqeritetin e lidhjes me Zotin, lidhje që merr gjallëri dhe ngrohtësi gjatë çdo përuljeje.

Pas kësaj, surja përmend një tjetër cilësi të thellë morale, atë se besimtarët shmangen nga fjalët dhe veprimet e kota. Kotësia nuk buron nga një shpirt serioz, ndërsa besimi i drejtë e mbush njeriun me ndjenjën e përgjegjësisë dhe seriozitetit, duke e vetëdijesuar për peshën e amanetit hyjnor. Natyrisht, serioziteti nuk nënkupton një gjendje të përhershme ashpërsie apo zymtësie, por, nga ana tjetër, kotësia nuk përputhet me ndjenjën e thellë të përgjegjësisë që ndien njeriu përballë Krijuesit të tij.

Po ashtu, këta besimtarë bartin në zemrat e tyre ndjeshmërinë ndaj të drejtës së Zotit në pasurinë e tyre, duke dhënë rregullisht zekatin. Ata janë të përkushtuar ndaj urdhrave hyjnorë edhe në marrëdhëniet gjinore, pa kaluar kufijtë që ka caktuar Zoti, si dhe në marrëdhëniet shoqërore, duke ruajtur amanetin dhe respektuar besën. Në këtë mënyrë, kuptohet më

qartë edhe konceptimi që shokët e Pejgamberit a.s. kishin për moralin, se ai është fryt i natyrshëm i besimit të drejtë dhe i adhurimit të gjallë e të përulur ndaj Zotit. Këtë e mësuan nga Kurani dhe nga udhëzimi i të Dërguarit të tyre të sinqertë e besnik, paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të.

Kurani fisnik u ka dhënë atyre një përshkrim të plotë të personalitetit besimtar, ku adhurimi përbën dimensionin themelor të tij. Vërejmë se si Zoti, në përshkrimin e cilësive të besimtarëve, e ka vendosur në fillim përulësinë në namaz dhe në fund ruajtjen e rregullt të tij, ndërkohë që në mes përmendet dhënia e zekatit, një formë adhurimi, krahas virtyteve të tjera morale.

E vërteta mbetet e pandryshuar, dhe ky është parim themelor i moralit islam. Një nga parimet bazë të Islamit është qëndrueshmëria e vlerave, e cila shoqërohet me qëndrueshmërinë e moralit. Përkushtimi moral përbën boshtin rreth të cilit rrotullohen të gjitha vlerat etike. Nëse humbet ndjenja e përkushtimit, zhduket edhe thelbi i qëllimit moral. Mungesa e përkushtimit çon në mungesë përgjegjësie, dhe kjo, nga ana e saj, shkatërron çdo mundësi për vendosjen e drejtësisë në vendin e saj.

Islami përmban parime të plota teorike të moralit, të cilat e udhëheqin njeriun drejt virtyteve në formën më të përsosur të tyre.[6] Kjo lidhet ngushtë me qëllimin e mesazhit islam, që është mëshira për gjithë njerëzimin. Morali nuk duhet kuptuar vetëm si një sistem rregullash, por si një mënyrë jetese

[6] El Gazali, Ebu Hamid, *Ihja Ulum el Din*, Bejrut: Dar el Fikër, 1988, f.50.

që reflekton besimin *(imanin)* dhe përpjekjen për të arritur *ihsanin* – pra, për të bërë të mirën edhe përtej detyrës së domosdoshme fetare.[7]

Në tekstin kuranor, nocioni *"moral"* përmendet dy herë:

*E para:* Në përgjigjen e popullit të Hudit a.s., kur ai i thërret ata të mos lidhen me jetën materiale, të mos tejkalojnë në ndërtim dhe të adhurojnë Allahun xh.sh., sepse kjo është më e drejtë dhe më e dobishme për ta, e ata iu përgjigjën, siç thuhet në ajetin: ***"Kjo** (që na këshillon ti)* ***nuk është tjetër, vetëm se traditë** (mitesh)* ***e popujve të lashtë."***[8]

Nga shqyrtimi i kuptimeve të këtij ajeti kuptohet se thirrja e pejgamberëve gjithmonë është bazuar në një vijë të pandryshueshme morale, e cila udhëheq drejt shëndetit dhe mirëqenies së shoqërisë dhe individit.

*E dyta:* Në fjalën e Allahut xh.sh.: ***"Vërtet, ti je në një shkallë të lartë morali!"***[9]

Ky ajet i drejtohet Muhamedit a.s., i cili është shembulli që duhet ndjekur. Librat e jetëshkrimit të të Dërguarit a.s. theksojnë se asnjë njeri nuk ka pasur karakterin që kishte ai, sepse ai ishte më i miri në moral, më i dashuri, më i mëshirshmi dhe më i dhembshuri. Ky ajet tregon se ai që i zotëron virtytet morale të përshkruara në Kuran është i karakterizuar me moral të madh, për shkak të madhështisë së këtyre virtyteve.

---

[7] Mevdudi, Abul A'la. *Tafhim el Kur'an*, vëll. I. Lahore: Islamic Publications, 1980, f. 32.

[8] Esh Shuara, 137.

[9] El Kalem, 4.

Një shembull tjetër i kësaj është ajeti: ***“E nëse i lëshoni ato para se t’i keni prekur, por u keni caktuar atyre një caktim*** *(kurorës),* ***atëherë duhet t’u jepni gjysmën e asaj që e keni caktuar, përveç nëse ato falin ose fal ai në duart e të cilit është lidhja e kurorës. E të falni*** *(burra ose gra)* ***është më afër devotshmërisë, e mos e harroni bamirësinë ndërmjet jush. Vërtet, Allahu sheh atë që vepronι.”***[10]

Fjala *takva* ka një ndërlidhje shumë të ngushtë me mirësjelljen e individit. Personi që vepron sipas Kuranit dhe virtyteve morale është i përkushtuar ndaj moralit të lartë, i drejtë dhe i devotshëm, duke ndjekur udhëzimet e Zotit në marrëdhëniet njerëzore dhe në përmbushjen e të drejtave të të tjerëve.

Kjo çështje është shprehur në Kuran në lidhjen ndërmjet përdorimit të arsyes dhe posedimit të një vetëdijeje morale dhe shpirtërore për Zotin. Fjala *takva,* e përkthyer rëndom si vetëdije dhe frikë nga Zoti, do të thotë, fjalë për fjalë, *“të mbrosh dhe të ruash veten prej rrezikut”*. Në traditë, ajo i referohet mbrojtjes së shpirtit nga çdo gjë që e mundon atë.

Ashtu siç është shpjeguar në hadith, *takva* do të thotë të kesh në zemër praninë madhështore të Zotit, me të cilën e mbron veten nga gjithçka e rreme, e keqe dhe e shëmtuar. Në këtë kuptim, domethëniet konceptuale të *aklit* dhe të *takvasë* përkojnë: të dyja i referohen përpjekjes sonë të vetëdijshme për ta mbrojtur veten nga pasojat jonjerëzore dhe imorale të së keqes, padrejtësisë dhe shtypjes.[11]

---

[10] El Bekare, 237.

[11] Ibrahim Kalin, *Islami, arsyeja dhe bota modern*, Logos-A, Shkup, 2012, f.72.

Një çështje tjetër që merr rëndësi të veçantë në moralin islam është *istikameti* (drejtësia, qëndrueshmëria). Përvetësimi i moralit arrihet përmes unitetit të qëllimit dhe të veprimit. Sjelljet nuk kanë vlerë në vetvete, por vetëm kur janë në harmoni me qëllimin dhe sinqeritetin e zemrës, ashtu siç thotë Pejgamberi a.s.: *"Veprat vlerësohen vetëm sipas qëllimit."*[12]

Allahu xh.sh. i paralajmëron njerëzit lidhur me këtë, duke urdhëruar: ***"O ju që besuat, pse thoni atë që nuk e bëni? Tek Allahu është shumë e urryer të thoni atë që nuk e punoni."***[13]

Edhe i Dërguari ynë, Muhamedi a.s., ka theksuar rëndësinë e drejtësisë së zemrës dhe të sinqeritetit në veprime, duke thënë: *"Derisa zemra e robit nuk është e drejtë, as besimi i tij nuk është i drejtë. Zemra nuk mund të jetë e drejtë derisa gjuha të bëhet e drejtë. Nuk mund të hyjë në Xhenet askush prej të cilit fqinji i tij nuk ndihet i sigurt."*[14]

Kështu theksohet se, besimtari duhet të jetë këmbëngulës dhe i përkushtuar moralisht. Ndërmjet moralit dhe adhurimeve ekziston një raport i ngushtë. Adhurimi, përveçse është detyrë ndaj Allahut, ndihmon personin të zhvillohet edhe në aspektin moral.[15] Për këtë arsye, në Kuran është vënë në dukje se namazi është mjet që e largon njeriun nga të këqijat dhe paturpësitë.

---

[12] El Buhari, Bedu'l- vahj, 1.

[13] Es Saf, 2-3.

[14] HMI 3079, Ibën Hambel, 3, 199.

[15] Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë, *Islami nëpërmjet haditheve*, Logos-A, 2017, botim i dytë, vëll. III, f. 18.

# Modeli praktik në zbatimin e moralit kuranor

Sheriati nuk është mjaftuar vetëm me shpjegimin teorik të moralit, por ai e ka mishëruar atë praktikisht në një model të gjallë, dhe ky model është vetë Pejgamberi a.s.. Kur është pyetur Aisheja r.a. për moralin e Pejgamberit, ajo është përgjigjur: "Morali i tij ishte Kurani."[16]

Sa më afër këtij modeli praktik të jetë njeriu, aq më e vërtetë është dëshmia e tij për përkushtimin ndaj vlerave islame.

Disa shembuj të moralit kuranor, të pasqyruar në veprimet e Pejgamberit a.s., janë:

- **Sinqeriteti:** Allahu xh.sh. thotë: ***"O ju që keni besuar, frikësohuni Allahut dhe bëhuni me të sinqertët."***[17] Pejgamberi a.s. ishte i njohur me epitetin *"I sinqerti dhe i besueshmi",* dhe këtë e dëshmonin edhe armiqtë e tij, para miqve të tij.
- **Drejtësia:** Allahu xh.sh. thotë: ***"Me të vërtetë, Allahu urdhëron për drejtësi dhe bamirësi."***[18] Muhamedi a.s. ishte i drejtë në çdo gjë, si ndaj bashkëshorteve të tij, ndaj shokëve, njashtu edhe ndaj armiqve të tij.
- **Falja dhe durimi:** Allahu xh.sh. thotë: ***"Le të falin dhe të jenë të durueshëm. A nuk doni që Allahu t'ju falë? Vërtet, Allahu është Falës dhe Mëshirues."***[19] Jeta e Pejgamberit a.s. është e mbushur me raste të shumta ku ai

---

[16] Transmeton Ahmedi, 25813.

[17] Et Tevbe, 119.

[18] En Nahl, 90.

[19] En Nur, 22.

u përgjigj me falje dhe durim. Ndër më të njohurat është falja e tij gjatë çlirimit të Mekës ndaj atyre që kishin qenë armiqtë e tij dhe kishin tentuar ta vrisnin, të cilët ai i la të lirë pa u dëmtuar.

Në rrugën e zbatimit praktik të moralit kuranor, është e domosdoshme që vetëdija kolektive e individëve të shoqërisë të përqafojë këto vlera. Disa nga mënyrat për ta arritur këtë janë:

- **Vëmendja ndaj edukimit familjar:** Prindërit duhet të luajnë rolin kryesor në formimin e fëmijëve të tyre, duke i edukuar ata me moralin e Kuranit.
- **Marrja e shembujve të mirë:** Duhet të nxirren në pah modele reale të njerëzve që kanë pasur moral kuranor, qoftë në të kaluarën apo në kohët moderne, si jetët e pejgamberëve dhe të njerëzve të drejtë. Leximi i jetëve të tyre dhe nxjerrja e mësimeve nga përvojat e tyre janë mënyra të dobishme për ndërtimin moral.
- **Ndërgjegjësimi për rëndësinë e vetëreflektimit:** Individët duhet ta njohin veten, ta shqyrtojnë dhe ta llogarisin vazhdimisht vetveten, pasi kjo është shenjë e përkushtimit të vërtetë ndaj moralit kuranor.[20]

Ka edhe shumë vlera të tjera të larta morale, që janë pasqyruar në jetën e pejgamberëve dhe të njerëzve të drejtë, të cilat Kurani urdhëron të ndiqen. Kjo bën që perceptimi i myslimanit mbi moralin të mos mbetet vetëm një koncept teorik, por të shndërrohet në një realitet praktik, të mishëruar

[20] Rukije Muhamed, *Ahlaku'l Kuran bejne et Ta'lim en Nedhari ve en Nemudhexh el'Ameli,* 24.01.2025. www.mugtama.com.

në shpirtin individual dhe në shoqërinë që ndërtohet mbi këto vlera, ashtu siç ndodhi në kohën e pejgamberëve dhe të pasuesve të drejtë të tyre.

## Baza kuranore e moralit

Kurani përmban shumë ajete që theksojnë rëndësinë e moralit të bukur. Në ajetin e njohur: ***"Vërtet, Allahu urdhëron drejtësinë, bamirësinë dhe ndihmën ndaj të afërmve, e ndalon të keqen...",***[21] theksohet se besimtari duhet të ndjekë drejtësinë dhe të tregojë mëshirë ndaj të tjerëve.

Konceptet *birr* (mirësia, devotshmëria) dhe *ihsan* (bamirësia e përsosur) janë themelore në formimin e karakterit moral.[22] Termat *takva* (ndërgjegje fetare), *sabër* (durim) dhe *shukr* (mirënjohje) lidhen drejtpërdrejt me sjelljen morale të besimtarit. Kurani i nxit besimtarët që të jenë të durueshëm në sprova, të drejtë në marrëdhënie dhe ndihmues ndaj të varfërve e nevojtarëve.[23]

---

[21] En Nahl, 90.

[22] Rahman, Fazlur, *Major Themes of the Qur'an*, Chicago: University of Chicago Press, 1980, 112.

[23] Ibid, 115.

# Shembuj të moralit të bukur në tregimet kuranore

## Muhamedi a.s., si shembull i shkëlqyer i moralit

Kurani, Muhamedin a.s., e paraqet si "*usvetun hasene*", shembull i përsosur i moralit të bukur. Ai ishte i drejtë, i mëshirshëm dhe gjithmonë kujdesej për të dobëtit, si dhe për jetën shoqërore të bashkësisë islame.[24]

Allahu xh.sh., në Kuran, thotë: ***"Ju e keni shembullin më të lartë në të Dërguarin e Allahut, për atë që shpreson në shpërblimin e Allahut dhe në botën tjetër, dhe që e përmend shpesh Allahun."***[25]

Komentatori i njohur i Kuranit, Ibën Kethiri, në lidhje me këtë ajet shprehet se ai është një bazë shumë solide për ta pasuar dhe ndjekur Sunetin e Muhamedit a.s., qoftë në të folur, në veprime apo në gjendje shpirtërore.[26] Sipas tij, ky ajet nuk kufizohet vetëm në aspektin e besimit teorik, por përfshin edhe praktikën jetësore të besimtarit, e cila mishërohet në ndjekjen e modelit profetik. Në këtë kuptim, Suneti i Muhamedit a.s. përbën interpretimin praktik dhe zbatimin konkret të mesazhit kuranor.

Kështu, Ibën Kethiri, e sheh këtë ajet si një thirrje të qartë që besimtari të mos kufizohet në leximin apo dëgjimin e fjalës së Zotit, por ta përkthejë atë në jetë përmes përputhjes me

---

[24] El Buhari, Muhamad. *Sahih el Buhari*, nr. 3558.

[25] El Ahzab, 21.

[26] Imam Hafidh ebil Fida Ismail ibën Kethir el Kureshi ed Dimeshki, *Tefsirul Kur'anil adhim*, Darul marife, Bejrut, vëll. III, 1993, f. 474.

fjalët dhe veprat e të Dërguarit a.s., i cili është shembulli më i përsosur i zbatimit të udhëzimit hyjnor.

Njerëzit, sipas natyrës së tyre, tërhiqen pas atij që është i karakterizuar me tiparet e besimit dhe i pasuruar me moralin e mirë islam, që ndjek rrugë dhe veprime të larta, dëshiron të mirën për të tjerët dhe largon prej tyre të keqen, si dhe është i sinqertë në marrëdhëniet dhe veprimet e tij.

Në përgjithësi, njerëzit presin që thirrësit në Islam (predikuesit) të jenë praktikues të Sunetit, të pasuruar me moralin dhe virtytet e mëdha të Islamit, pa hipokrizi, pa interes të keq dhe pa dyfytyrësi.[27]

Leximi dhe reflektimi mbi Kuranin forcon imanin dhe kultivon virtytet morale. Ajetet që flasin për të vërtetën, drejtësinë dhe durimin ndikojnë drejtpërdrejt në formimin e karakterit të individit. Kurani nuk edukon vetëm individin dhe familjen, por edhe shoqërinë në tërësi. Ai thekson rëndësinë e bashkëjetesës, respektit ndaj të afërmve dhe ndihmës ndaj të varfërve, duke krijuar kështu një kulturë të përgjegjësisë morale dhe sociale.[28]

[27] Abdurahim el Magdavi, *El Usus el Ilmije li Menhexhi edda'veti el Islamije*, Darul hadare li Neshër ve Tevzi, bot. 3, Riad, 2018, f. 751.

[28] Muhamed Tabari. *Xhami' el Bejan fi tefsir'il Kuran*, vëll. III, Bejrut: Dar el Fikër, 1986, f. 88.

# Përfundimi

Kurani është udhëzues i përhershëm për moralin e bukur. Ai ofron shembuj të qartë për formimin e karakterit dhe zhvillimin e sjelljeve pozitive, të bazuara në drejtësi, durim, mëshirë dhe devotshmëri ndaj Zotit. Studimi i tregimeve kuranore dhe reflektimi mbi ajetet e moralit ndihmon besimtarët të ndërtojnë një jetë me vlera të qëndrueshme dhe të përhershme.

Në këtë punim u trajtuan konceptet morale në Kuran dhe u paraqitën shembuj konkretë të zbatimit të tyre në praktikën e jetës profetike. Kurani thekson fuqishëm përforcimin e virtyteve morale në jetën e individëve dhe të shoqërive, duke ofruar zgjidhje praktike dhe shpirtërore për përmirësimin e marrëdhënieve njerëzore dhe ndërtimin e një shoqërie të bazuar mbi drejtësi, mëshirë, sinqeritet, përulësi dhe barazi.

Morali në Islam nuk kufizohet vetëm në aspektin individual, por shtrihet edhe në marrëdhëniet shoqërore, familjare dhe ndërmjet kombeve e popujve. Përmes zbatimit praktik të këtyre vlerave morale, mund të ndodhë një transformim pozitiv në shoqëri, duke forcuar drejtësinë sociale dhe bashkëpunimin ndërnjerëzor.

Nga kjo kuptohet se Kurani ofron një kornizë të plotë morale, nga e cila mund të përfitohet për përmirësimin e realitetit bashkëkohor dhe për orientimin e tij drejt ndërtimit të shoqërive të begata, të drejta dhe tolerante.

Në fund, mbetet një nevojë e ngutshme për aktivizimin e këtyre vlerave kuranore në epokën moderne, veçanërisht në kushtet e ndryshimeve të shpejta që përjeton bota. Prandaj, është e domosdoshme që të vazhdojnë studimet që trajtojnë rolin e moralit kuranor në fushat e ndryshme të jetës sociale, ekonomike, kulturore dhe politike.

**Prof. ass. dr. Musa VILA**

# CILËSITË E INJORANCËS, FANATIZMI DHE DISKRIMINIMI, NUK I PËRKASIN ISLAMIT

عَنْ أَبِي ذَرٍّ قَالَ: إِنَّهُ كَانَ بَيْنِي وَبَيْنَ رَجُلٍ مِنْ إِخْوَانِي كَلَامٌ وَكَانَتْ أُمُّهُ أَعْجَمِيَّةً فَعَيَّرْتُهُ بِأُمِّهِ فَشَكَانِي إِلَى النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ فَلَقِيتُ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ فَقَالَ:

يَا أَبَا ذَرٍّ إِنَّكَ امْرُؤٌ فِيكَ جَاهِلِيَّةٌ. قُلْتُ: يَا رَسُولَ اللَّهِ مَنْ سَبَّ الرِّجَالَ سَبُّوا أَبَاهُ وَأُمَّهُ. قَالَ يَا أَبَا ذَرٍّ إِنَّكَ امْرُؤٌ فِيكَ جَاهِلِيَّةٌ هُمْ إِخْوَانُكُمْ جَعَلَهُمْ اللَّهُ تَحْتَ أَيْدِيكُمْ فَأَطْعِمُوهُمْ مِمَّا تَأْكُلُونَ وَأَلْبِسُوهُمْ مِمَّا تَلْبَسُونَ وَلَا تُكَلِّفُوهُمْ مَا يَغْلِبُهُمْ فَإِنْ كَلَّفْتُمُوهُمْ فَأَعِينُوهُمْ.

*Ebu Dherri r.a., ka thënë: "Vërtet në mes meje dhe një personi nga vëllezërit e mi kishim fjalosje. Nëna e tij ishte joarabe, e unë e turpërova me nënën e tij. Pastaj ai ishte ankuar te Pejgamberi a.s., e kur e takova Pejgamberin a.s., ai më tha: "O Eba Dherr, ti je një njeri me cilësi të injorancës." Unë i thashë: "O i Dërguar i Allahut, kush i ofendon njerëzit, ata ia ofendojnë babën dhe nënën e tij." Ai më tha: "O Eba Dherr, vërtet ti je njeri me cilësi të injorancës. Ata (robërit) janë vëllezërit tuaj në duart tuaja. Ushqeni*

*ata nga ajo që ju hani, vishni nga ajo që ju vishni, e mos i rëndoni çka nuk mund t'i përballojnë, e nëse i ngarkoni, atëherë ndihmojuni atyre."*[1]

## Fjalët e panjohura në hadith

Fjala *"ajertuhu"* ka kuptimin e *turpit, me i dhënë përkatësi të turpit*. Thuhet t'i ketë thënë: *"O djali i zezakes"*.[2] Në një version tjetër thuhet: *"e kam ofenduar një person, apo në mes meje dhe atij janë shkëmbyer ofendime, të shara"*.

Fjala *"rexhulun"* - *burrë, person,* thuhet ky person ka qenë myezini Bilalli r.a., të cilit Ebu Bekri r.a. i kishte dhuruar lirinë.

Fjala *"e'axhemije" (e huaja),* d.m.th. secili person që nuk e flet pastër gjuhën arabe konsiderohet *i huaj - e'axhemije,* pavarësisht a është arab apo joarab.[3] Nëna e Bilallit ishte e huaj, me prejardhje nga Etiopia.

Thënia *"fike xhahilijjun"* - *"Ti ke cilësi të injorancës"* apo ofendimi është vepër jomorale dhe veti e injorancës.

Fjala *"havele"* është emër që i dedikohet robit dhe robëreshës. Njëjësi është *"hailun"* - *rob*. Ky emër përdoret edhe për *çobanin, rojtarin*. Thuhet përdoret ky emër për *pronësi - et tahvilu*, d.m.th. me qenë pronar apo *të posedosh* - et temliku.

---

[1] "Sahihul Buhari", Kitabul iman, vëll. I, f. 13, nr.30; "Sahihu Muslim", vëll. III, f.1882, nr.1661.

[2] Ibën Haxher, "*Fet'hul Bari*", vëll. I, f. 86.

[3] El Ajni, "*Umdetul Karij*", vëll. I, f. 208.

*Fjala "ve la tukel-lifuhum"* - *Dhe mos i rëndoni*, d.m.th. robërit mos i rëndoni fizikisht me barra dhe punë të rënda, apo me ndonjë *urdhër që është i vështirë për t'u kryer*.

## Shpjegimi i hadithit

Hadithi i mësipërm tregon dhe udhëzon se nuk lejohet assesi që myslimani ta ofendojë vëllain e tij, e as t'i japë përkatësi të turpit, e as të krenohet me përkatësinë e prindërve dhe as të ndihet me i ngritur se të tjerët, edhe nëse tjetri është shërbëtor, çoban apo rob.

Përderisa sahabët qëndronin në ndejë të përbashkët, papritmas Ebu Dherri e kishte turpëruar Bilalin r.a., duke i thënë: *"O biri i zezakes."* Atëherë Bilali iu ankua Pejgamberit a.s. për këtë ofendim. Pejgamberi a.s. u hidhërua shumë dhe e qortoi Ebu Dherrin duke i thënë se ofendimi është cilësi dhe veti paraislame, ndërsa në Islam, njerëzit janë të barabartë në të gjitha dispozitat e fesë, dhe nuk ka vend për diskriminim për shkak të etnitetit, gjuhës apo ngjyrës së trupit.

Në kushtetutën islame, ekziston vetëm një emër, ai është mysliman. Nuk ka njerëz të zinj, ezmerë, të kuqë apo të bardhë. Ne nuk njihemi përmes ngjyrave, përmes përkatësive etnike, etniteteve, gjuhëve dhe as vendeve. Ne njihemi vetëm me fjalën *La ilahe il-lall-llah* dhe në bazë të adhurimit.[4]

[4] Aid el Karnij, "*El misku vel inberu fi hutabil minber*", f.70.

# Përparësia matet me devotshmëri

Përparësia e vërtetë qëndron në devotshmëri. Ai që nuk ka devocion nuk ka pse të mbështetet në përkatësinë apo gjenealogjinë e tij. Ndërsa, ai që është i shtresës së ulët, gjenezën e përfiton me devotshmëri. Allahu xh.sh. thotë: ***"Vërtet se më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që është më i devotshmi."*** *(El Huxhurat, 13).*

Ebu Dherri r.a., tregon se Pejgamberi a.s., me një rast i kishte thënë: *"Shiko, ti nuk je më i mirë se njeriu i kuq e as se ai i ziu, sepse përparësia është me devotshmëri."*[5]

Pejgamberi a.s., që në start të thirrjes islame kishte vendosur këtë parim, se nuk ka pasuri, pozitë, etni, apo ngjyrë, por ka devotshmëri dhe adhurim. E kur në skenë u shfaq Ebu Dherri me këtë ofendim dhe e shkatërroi atë parim, atëherë ai a.s., iu përgjigj: *"Vërtet ti je njeri me cilësi të injorancës (paraislame)",* dhe kërkoi nga ai që të distancohet menjëherë nga veset e së kaluarës dhe të ndihet i njëjtë me të ziun, me ezmerin dhe me të kuqin. Thuhet se kjo ngjarje kishte ndodhur ende pa e ditur Ebu Dherri ndalesën e saj, dhe kjo cilësi kishte mbetur tek ai për shkak se një kohë të gjatë kishte qenë larg nga Pejgamberi a.s..

Barazinë ndërmjet njerëzve, Resulullahu a.s., e kishte proklamuar edhe në Hytben e mirënjohur gjatë ditëve të haxhin në Mine: *"O ju njerëz, vërtet Zoti juaj është Një, dhe babai juaj është një (Ademi). Kini kujdes! Nuk ka përparësi*

---

[5] "Fet'hul Barij", vëll. X, f. 468; "Musned Ahmed",vëll. V, f.158.

*arabi nga i huaji, as i huaji nga arabi, as i kuqi nga i zi, as i ziu nga i kuqi, përveçse me devotshmëri."*[6]

Kur i Dërguari a.s. tuboi tre myslimanët nga tri vendet e ndryshme, respektivisht Selmanin nga Persia (Irani), Suhejbin nga romakët e bardhë dhe Bilalin nga Etiopia, një arab i quajtur Kajs hyri brenda dhe këta i quajti të huaj - *el e'axhemij.* I Dërguari i Allahut a.s. qe zemëruar shumë dhe i tha: *"Edhe yt atë është i njëjtë, edhe feja juaj është e njëjta, ndërkaq arabizmi për të cilin, me sa po shihet, po krenohesh aq shumë, nuk i takon as babait tënd dhe as nënës sate (duke menduar se Ademi dhe Hava janë prindërit e të gjithë juve).*" Pastaj deklaroi: *"Nuk është prej neve (prej umetit islam) kush propagandon fanatizmin fisnor (etninë), kush lufton për të, dhe kush e jep jetën për të."*[7]

## Eliminimi i robërisë përmes vëllazërisë

Pjesa e hadithit në të cilin Pejgamberi a.s., ka thënë: *"Ata (robërit) janë vëllezërit tuaj në duart tuaja",* paraqet atë se si Pejgamberi a.s., robërve ua jep epitetin e vëllazërisë. Me këtë barazi, që e shpreh Pejgamberi a.s., eviton çdo diskriminim racor dhe strukturor në mes njerëzve në shoqëri. Ky deklarim i Pejgamberit a.s. ishte një hap i madh drejt eliminimit të robërisë në mënyrë graduale. Në këtë kohë, i tërë sistemi shoqëror ishte i ndërtuar në kurriz të robërisë, e deklaratat e tilla ishin të çuditshme për shoqërinë e asaj kohe. Sa për ilustrim thuhet se, qyteti i Romës në Perandorinë Romake, kishte

---

[6] "Musned Ahmed", vëll. 47, f. 478, nr. 22391.

[7] "Sunen Ebi Davud", vëll. XIII, f. 325, nr. 4456.

dyqind e katërmbëdhjetë mijë qytetarë të lirë, ndërsa kishte më tepër se njëzet milionë robër apo skllevër. Ligji parashihte dënime të ndryshme sa u përket këtyre shtresave edhe nëse vepra e bërë ishte e njëjtë. Robi, i cili vidhte vritej, kurse për atë që llogaritej i lirë mjaftonte që sendin e vjedhur ta kthente. Me një fjalë, robërit as që trajtoheshin si njerëz, e lëre më si vëllezër.

Në mënyrë të qartë Pejgamberi a.s. kërkoi që, ushqimi dhe veshja të jenë të barabarta ndërmjet qytetarëve të lirë dhe robërve, apo edhe shërbëtorëve.

Thënia në hadith *"mos i rëndoni",* është urdhër i prerë që ngarkesa të mos jetë jashtë suazave njerëzore, dhe atë që mund ta bartë zotëria, mund të ngarkohet edhe robi apo shërbëtori. Mos i ngarkoni fizikisht jashtë mundësisë së tyre, po ashtu edhe psiqikisht mos i ngarkoni me urdhra që janë të vështira, dhe mos ju bëni presion që ata të ndihen të kategorisë së dytë, apo edhe më të ulët. Aq sa ju mund t'i përballoni aq edhe mund t'i ngarkoni, e nëse i ngarkoni më shumë, të jeni të kujdesshëm dhe u ndihmoni në punët e tyre fizike dhe mendore.

## Kush është Ebu Dherri, protagonisti i hadithit

Emri i tij është Xhundeb, d.m.th. lloj zogu, djali i Sufjan el Gafarijut. Konsiderohet prej sahabëve të vjetër, ishte i pesti me radhë që e përqafoi Islamin. Vinte nga fisi Gafar, i cili ishte fis problematik dhe i njohur për plaçkitje të udhëtarëve - cuba. Kur e pa Pejgamberi a.s. duke ardhur për të hyrë në Islam buzëqeshi duke thënë: *"Vërtet kë do e udhëzon*

*Allahu."* Kjo ngjarje kishte ndodhur në Mekë. Pejgamberi a.s. e urdhëroi të kthehej te fisi i vet për t'i udhëzuar në rrugën e vërtetë. Ishte guximtar, pasi pranoi Islamin, në prezencën e politeistëve e ngriti zërin duke cituar dëshminë – shehadetin, edhe pse kjo i kushtoi me rrahje. Kishte qëndruar disa vite te fisi i tij, e kur Pejgamberi a.s. ishte shpërngulur në Medine, ky kishte arritur që me vete ta marrë fisin e tij Gafar dhe të shkonte në Medine. Kur i pa Pejgamberi a.s. u mahnit dhe përpiqej që t'ia zë në gojë emrin e tij dhe i tha Ebu Nemle.[8] Ai ia kujtoi Ebu Dherr. Pejgamberi a.s., i tha - po, Ebu Dherr. Pastaj filloi duke u lutur: *"Ky është fisi Gafar, Allahu e pastë falë, erdhën në Islam, Allahu i shpëtoftë."*[9]

Mandej u drejtua kah ky trim i madh me fjalët: *"Toka nuk ka bartur e as qielli nuk ka strehuar njeriun më të sinqertë të fjalës sesa Ebu Dherrin."*[10]

Ai nuk kishte marrë pjesë në luftën e Bedrit, Uhudit dhe Hendekut për shkak se ishte te fisi i tij larg nga Pejgamberi a.s., por, ishte shembull në luftën e Tebukut. Atë e kishte vonuar deveja e tij, e cila i kishte ngordhur në rrugë. E ky ia mësyu në këmbë, tërë atë rrugë të gjatë shkretinore dhe të nxehtë derisa e arriti Pejgamberin a.s. me shokët e luftës. Pejgamberi a.s., kur e pa i tha: "*Për sa hapa që ke bërë, Allahu për aq t'i shleftë mëkatet.*"

---

[8] En Nemël është buburrec, e më të voglit të buburrecit i thuhet Dherr.

[9] "Sahihul Buhari", vëll. IV, f.95, nr. 951; "Sahihu Muslim", vëll. III, f. 446, nr.1095.

[10] "Sunen Ibën Maxhe", vëll. I, fq. 181, nr.152.

Pejgamberi a.s. fliste fjalë të mira për të. Ebu Dherri shpesh e pyeste për këshilla. Një herë i tha Pejgamberit a.s. që ta këshillojë për diçka. E Pejgamberi a.s. e këshilloi duke i thënë: *"Të këshilloj me lexim të Kuranit, sepse ai është dritë për ty në Tokë, e në qiell rikujtim për ty."* Ebu Dherri i tha: *"Më shto edhe diçka."* Ai i tha: *"Gjithnjë shiko atë që është më i varfër se ti, e mos shiko atë që është më i pasur se ti, se vërtet vetëm kjo është më e drejtë për të mos e përbuzur begatinë e Allahut për ty."*[11]

Nganjëherë Pejgamberi a.s., i drejtonte pyetje Ebu Dherrit: *"Cili është qëndrimi yt, nëse has në udhëheqës të korruptuar që përvetësojnë pasuri?"* Ai u përgjigj: *"Me shpatë do t'i luftoj ata*." Atëherë Pejgamberi a.s. buzëqeshi dhe i tha: *"A do të të tregoj se cila është më mirë (të veprosh)? Përmbahu derisa të më takosh mua."*

Pasi kaloi koha e Ebu Bekrit dhe Omerit r.a., pasuan njerëz, të cilët përvetësuan paranë dhe pronën publike, e në anën tjetër kishte të atillë që nuk iu jepnin të varfërve. E, Ebu Dherri duke ecur rrugës së tregut ngrittë zërin duke thënë: *"Përgëzoj ata që deponojnë pasurinë, arin dhe argjendin me ndëshkim të hekurit në zjarr."*

Kur Ebu Dherri pati rastin ta shohë pallatin, që e kishte ndërtuar Muaviju, i tha: *"Nëse e ke bërë me paranë e myslimanëve, kjo është tradhti, e nëse e ke bërë me paranë tënde kjo është e tepërt (israfë). O Muavij, vërtet ti të pasurin e ke pasuruar edhe më tepër, e të varfrin e ke varfëruar."*

---

[11] "El Mu'xhemul kebir lit Taberanij", vëll. II, f. 214, nr.1628.

Ishte i njohur për asketizëm, thuhet se i përngjante Isait a.s. në tërheqje (ruajtje) prej kësaj bote. Ai e konsideronte haram deponimin e pasurisë tek individi më tepër se sa ka nevojë. Ai thoshte: *"Mua më mjafton kafshata ditore."*

Ebu Dherri kishte refuzuar të jetë emir - princ në Irak. Ai u kishte thënë: *"Për Allahun jo, ... assesi nuk mundeni të më anoni mua në dynjanë e juve."*

Kështu ai kishte zgjedhur të jetonte në shkretëtirë në Rrebdhe i izoluar prej njerëzve, vetëm me gruan dhe djalin e tij të vogël. Pejgamberi a.s., në luftën e Tebukut, kur e pa të vetmuar duke ardhur në këmbë tha: *"Allahu e mëshiroftë Ebu Dherrin, i vetëm po ecën, i vetëm do të vdesë dhe i vetëm do të ringjallet."*[12]

Vërtet ai ishte i vetëm duke ecur për në luftën e Tebukut, ishte i vetëm kur vdiq në shkretëtirën Rrebdhe, dhe i vetëm do të ringjallet inshallah, ngase mirësitë e tij ishin të shumta, kështu që afër tij nuk ka vend për të tjerët.

Ishte njeri me tipare të veçanta, zhvilloi një jetë më ndryshe se të tjerët, ishte shumë guximtar, tërë jetën ia kushtoi Islamit, askujt nuk iu nënshtrua për çështje të kësaj bote, askënd nuk e imitoi në pasuri, veshje, dukje dhe qëndrime. Pejgamberi a.s., ka thënë: *"Askush të mos imitoj: të thotë: nëse njerëzit bëjnë mirë, bëj edhe unë, e nëse bëjnë keq, bëj edhe unë. Por, edukoni veten të bëni mirë kur ata bëjnë mirë, e kur bëjnë keq, atëherë ju të mos bëni padrejtësi."*[13]

---

[12] "El Mustedrek ala s-sahihajni lil Hakim", vëll. III, f. 52, nr. 4373. Ibën Haxher, "El Isabe fi temjiz es sahabe".

[13] "Sunen et Tirmidhij", vëll. VII, f. 290, nr.1930.

Ebu Dherri ka transmetuar nga Pejgamberi 281 hadithe. Vdiq në shkretëtirën Rrebdhe afër Medinës në vitin 32 h.. Përkujdesjen e tij në përgatitjen e varrimit dhe faljen e xhenazes ia kishte bërë Abdullah bin Mesudi. Ky ishte një paralajmërim i Pejgamberit a.s.: *"Për Allahun, një njeri nga ju do të vdes në shkretëtirë, e në atë do të prezantojnë një grup prej besimtarëve."*

Dhe vërtet kështu ndodhi, në xhenazen e tij prezantuan grupi i besimtarëve në krye me Ibën Mesudin.

**Dr. Fikret KARÇIQ***

# ISLAMI DHE INTEGRIMI EVROPIAN - ÇËSHTJA E INSTITUCIONALIZIMIT TË ISLAMIT[1]

Myslimanët në vendet e Bashkimit Evropian (BE) ndryshojnë në disa aspekte nga dy përqendrimet e tjera të mëdha të myslimanëve në Evropë, ato në Ballkan dhe ato në territorin e republikave të ish-Bashkimit Sovjetik.[2] Dallimet kryesore ndërmjet këtyre grupeve qëndrojnë në historinë, strukturën dhe formën e institucionalizimit. Historikisht, prania e myslimanëve në vendet e BE-së është më e vonshme dhe, në një masë të madhe, fillon në vitet pesëdhjetë të shekullit XX me valët e emigrantëve ekonomikë dhe politikë, që erdhën në Evropë nga bota myslimane. Ndërsa prania e myslimanëve

---

* **Fikret Karçiqi** (Allahu e pastë mëshiruar) ka qenë doktor i shkencave juridike, profesor i rregullt në Fakultetin e Shkencave Islame në Sarajevë, në lëndët *Historia e së drejtës së Sheriatit* dhe *Teoria e shtetit dhe ligji*, dhe profesor i rregullt në Fakultetin Juridik në Sarajevë në lëndën *Historia e përgjithshme e shtetit dhe të së drejtës*.

1 Dr. Fikret Karčić, "Islam i evropske integracije: Pitanje institucionalizacije islama", *Religija i evropske integracije,* Fakulteti i Shkencave Politike, Sarajevë, 2006, f. 187-199.

2 Më shumë për këtë shih: Jorgen Nielsen, *Muslims in Western Europe*, Edinburgh University Press, Edinburgh, 1995.

në Ballkan daton që nga pushtimet osmane në shekujt XIV dhe XV.

Sa i përket strukturës, komunitetet myslimane në Bashkimin Evropian janë heterogjene dhe përbëhen nga emigrantë, pasardhësit e tyre, anëtarë të brezit të dytë e të tretë, të cilët shpesh kanë vetëm lidhje simbolike me vendet e origjinës së prindërve të tyre, si dhe nga të konvertuarit evropianë në Islam.

Ndërsa në aspektin e shkallës dhe formës së organizimit fetar institucional, myslimanët në vendet e BE-së ndryshojnë nga myslimanët e Ballkanit, të cilët i kanë institucionet e tyre fetare të formuara nën ndikimin osman. Në modelin e institucionalizimit të Islamit dhe zhvillimit post-osman në shtetet nacionale ballkanike, myslimanët në vendet e BE-së po lëvizin gradualisht drejt institucionalizimit, duke kaluar nga niveli lokal në atë kombëtar dhe potencialisht në nivel transnacional. Në këtë tekst do të trajtojmë pikërisht këtë fenomen të fundit.

## Çfarë është institucionalizimi i Islamit?

Me *"institucionalizimin e Islamit"* kuptojmë procesin e krijimit të institucioneve islame që ua mundësojnë myslimanëve praktikimin e fesë së tyre dhe rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet këtyre institucioneve dhe kornizës shtetërore brenda së cilës ato veprojnë. Prandaj, institucionalizimi i Islamit është një proces me dy aspekte: 1. dhënien e statusit ligjor Islamit në kuadër të marrëdhënieve të përgjithshme ndërmjet shtetit dhe fesë në shtetet anëtare të BE-së; dhe 2. formimin e institucioneve dhe organizatave të ndryshme my-

slimane që kanë funksion të udhëheqjes fetare, ruajtjen, zhvillimin dhe transferimin e njohurive dhe mundësimi i praktikës fetare.

Myslimanët dhe shtetet ku ata jetojnë marrin pjesë në këtë proces me theks të ndryshëm. Sipas logjikës së zhvillimeve, në aspektin e parë - dhënia e statusit institucional Islamit - rolin dominues e luan shteti, i cili e realizon këtë duke ndjekur sistemin e vet të rregullimit të marrëdhënieve ndërmjet autoritetit politik dhe atij fetar. Në aspektin tjetër - formimin e institucioneve islame - rolin mbizotërues, madje shpesh ekskluziv, e luajnë vetë myslimanët, edhe pse në disa raste është e mundur që shteti të ndërhyjë në këtë proces.

Korniza e referencës, së cilës i referohen myslimanët gjatë procesit të ndërtimit të institucioneve fetare, është e larmishme. Në pjesën më të madhe, kjo kornizë bazohet në përvojën e popujve myslimanë shumicë, të cilët përgjatë historisë së tyre kanë ndjekur konceptin e unitetit organik ose funksional të autoritetit politik dhe atij fetar. Ndërkaq, popujt myslimanë, që për një periudhë të historisë së tyre kanë pasur status minoriteti në vende jomyslimane, siç është rasti i myslimanëve të Ballkanit, kanë përvojë më të madhe lidhur me procesin e institucionalizimit të Islamit në një mjedis jomysliman. Megjithatë, kjo përvojë nuk është përpunuar teorikisht nga autorët myslimanë, dhe zgjidhjet e arritura nuk kanë fituar rëndësi normative për myslimanët jashtë rajoneve prej nga burojnë.

Çështja e institucionalizimit të religjionit në përgjithësi, dhe e Islamit në veçanti, shtrohet kryesisht në Evropë, ku ekzistojnë sisteme të ndryshme të rregullimit të marrëdhënieve ndërmjet autoritetit politik dhe atij fetar. Kjo temë, për shem-

bull, nuk diskutohet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku ekziston një sistem i veçantë i marrëdhënieve ndërmjet religjionit dhe shtetit, dhe ku shteti nuk ndërhyn në debatet që lidhen me institucionalizimin e religjionit.[3]

## Statusi institucional i Islamit në vendet e BE-së

Gjatë dy dekadave të fundit, vendet e Bashkimit Evropian, secila brenda juridiksionit të vet, kanë marrë një sërë masash për të përcaktuar statusin ligjor të Islamit.[4] Ecuria e këtij procesi është ndikuar nga një sërë faktorësh, ashtu siç përmendin Robert Alufi Beck-Peccoz dhe Giovanna Zincone në librin *"Pozicioni juridik i pakicave islame në Evropë",* të cilin e kemi përdorur gjerësisht në hartimin e këtij teksti.[5]

Së pari, ka qenë i rëndësishëm modeli me të cilin rregullohen marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe religjionit në një vend të caktuar evropian (sistemi i religjionit shtetëror, komunitetet fetare të njohura, ndarja e shtetit nga religjioni, etj.).[6]

---

[3] Jocelyne Cesari, "Islamic Minorities Rights in Europe and in the USA", në *The Legal Treatment of Islamic Minorities in Europe*, ur. Roberta Aluffi B.-P. i Giovanna Zincone (Peeters, 2004), 23.

[4] Më shumë për këtë shih: *Islam and European Legal Systems*, ur. Silvio Ferrari i Anthony Bradney (Dartmouth: Ashgate, 2000).

[5] *The Legal Treatment of Islamic Minorities in Europe*, ur. Roberta Alufi Beck-Peccoz i Giovanna Zincone (Peeters, 2004), 324.

[6] Më shumë rreth këtyre sistemeve, shih: *Religious Meedom and the Position of Islam in Western Europe*, ur. W. A. R. Shadid i PS. van Koningsveld (Kampen: Kok Pharos, 1995), 7-23.

Së dyti, ka pasur rëndësi fakti nëse Islami në atë vend është një fenomen i vjetër apo i ri. Në rastet kur një shtet kishte përvojë historike në rregullimin e pozitës së Islamit para valës së emigracionit, ajo përvojë ka ndikuar dukshëm në zgjidhjet e mëvonshme.

Së treti, ka qenë i rëndësishëm qëndrimi i shtetit ndaj pakicave, sepse pozita e myslimanëve zakonisht trajtohet brenda kornizës së përgjithshme të politikave për pakicat.

Së katërti, një rol të veçantë ka luajtur edhe përvoja koloniale e ndonjë shteti në botën myslimane, pasi lidhjet e krijuara në të kaluarën shpesh janë reflektuar deri në ditët e sotme.

Në vendet ku ekziston një ndarje strikte ndërmjet shtetit dhe religjionit, institucionalizimi i Islamit në parim nuk konsiderohet çështje politike dhe i lihet kryesisht iniciativës së myslimanëve. Përjashtim paraqet Franca, ku qeveria, që nga viti 1989, përmes Ministrisë së Punëve të Brendshme, ka ndërmarrë një sërë masash që synojnë organizimin fetar të myslimanëve. Kjo ndërhyrje e ka vënë shtetin laik në një pozicion paradoksal - që të merret drejtpërdrejt me çështje fetare.

Në vendet ku ekziston një lidhje institucionale ndërmjet shtetit dhe religjionit, qoftë në formën e një religjioni shtetëror apo të një sistemi bashkëpunimi me komunitetet fetare, pjesëmarrja e autoriteteve shtetërore në institucionalizimin e Islamit ka qenë e konsiderueshme. Për shembull, vende të tilla si Belgjika, Italia dhe Spanja, të cilat ndjekin modelin e bashkëpunimit ndërmjet shtetit dhe religjionit, e kanë inkurajuar procesin e institucionalizimit të Islamit.

Në shtetet që ndjekin modelin e religjionit shtetëror, si Mbretëria e Bashkuar, Danimarka dhe Greqia, njohja e Islamit ka qenë e ngadaltë ose po ecën ngadalë për shkak të rezistencës së strukturave fetare tradicionale. Është me interes të theksohet se në disa raste, si në Mbretërinë e Bashkuar, myslimanët nuk kanë kërkuar heqjen e sistemit të religjionit shtetëror, por shtrirjen e privilegjeve të këtij sistemi edhe mbi Islamin. Në këto raste, përfaqësuesit myslimanë nuk kanë zgjedhur modelin e ndarjes absolute, i cili do të siguronte trajtim të barabartë për të gjitha religjionet.

Të ndikuara nga këta dhe faktorë të tjerë, vendet e BE-së kanë rregulluar individualisht statusin institucional të Islamit gjatë dy dekadave të fundit.

Në vitin 1979, Austria e njohu Bashkësinë Fetare Islame si një korporatë publike, në bazë të ligjit të vitit 1912, i cili fillimisht kishte për synim rregullimin e pozitës së myslimanëve në Bosnje e Hercegovinë, Kroaci dhe Slloveni.[7] Sot, në këtë vend jetojnë 338.988 myslimanë, që përbëjnë 4,2% të popullsisë. Në krye të Bashkësisë Fetare Islame është myftiu. Edukimi fetar zhvillohet në shkollat publike dhe mësuesit e fesë paguhen nga shteti. Austria ka themeluar edhe Akademinë Pedagogjike Islame në Vjenë, e cila financohet nga fondet shtetërore.

Belgjika e njohu Islamin me një ligj federal në vitin 1974. Sipas ndryshimeve në Kushtetutën belge të vitit 2001, këshillat rajonalë janë të autorizuar të miratojnë bashkësitë

---

[7] Wolfgang Wieshaider, *"The Legal Status of Muslim Minority in Austria", në The Legal Treatment of Islamic Minorities in Europe,* 31 -39.

fetare në nivel lokal. Në Belgjikë ekziston një sistem bashkëpunimi midis shtetit dhe religjionit, sipas të cilit shteti ofron ndihmë financiare për komunitetet fetare, duke përfshirë pagat dhe pensionet e klerikëve, por nuk mund të ndërhyjë në çështje dogmatike, organizimin e ritualeve apo emërimet.

Organizimi i Bashkësisë Islame ishte një proces i gjatë që filloi në vitet nëntëdhjetë të shekullit XX, ku morën pjesë si komunitetet myslimane, ashtu edhe shteti. Sot, struktura organizative e Bashkësisë Islame në Belgjikë përbëhet nga: Kuvendi me 61 anëtarë dhe Udhëheqja Fetare (Ekzekutivi) me 17 anëtarë (7 marokenë, 4 turq, 3 belgë dhe 3 të tjerë), e udhëhequr nga presidenti. Kandidatët për Ekzekutiv konfirmohen nga Ministria e Drejtësisë përpara zgjedhjes së tyre. Zgjedhjet janë mbajtur në vitin 1999 dhe 2003.

Belgjika paraqet një rast të shtetit që ndërhyri në organizimin e Bashkësisë Islame.[8] Shpjegimi i kësaj politike është se, në të kundërt, nuk do të ishte e mundur të gjendeshin përfaqësues myslimanë me të cilët të negociohej. Sipas zgjidhjeve të miratuara, shteti miraton emërimin e imamëve dhe siguron pagat e tyre, nëse nuk emërohen nga shtetet e huaja, siç është rasti me Turqinë. Gjithashtu, shteti, me propozim të Ekzekutivit, emëron dhe paguan mësues fetarë në shkollat fillore dhe të mesme. Mungesa e udhëheqjes fetare të njohur ka ndikuar gjatë në aftësinë e myslimanëve për të ushtruar të drejtat e tyre. Për shembull, deri në themelimin e Ekzekuti-

[8] Jean Hallet, "*The Status of Muslim Minority in Belgium*", në *The Legal Treatment of Islamic Minorities in Europe*, Rik Torfs, "*The Legal Status of Islam in Belgium*", në *Islam and European Legal Systems*, 73-95.

vit, mësuesit fetarë myslimanë emëroheshin përkohësisht, për një periudhë njëvjeçare, me paga më të ulëta se kolegët e tyre të feve të tjera.

Franca, bazuar në ligjin e vitit 1905, është një republikë laike, ku asnjë religjion nuk gëzon status të veçantë, por ekziston një garanci e përgjithshme për lirinë e religjionit dhe për ndarjen e religjionit nga shteti.[9] Shteti nuk njeh asnjë religjion dhe nuk e financon atë nga fondet publike. Megjithatë, shteti mund të mbështesë institucionet kulturore ose shoqërore me karakter religjioz.

Besimtarët në Francë mund të organizohen në dy lloje shoqatash: shoqata të përgjithshme, të rregulluara nga ligji i vitit 1901, dhe shoqata fetare, të bazuara në ligjin e vitit 1905. Shoqatat e para mundësojnë aktivitetet sportive, kulturore, arsimore, religjioze apo të tjera. Shoqatat e tilla konsiderohen "të dobishme për publikun" dhe mund të marrin ndihmë nga fondet publike. Myslimanët në Francë kanë rreth 1.560 shoqata të tilla. Shoqatat e tjera janë ekskluzivisht fetare dhe nuk mund të përfitojnë ndihmë nga fondet publike.

Në Francë, në vitin 1990, filloi procesi i formimit të institucioneve, që do të përfaqësonin Islamin dhe myslimanët francezë në nivel shtetëror. Qeveria franceze mori pjesë shumë aktivisht në këtë proces përmes Ministrisë së Punëve të Brendshme. Pas negociatave të gjata me organizata të ndryshme myslimane, në vitin 2002 u arrit një marrëveshje mbi

[9] Brigitte Basdevant-Gaudemet, "The Legal Status of Islam in France", në *Islam and European Legal Systems*, 97-125; Ista, "Islam in France", në *The Legal Treatment of Islamic Minorities in Europe*, 59-83.

strukturën e përfaqësimit fetar mysliman në Francë. Në prill të vitit 2003 u mbajtën zgjedhjet dhe filloi të funksionojë organizata e re fetare.

Institucionet aktuale fetare islame në Francë përbëhen në nivel shtetëror nga: Këshilli Francez për Fenë Myslimane *(Conseil Français du Culte Musulman,* CFCM), Asambleja e Përgjithshme, Drejtoria dhe Byroja. Kryetari aktual i Këshillit është rektor i Xhamisë së Parisit.

Është interesante se formimi i institucioneve nacionale islame në Francën laike u arrit me pjesëmarrjen aktive të shtetit. Më parë, grupe të ndryshme myslimane përpiqeshin të krijonin shoqata ombrellë, por pa sukses. Të tilla ishin Unioni i Organizatave Islamike në Francë (UOIF), i themeluar në vitin 1983 nën ndikimin e Vëllazërisë Myslimane, dhe Federata Kombëtare e Myslimanëve në Francë (FNMF), e themeluar në vitin 1985 nën ndikimin e Marokut.

Në Gjermani jetojnë rreth tre milionë myslimanë, që përbëjnë 3.5% të popullsisë së përgjithshme. Shumica janë me origjinë turke (2.2 milionë). Kushtetuta gjermane e vitit 1949, në Nenin 4, garanton lirinë e fesë dhe të ndërgjegjes.[10]

Sa i përket statusit të bashkësive fetare, ekzistojnë dy lloje shoqatash. Të parat janë "korporata të ligjit publik" – si disa kisha të krishtera dhe komuniteti hebre, të cilat morën këtë status në kohën e shpalljes së Kushtetutës së Weimarit në vitin 1919, dhe pozita e tyre u ruajt nga Kushtetuta gjer-

---

[10] Gerhard Robbers, "The Legal Status of Islam in Germany", në *Islam and European Legal Systems*, 147-155; Mathias Rohe, "The Legal Treatment of Muslims in Germany", në *The Legal Treatment of Islamic Minorities in Europe*, 83-109.

mane e vitit 1949. Komuniteti hebre e mori këtë status edhe pas Luftës së Dytë Botërore. Myslimanët ende nuk e kanë marrë këtë status, për shkak të pranisë së tyre relativisht të shkurtër në vend; shoqatat e tyre konsiderohen si “shoqata të së drejtës private”.

Statusi i një “korporate të së drejtës private” përfshin të drejtën për mbledhjen e kontributeve nga besimtarët, organizimin e bashkësisë lokale, trajtimin e pronës së bashkësive fetare si pronë publike, përjashtimin nga taksat e caktuara, dërgimin e delegatëve në këshillat e stacioneve të radios etj.. Për të marrë këtë status, bashkësitë fetare duhet të kenë organe vendimmarrëse për mësimin fetar dhe të bëjnë publike vendimet e tyre. Bashkësitë myslimane që plotësojnë këto kushte mund të njihen institucionalisht.

Edukimi fetar në shkollat publike është i garantuar nga kushtetuta federale, por mungesa e një partneri adekuat mysliman për zhvillimin e programeve dhe emërimin e mësuesve ka penguar zbatimin praktik të kësaj garancie. Kjo u arrit vetëm për myslimanët me origjinë turke, në emër të të cilëve ndërhyri shteti turk, si pjesë e mësimit në gjuhën amtare, krahas lëndëve të tjera kombëtare.

Në Greqi jetojnë dy kategori myslimanësh: ata në Trakinë Perëndimore, të cilët gëzojnë statusin e pakicës fetare bazuar në marrëveshjet turko-greke të viteve 1920, dhe emigrantët myslimanë që kanë ardhur në Greqi gjatë viteve 1980 dhe 1990.[11] Pozicioni i të fundit nuk i nënshtrohet një rregu-

[11] Konstantinos Tsitselikis, “Personal Status of Greece’s Muslims: A Legal Anachronism or an Example of Applied Multiculturalism”, u *The Legal Treatment of Islamic Minorities in Europe*, 109-133.

lloreje të veçantë. Myslimanët në Trakinë Perëndimore kanë institucionet e tyre religjioze, të trashëguara nga periudha osmane. Në krye të hierarkisë religjioze janë myftinjtë me seli në qytetet Komotini, Xanthi dhe Didimotiho, të cilët mbikëqyrin punën e imamëve dhe hatibëve, vakëfeve, medreseve dhe zbatojnë ligjin e Sheriatit në çështjet e statusit personal të myslimanëve. Ligji që rregullon këtë është Ligji Nr. 1920/1991.

Situata ndryshon për grupet e reja myslimane në Athinë. Ata nuk kanë xhami zyrtare, nuk kanë imamë të autorizuar për kryerjen e martesave dhe nuk kanë organizata zyrtare fetare që përfaqësojnë të gjithë myslimanët. Disa grupe etnike myslimane të emigrantëve, si pakistanezët dhe bangladeshianët, kanë shoqata që kryejnë gjithashtu funksione fetare.

E drejta e myslimanëve për të aplikuar Sheriatin në çështjet personale është ekskluzive për Trakinë Perëndimore dhe sot përbën një fenomen unik në Evropë. Myslimanët kanë të drejtë të zgjedhin midis juridiksionit të gjykatave civile ose të myftiut. Praktikisht, zbatimi i ligjit të Sheriatit është i detyrueshëm për të gjithë myslimanët e Trakisë Perëndimore. Myftinjtë emërohen nga qeveria, kanë statusin e nëpunësit shtetëror dhe vendimet e tyre janë të zbatueshme.

Sipas vlerësimeve të vitit 2003, rreth një milion myslimanë jetojnë në Itali, nga të cilët rreth 10,000 janë të konvertuar në Islam. Kushtetuta italiane garanton lirinë e religjionit dhe barazinë e të gjitha bashkësive fetare para ligjit (Neni 8). Marrëdhëniet e tyre me shtetin rregullohen me ligj përmes kontratave të veçanta (**intese**) me bashkësitë fetare. Një kontratë e tillë mes qeverisë italiane dhe përfaqësuesve të myslimanëve ende nuk është finalizuar, kryesisht për shkak të

mungesës së një përfaqësuesi autoritar mysliman, pavarësisht disa përpjekjeve të ndërmarra në fund të shekullit XX dhe fillim të shekullit XXI.

Shumica e shoqatave myslimane në Itali kanë karakter të shoqatave të së drejtës së përgjithshme, ndërsa vetëm Qendra Kulturore Islame e Italisë (CICI) gëzon statusin e një organi fetar të njohur *(ente morale di culto).* Në literaturë konstatohet se, edhe pa një kontratë zyrtare me Bashkësinë Myslimane, legjislacioni italian ofron zgjidhje të kënaqshme për nevojat bazë të myslimanëve, veçanërisht përmes Ligjit për Religjionet e Pranuara të vitit 1929.[12]

Komunitetet myslimane kanë një status të ngjashëm, shoqata private, në Portugali.[13] Kushtetuta aktuale portugeze miraton parimin e ndarjes së religjionit nga shteti, garanton lirinë fetare dhe ndalon diskriminimin në bazë të fesë. Megjithatë, Kisha Katolike Romake, bazuar në konkordatin e vitit 1940, gëzon privilegje që nuk u takojnë pasuesve të feve të tjera. Në vitin 2001, u miratua Ligji i ri për Lirinë e Religjionit, i cili lejon që shoqatat religjioze me karakter privat-juridik, siç kanë zakonisht myslimanët, të shndërrohen në subjekte fetare-juridike brenda tre viteve. Parashikohet gjithashtu formimi i Komisionit për Liritë Religjioze, si organ kë-

---

[12] Stefano Allievi i Franseco Castro, “The Islamic Presence in Italy”, në *Islam and European Legal Systems*, 155-181; Roberta Aluffi Beck-Peccoz, “The Legal Treatment of Muslim Minority in Italy”, në *The Legal Treatment of Islamic Minorities in Europe*, 133-159.

[13] Jose Leitao, “The New Islamic Presence in Portugal: Toward a Progressive Integration”, në *The Legal Treatment of Islamic Minorities*, 179-195.

shillimor për qeverinë dhe parlamentin. Kushtet e reja pritet të inkurajojnë bashkimin e rreth 39,000 myslimanëve në një organizatë të nivelit kombëtar.

Sipas regjistrimit të vitit 2001, në Mbretërinë e Bashkuar jetonin rreth 1.591.000 myslimanë. Edhe pse Kisha e Anglisë gëzon statusin e religjionit dominues, ka liri të gjerë për shprehjen e religjioneve të tjera, përfshirë Islamin. Këto religjione njihen de facto nga rregullore të shumta ligjore që lidhen me edukimin, kujdesin shpirtëror, ligjin personal, therjen e kafshëve etj.. Myslimanët janë të organizuar në shoqata private-juridike. Në mesin e viteve 1990, kishte rreth 950 shoqata të tilla myslimane. Gjithashtu, ekzistojnë organizata ombrellë, si Këshilli Mysliman i Britanisë *(Muslim Council of Britain).*[14]

Sipas vlerësimeve të vitit 2002, rreth 700,000 myslimanë jetojnë në Holandë. Marrëdhëniet ndërmjet fesë dhe shtetit bazohen në parimin e ndarjes. Kishat, religjionet dhe bashkësitë religjioze mund të themelojnë shoqata ose fondacione dhe të fitojnë statusin e një personi juridik sipas rregullave private. Nga pikëpamja organizative, këto shoqata janë të pavarura nga shteti dhe nuk marrin ndihmë financiare publike. Prandaj, nuk ka rregulla specifike ligjore për statusin e Islamit. Formimi i institucioneve islame kryhet në bazë të rregulloreve të përgjithshme ligjore për shoqatat.[15]

---

[14] Humayun Ansari, "The Legal Status of  Muslims in the UK", në *The Legal Treatment of Islamic Minorities in Europe*, 255-289.

[15] Jan Rath et alt.,"Making Space for Islam in the Netherlands", në *The Legal Treatment of Islamic Minorities in Europe*, 159-179.

Në Suedi, që nga 1 janari 2000, vlen parimi i ndarjes së religjionit nga shteti.[16] Deri atëherë, Kisha Ungjillore Luterane, që nga shekulli i XVI, kishte statusin e kishës shtetërore. Pas vitit 2000, rregulloret ligjore suedeze iu përshtatën situatës së re, të karakterizuar nga liria e religjionit dhe barazia ligjore e të gjitha religjioneve. Megjithatë, Kisha suedeze ndoshta do të vazhdojë të mbajë pozitën e privilegjuar mes të barabartëve.

Në Suedi vlerësohet se jetojnë midis 270,000 dhe 350,000 myslimanë. Ekzistojnë tri organizata nacionale ombrellë myslimane të mbështetura nga shteti: Bashkësitë e Bashkuara Islame në Suedi (FIFS), Bashkësitë e Bashkuara Myslimane të Suedisë (SMuF) dhe Unioni i Qendrave Islame të Kulturës (IKUS). Këto tre organizata bashkëpunojnë në Këshillin Islam për Bashkëpunim. Arsyeja kryesore për ekzistencën e organizatave të ndryshme ombrellë është çështja e udhëheqjes dhe e financave.

Përfundimisht, Kushtetuta spanjolle e vitit 1978 (Neni 16) proklamon shekullarizimin e shtetit dhe lirinë e religjionit.[17] Ligji organik mbi lirinë e religjionit i vitit 1980 i zhvillon më tej këto dispozita. Të gjitha kishat, fetë dhe bashkësitë fetare fitojnë statusin e personit juridik duke u regjistruar në Regjistrin e organeve fetare. Këto organe kanë pavarësi të

---

[16] Jonas Otterbeck, “The Legal Status of Islamic Minorities in Sweden”, në *The Legal Treatment of Islamic Minorities in Europe*, 233-255.

[17] Joaquin Mantecon, “Islam in Spain”, në *The Legal Treatment of Islamic Minorities in Europe*, 213-231; Javier Martinez-Torron, “The Legal Status of Islam in Spain”, në *Islam and European Legal Systems*, 47-73.

plotë organizative, përfshirë të drejtën për të miratuar rregulloret dhe rregullat e brendshme, për të krijuar shoqata, fondacione dhe institucione të tjera për të arritur qëllimet fetare. Shteti mund të lidhë kontrata me religjionet e regjistruara, kishat ose bashkësitë religjioze që janë të rrënjosura thellë në Spanjë për nga historia dhe numri i besimtarëve. Ky status iu dha Islamit me ligjin e vitit 1989.

Me kërkesë të qeverisë spanjolle, bashkësitë fetare islame të atëhershme u bashkuan në një federatë me qëllim zhvillimin e negociatave dhe nënshkrimin e kontratave. Një organ i ri u formua në vitin 1992 me emrin Komisioni Islamik Spanjoll (CIE) dhe në prill të të njëjtit vit nënshkroi një kontratë me qeverinë spanjolle. Kjo kontratë rregullon çështjet e statusit të prijësve të komuniteteve fetare, imamëve, xhamive dhe donacioneve; pasojat civile-juridike të martesave të kryera sipas rregullave islame; ndihmën pastorale; mësimin e fesë islame në institucionet arsimore; përfitimet tatimore; festimin e festave islame; dhe bashkëpunimin midis qeverisë dhe Komisionit Islamik në ruajtjen dhe përmirësimin e trashëgimisë historike dhe artistike islame. Komisioni Islamik Spanjoll, si organ i formuar me iniciativën e qeverisë për të përfaqësuar myslimanët, përfaqëson një lloj "federate federatash" dhe nuk ka një udhëheqje të unifikuar dhe efektive.

Nga kjo pasqyrë e shkurtër, mund të konstatohet se statusi institucional i Islamit nuk është zgjidhur në mënyrë uniforme në nivel të Bashkimit Evropian, por ka qenë i rregulluar brenda kornizës së legjislacionit nacional të vendeve anëtare. Në këtë proces, çdo shtet udhëhiqej nga arsyet e veta historike, ligjore dhe politike. Së fundi, dhënia e statusit institucional Islamit ishte rezultat i vullnetit të vet shteteve.

# Niveli i institucioneve islame dhe identiteti i myslimanëve

Në vendet e Bashkimit Evropian ekzistojnë disa nivele të institucioneve islame: lokale, rajonale, nacionale (shtetërore) dhe transnacionale (niveli i BE-së). Në këtë kuadër zhvillohet procesi i formimit të institucioneve islame.[18] Numri më i madh i institucioneve dhe organizatave islame, xhematet, xhamitë, qendrat islame, hoxhallarët, myftinjtë, shoqatat etj., i përkasin nivelit lokal ose, në disa raste, rajonal. Këto institucione bazohen kryesisht në parimin etnik (turq, marokenë, algjerianë, pakistanezë, bangladeshianë, indianë, shqiptarë, boshnjakë etj.), i cili përcakton në mënyrë dominuese identitetin e myslimanëve në BE.

Megjithatë, ndryshimet në strukturën e popullsisë myslimane, veçanërisht paraqitja e gjeneratës së dytë dhe të tretë, e cila identifikohet si “mysliman francez”, “mysliman britanik” ose “mysliman gjerman”, si dhe rritja e numrit të të konvertuarve nga popullsia autoktone, ngre çështje të reja lidhur me identitetin, vetëvendosjen dhe përfaqësimin e myslimanëve. Si rezultat, shtrohet nevoja për institucione islame në nivel nacional (shtetëror).

Në praktikë, këto institucione janë kryesisht “ombrellë” ose federata që përbëhen nga aleanca të organizatave islame në një vend të caktuar. Procesi i krijimit të institucioneve

---

[18] Shih: Melissa Anne Parker, “The Europeanization of Islam: The Role of the Multy-Level Structure of the EU”, paper presented at European Union Studies Association (EUSA): Biennial Conference, 2005 [9th ), March 3l-April 2, 2005.

ombrellë myslimane në vendet anëtare të BE-së është ende në vazhdim dhe ngre pyetje të shumta, siç janë: përfaqësimi i organizatave ekzistuese, autonomia e tyre, mënyra e funksionimit, trajnimi i personelit etj.. Shtetet evropiane e ndjekin me interes këtë proces, pasi duan të dinë se kush i përfaqëson fetarisht myslimanët dhe interpreton Islamin. Nga ana tjetër, myslimanët shfrytëzojnë mundësitë që ua ofron sistemi juridik i vendeve përkatëse.

Literatura thekson se krijimi i institucioneve islame në nivel nacional mund të shihet si një "shprehje e identitetit" ose një "domosdoshmëri taktike". Ai u jep grupeve të ndryshme myslimane mundësi më të mira për të mbrojtur të drejtat e tyre fetare dhe për të realizuar interesat e tyre, duke përfshirë përfaqësimin më efektiv para shtetit dhe shfrytëzimin e përfitimeve që u takojnë bashkësive fetare, si ndihma financiare.[19]

Shembuj të këtij institucionalizimi në nivel nacional janë Franca, Belgjika dhe Spanja, të cilat përkujtojnë pjesërisht historinë e themelimit të Bashkësisë Islame në Bosnje e Hercegovinë gjatë sundimit austro-hungarez dhe zhvillimet e saj të mëvonshme.

Ekziston gjithashtu mundësia e krijimit të institucioneve transnacionale islame në Evropë. Ato mund të shihen si një "shprehje e identitetit" ose një "domosdoshmëri taktike". Nga pikëpamja e identitetit, projekti i një qytetari evropian, i mbrojtur që në fillimet e tij nga BE-ja, mund të mbështesë gjithashtu shfaqjen e një "myslimani evropian", i cili integron aspekte të kulturës evropiane në identitetin e tij. Në këtë

[19] Ibid., 8.

rast, lind nevoja për institucione islame në nivel transnacional.

Nga pikëpamja taktike, sistemi i BE-së mundëson financimin e shoqatave transnacionale të emigrantëve. Ata që janë të pakënaqur me zgjidhjet e marra në nivel nacional mund t'i drejtohen institucioneve transnacionale, duke çuar kështu në formimin e shoqatave me karakter transnacional. Një shembull i tillë është Federata e Organizatave Islame në Evropë (FIOE), e cila vepron si grup lobues dhe pretendon të përfaqësojë myslimanët që jetojnë në BE.

Në literaturë nuk është e qartë se si mund të duket struktura e institucioneve islame në nivel evropian, pasi niveli nacional ende nuk është konsoliduar. Një aspekt interesant është funksioni i iftas - interpretimi i rregullave islame. Sipas zhvillimeve aktuale, ky funksion shihet si kolektiv. Në vitin 1997 u formua Këshilli Evropian për Fetva dhe Kërkime (ECFR) me detyrën për t'u ofruar myslimanëve evropianë interpretime të përshtatshme të porosive islame. Ky këshill identifikohet si "institucion profesional dhe i pavarur", ku shumica e anëtarëve janë dijetarë myslimanë me origjinë arabe. Funksionimi i tij tregon përpjekjen për të krijuar një institucion transnacional, megjithëse sa është përfaqësues i praktikës islame në Evropë mbetet një çështje e hapur.

## Përfundimi

Gjatë dy dekadave të fundit, në vendet e Bashkimit Evropian filloi procesi i institucionalizimit të Islamit. Ky proces përfshin dy aspekte kryesore: dhënien e statusit ligjor Islamit brenda sistemit juridik të vendeve anëtare dhe ndërtimin e institucioneve fetare islame. Deri tani janë themeluar institucione islame në nivele lokale, rajonale dhe kombëtare.

Ekziston gjithashtu një tendencë drejt krijimit të institucioneve transnacionale islame. Në këtë kuadër, mund të vërehet një lidhje midis procesit të integrimit evropian dhe zhvillimit të institucioneve islame: identitetet e reja kërkojnë institucione të reja.

Procesi i ndërtimit të "qytetarit evropian" mund të çojë gjithashtu në formimin e konceptit të "myslimanit evropian", duke reflektuar nevojën për institucione islame që pasqyrojnë realitetin dhe identitetin e myslimanëve në Evropë.[20]

*Përktheu dhe përshtati*
*nga gjuha boshnjake:*
**Dr. Azmir Jusufi**

---

20 VËMENDJE: Ky punim i profesorit të nderuar, Fikret Karçiqi (Allahu e pastë mëshiruar) është botuar më 2006, prandaj shifrat e përmendura në këtë punim tash pas gati dy dekadave kanë ndryshuar dukshëm. Këtë element duhet me pas në konsideratë (A. J.)

**Dr. Sedat ISLAMI**

# AJKA E VEPRAVE TË VIRTYTSHME

## Hyrje

Në Kuranin fisnik dhe në hadithet e Pejgamberit a.s., bëhet thirrje që besimin ta shoqërojmë me vepra të mira. Besimi, siç është përshkruar,[1] i ngjan një peme të fuqishme dhe frutdhënëse gjatë gjithë kohës. Në Kuran, në dhjetëra vende, besimi është shoqëruar me veprën e mirë.[2] Janë ofruar edhe shembuj të veprave të mira, por që disa prej tyre janë dalluar nga të tjerat për rëndësinë dhe ndikimin. Fjala është për: frikën nga Zoti, namazin, urdhërimin për të mirë dhe ndalimin nga e keqja, durimin dhe faljen, të cilat janë përmendur në ajetet e mëposhtme si vepra të veçanta:

﴿ لَتُبْلَوُنَّ فِي أَمْوَالِكُمْ وَأَنفُسِكُمْ وَلَتَسْمَعُنَّ مِنَ الَّذِينَ أُوتُوا الْكِتَابَ مِن قَبْلِكُمْ وَمِنَ الَّذِينَ أَشْرَكُوا أَذًى كَثِيرًا ۚ وَإِن تَصْبِرُوا وَتَتَّقُوا فَإِنَّ ذَٰلِكَ مِنْ عَزْمِ الْأُمُورِ ﴿١٨٦﴾

***"Ju, me siguri do të sprovoheni në pasurinë e në jetën tuaj dhe do të dëgjoni shumë fyerje nga popujt që iu***

---

[1] Shih: Kurani: Ibrahim: 24-25.

[2] 88 herë janë përmendur imani dhe vepra e mirë së bashku. Sipas: Abdurrahan Helelij, "Iktiranu el Imani bil ameli es salihi fil Kuran", Revista e Universitetit të Damaskut për Shkenca Ekonomike dhe Juridike, vëll. 27, nr. 3, v. 2011, f. 450.

***është dhënë Libri para jush, si dhe nga paganët. Por, nëse ju duroni dhe ruheni** (nga të këqijat), **atëherë kjo është vërtet përcaktuese e çështjeve.”** (Ali Imran, 186).*

﴿يَا بُنَيَّ أَقِمِ الصَّلَاةَ وَأْمُرْ بِالْمَعْرُوفِ وَانْهَ عَنِ الْمُنكَرِ وَاصْبِرْ عَلَىٰ مَا أَصَابَكَ ۖ إِنَّ ذَٰلِكَ مِنْ عَزْمِ الْأُمُورِ ﴿١٧﴾﴾

***“O djali im, kryeje namazin, urdhëroje të mirën, pengoje të keqen dhe bëhu i durueshëm për çfarëdo që të godet! Me të vërtetë, ky është thelbi i patundur i të gjitha punëve!”** (Llukman, 17).*

﴿وَلَمَن صَبَرَ وَغَفَرَ إِنَّ ذَٰلِكَ لَمِنْ عَزْمِ الْأُمُورِ ﴿٤٣﴾﴾

***“Kushdo që duron dhe fal, ta dijë se, në të vërtetë, këto janë nga veprimet më të virtytshme.”** (Shura, 43).*

Se çfarë nënkuptohet me këto vepra dhe cilat janë urtësitë e veçimit të tyre, me lejen e Allahut do të mundohemi t’i mësojmë në këtë punim.

## Përse janë quajtur 'Azm el umur`?

Dijetarët myslimanë,[3] në shpjegimet që kanë ofruar për kuptimin e togfjalëshit “azm el umur” kanë dhënë dy shpjegime me vlerë:

---

[3] Tefsireve që u jemi referuar për këto kuptime Muhamed bin Xherir et Taberij, *Xhamiu el bejan an te’vili aji el Kur’an*, red. shkenc. dr. Abdullah bin Abdulmuhsin et Turki, (Kajro: Dar Hixhër, 2001), 6/291; 18/558; 20/529; Ismail bin Omer bin Kethir, *Tefsiru el Kur’ani el adhim*, red. shkenc. Hikmet bin Beshir bin Jasin, (Arabi Saudite: Dar Ibën Xheuzi, 1431 h.). 2/482; Muhamed bin Ahmed el Kurtubi, *El xhamiu el ahkami el Kur’an*, red. shkenc. Ahmed Berduni dhe Ibrahim Atfish,

1) I janë referuar kuptimit gjuhësor, sipas të cilit veprat që janë *azm* reflektojnë *vendosmëri, seriozitet, forcë, energji, durim, qëllim, përmbushje të premtimit, virtyte*. Pra, janë vepra madhështore që prezantojnë personalitetin e përkryer të besimtarit. Këto vepra janë të atilla që duhet kujdesur për to dhe se vetëm besimtarët e vendosur dhe seriozë i përkushtohen atyre. Veprat e këtilla sigurisht se janë të obliguara, ngase nuk mund të paramendohet të jenë kaq serioze e pastaj të jenë vullnetare.
2) Duke qenë se janë të këtilla, atëherë ato sigurisht se janë kryer nga pejgamberët, ata që në Kuran dallohen për vendosmëri, seriozitet, sakrificë. Në Kuran, pesë pejgamberë janë dalluar nga të tjerët si *ulu el azmi* – të vendosurit[4], dhe këto vepra mund të jenë quajtur kështu duke marrë parasysh praktikat dhe sakrificën e tyre.

Këto vepra kanë rëndësinë veç e veç, por edhe si tërësi. Kjo për faktin se ato përmbledhin fenë në miniaturë. Devotshmëria paraqet dimensionin shpirtëror të fesë, namazi atë fetar ose praktik, urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja instrumentin shoqëror të fesë, dhe durimi dhe falja para-

(Kajro: Dar el kutub el misrije, ed. 2, 1964), 3/110; 4/304; 14/69; 16/44; El Husejn bin Mesud el Begavij, *Mealim et tenzil fi tefsiri el Kur'an*, red. shkenc. Muhamed Abdullah Nemr, Uthman bin Xhumuah Dumejrije dhe Sulejman Muslim el Haresh, (Riad: Dar Tajjibe, ed. 4, 1997), 2/148; 6/289; 7/198; Abdurrahman bin Nasir es Sa'di, *Tejsiru el Kerimi err Rrahman fi tefsiri kelami el Mennan*, red. shkenc. Abdurrahman bin Muala Luvejhak, (Bejrut: Muessesetu err Rrisale, 2000), f. 160; 648; 760.

[4] Shih: Kurani: Ahkaf: 35.

qesin vlerat dhe virtytet e saj. Ky është dhe klasifikimi që do ta ndjekim gjatë shtjellimit të tyre.

## Dimensioni shpirtëror

Devotshmëria është lidhja dhe raporti më korrekt ndërmjet robit dhe Zotit. Devotshmëria, siç e ka interpretuar Imam Taberiu në këtë ajet, nënkupton që "t'ia kemi frikën Zotin në çdo gjë që na ka urdhëruar dhe ndaluar, duke iu bindur në të gjithë këtë"[5], pra, duke zbatuar urdhëresat dhe duke u larguar nga ndalesat.

Devotshmëria ka rëndësinë e vet shpirtërore për faktin se, duke pasur këtë lidhje të fuqishme me Zotin, besimtari nuk e humb shpresën asnjëherë dhe nuk demoralizohet. Përkundrazi, ai e di se premtimi i Zotit për të devotshmit është i vërtetë dhe se herët apo vonë do të ketë rrugëdalje për problemet, hallet dhe sfidat e tij.[6] Pra, lehtësime dhe zgjidhje të problemeve do të kenë të gjithë ata që i besojnë Zotit dhe u përmbahen rregullave dhe fesë së Tij.

Devotshmëria, vështruar sipas kontekstit të ajetit dhe shkakut të shpalljes së tij[7], na ofron mësime shumë me vlerë, si:

1) Qëndrueshmërinë përballë sprovave të ndryshme të jetës: shpenzimit të pasurisë (për përmbushjen e dety-

[5] Taberiu, *Xhamiu el bejan an te'vili aji el Kur'an*, vep. cit. 6/290.

[6] Allahu i Madhëruar kështu premton për të devotshmit: ***"...Atij që i frikësohet Allahut, Ai do t'i gjejë rrugëdalje*** *(nga çdo vështirësi)." (Talak, 2);* ***"Atij që i frikësohet Allahut, Ai do t'ia lehtësojë çështjen."*** *(Talak, 4).*

[7] Shih: Kurtubi, *El xhamiu el ahkami el Kur'an*, vep. cit. 4/303-304.

rimeve materiale të përshkruara fetarisht)[8], të humbjes së saj, të humbjes së të afërmve, mbështetësve, frikës, etj.;

2) dallimin e besimtarit të sinqertë nga të tjerët, pasi në sprova dihet kush ka besim të fortë e kush jo;
3) parapërgatitjen për ballafaqimin me sprova të këtilla dhe durimin kur ato të ndodhin;[9]
4) trajtimin me gjakftohtësi të fyerjeve dhe ofendimeve me baza fetare;[10]
5) faljen ndaj atyre që sillen me ne kështu, pra kthimin e të keqes me të mirë, përderisa nuk tejkalohen kufijtë dhe limitet, kur feja më pas lejon hakmarrjen. Për këtë arsye, Sa'di, përmend rolin e devotshmërisë edhe si *përcaktuese të kufirit të veprave të tjera*, durimit më saktë, kufi ky që nuk bën të shkelet, përndryshe kalon në dobësi dhe përbuzje, si dhe më nuk është vepër e vlerësuar fetarisht.[11]

---

[8] Shpenzimi i pasurisë është e dhimbshme për njeriun nga vetë natyra e tij. Për këtë bëhet koprrac dhe i ikën detyrimeve që ka. Shih: Kurtubi, *El xhamiu el ahkami el Kur'an*, vep. cit. 4/303; Sa'di, *Tejsiru el Kerimi err Rrahman fi tefsiri kelami el Mennan*, vep. cit. f. 160.

[9] Shih: Sa'di, *Tejsiru el Kerimi err Rrahman fi tefsiri kelami el Mennan*, vep. cit. f. 160.

[10] Çifutët thanë për Zotin të ishte i varfër e koprrac. Të krishterët thanë se Ai kishte fëmijë. Shih: Taberiu, *Xhamiu el bejan an te'vili aji el Kur'an*, vep. cit. 6/290.

[11] Sa'di, *Tejsiru el Kerimi err Rrahman fi tefsiri kelami el Mennan*, vep. cit. f. 160.

# Dimensioni fetar

Në rrafshin fetar ose praktik, vepër që klasifikohet në kuadër të *azm el umur* është namazi.

Por çfarë synohet me namazin dhe përse ai është pjesë e këtyre veprave?

Dijetarët kanë përmendur se për qëllim me namazin është, jo thjesht falja e tij, por përmbajtja e rregullave dhe kushteve përkatëse.[12] Kjo e bën namazin vepër të cilën besimtari nuk e kryen si të mundet e dosido, por ia kushton vëmendjen dhe përkushtimin më të madh të mundshëm.

E arsyeja pse është përzgjedhur namazi qëndron në pozitën që ka. Është prej adhurimeve fizike më të mëdha.[13] Namazi, siç e dimë është urdhër fetar, të cilin besimtarët duhet ta kryejnë pesë herë në ditë. Është shtyllë e fesë. Është, përtej kësaj, nëse e vështrojmë nga aspekti edukativ, frenuesi nga mëkatet dhe zbardhësi i shpirtit nga njollat e tyre. Allahu i Madhëruar dhe i Dërguari i Tij e kanë përshkruar me këtë efekt.

﴿ وَأَقِمِ الصَّلَاةَ ۖ إِنَّ الصَّلَاةَ تَنْهَىٰ عَنِ الْفَحْشَاءِ وَالْمُنكَرِ ﴾

***"...dhe fale namazin! Vërtet që namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar..."*** *(Ankebut, 45).*

---

[12] Shih: Taberiu, *Xhamiu el bejan an te'vili aji el Kur'an*, vep. cit. 18/558; Ibën Kethiri, *Tefsiru el Kur'ani el adhim*, vep. cit. 6/116.

[13] Shih: Sa'di, *Tejsiru el Kerimi err Rrahman fi tefsiri kelami el Mennan*, vep. cit. f. 648.

Pejgamberi a.s., ka thënë:

أَرَأَيْتُمْ لو أنَّ نَهْرًا ببَابِ أَحَدِكُمْ يَغْتَسِلُ منه كُلَّ يومٍ خَمْسَ مَرَّاتٍ، هلْ يَبْقَى مِن دَرَنِهِ شيءٌ؟ قالوا: لا يَبْقَى مِن دَرَنِهِ شيءٌ، قالَ: فَذلكَ مَثَلُ الصَّلَوَاتِ الخَمْسِ، يَمْحُو اللَّهُ بهِنَّ الخَطَايَا.

*"Çfarë mendoni, nëse dikush do të kishte një lum që rrjedh pranë derës së tij dhe në të cilin do të lahej pesë herë në dit, a do t'i mbetej doç e papastër në turp? Jo, aspak papastërti nuk do t'i mbetej - thanë. Ky është shembulli i namazeve. Allahu i shlyen me to mëkatet – tha ai."*[14]

## Dimensioni shoqëror

Në rrafshin shoqëror, vepër me rëndësi të veçantë është urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja.

Çfarë nënkuptojmë me urdhërimin për të mirë dhe ndalimin nga e keqja? Imam Taberiu në tefsirin e tij, duke shpjeguar ajetin e 17-të të kaptinës Llukman, urdhërimin për të mirë e interpreton "urdhër për t'iu nënshtruar Allahut dhe për ta respektuar urdhrin e Tij", ndërsa ndalimin nga e keqja si "ndalim nga mëkatet dhe rënien në ndalesa."[15]

Urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja është mekanizëm fetar, që ruan vlerat dhe i kultivon ato. Puna e këtij mekanizmi i ngjan punës së një bujku që, për ta rritur një bimë në mënyrë të shëndoshë, përveç ujitjes, duhet t'ia largojë

[14] Buhariu, nr. 528; Muslimi, nr. 667.

[15] Taberiu, *Xhamiu el bejan an te'vili aji el Kur'an*, vep. cit. 18/558.

edhe barishtet e egra. Këto të fundit janë antivlerat, prandaj pa luftimin e tyre nuk mund të paramendohet shoqëria e shëndoshë. Ja sa bukur e ka përshkruar Pejgamberi a.s., fuqinë shpëtuese të urdhërimit për të mirë dhe ndalimit nga e keqja.

مَثَلُ القائِمِ علَى حُدُودِ اللَّهِ والواقِعِ فيها، كَمَثَلِ قَوْمٍ اسْتَهَمُوا علَى سَفِينَةٍ، فأصابَ بَعْضُهُمْ أعْلاها وبَعْضُهُمْ أسْفَلَها، فَكانَ الَّذِينَ في أسْفَلِها إذا اسْتَقَوْا مِنَ الماءِ مَرُّوا علَى مَن فَوْقَهُمْ، فقالوا: لو أنَّا خَرَقْنا في نَصِيبِنا خَرْقًا ولَمْ نُؤْذِ مَن فَوْقَنا، فإنْ يَتْرُكُوهُمْ وما أرادُوا هَلَكُوا جَمِيعًا، وإنْ أخَذُوا علَى أيْدِيهِمْ نَجَوْا، ونَجَوْا جَمِيعًا.

*"Shembulli i atij që nuk i shkel kufijtë (ndalesat) e Allahut dhe atij që i shkel ato, është sikur shembulli i disa njerëzve që kanë hipur në anije, të cilët, për të zënë vendet kanë hedhur short se kush ku do të ulet. Disave shorti iu ra të ulen lart e të tjerëve poshtë. Këta që ishin poshtë kur kishin nevojë për ujë, kalonin pranë këtyre që ishin lart. Nga keqardhja që ndien për ta thanë: sikur ta hapnim një vrimë në pjesën tonë që të mos i bezdisim ata që janë lart! Nëse i lënë ta bëjnë këtë, do të shkatërrohen të gjithë, ndryshe, nëse i kapin për dore dhe i ndalojnë, shpëtojnë ata dhe shpëtojnë të gjithë."*[16]

Por, urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja, nuk janë vepra që kryhen pa rregulla dhe kod përkatës. Përveç dijes, që është parakusht, lipsen edhe butësia, shëmbëlltyra dhe

[16] Buhariu, nr. 2493.

durimi.[17] Kjo për faktin se, siç ka thënë Ibën Kethiri, "çdokush që urdhëron për të mirë dhe ndalon nga e keqja patjetër se do të fyhet e ofendohet, prandaj nuk ka ilaç tjetër për të përveç durimit, kërkimit të ndihmës prej Zotit dhe kthimit tek Ai.."[18]

Çdokush që lexon në biografitë dhe misionet e pejgamberëve a.s., do të gjej se si ata janë fyer dhe nënçmuar pse i kanë urdhëruar njerëzit për të mirë dhe i kanë ndaluar nga e keqja, por që nuk janë dorëzuar kurrë dhe nuk kanë hequr dorë nga misioni.

﴿ وَلَقَدْ كُذِّبَتْ رُسُلٌ مِّن قَبْلِكَ فَصَبَرُوا عَلَىٰ مَا كُذِّبُوا وَأُوذُوا حَتَّىٰ أَتَاهُمْ نَصْرُنَا ۚ وَلَا مُبَدِّلَ لِكَلِمَاتِ اللَّهِ ۚ وَلَقَدْ جَاءَكَ مِن نَّبَإِ الْمُرْسَلِينَ ﴿٣٤﴾

***"Edhe para teje** (o Muhamed!), **shumë të dërguar janë mohuar, por ata e kanë duruar mohimin dhe lëndimin** (që kanë pësuar), **derisa u ka ardhur ndihma Jonë, sepse askush nuk mund t'i ndryshojë vendimet e Allahut. Ti tashmë ke dëgjuar për ata të dërguar."** (En'amë, 34).*

Për këtë shkak, urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja, llogaritet si njëra ndër veprat më të dashura për Allahun e Madhëruar. Pejgamberi a.s., ka thënë:

---

[17] Shih: Sa'di, *Tejsiru el Kerimi err Rrahman fi tefsiri kelami el Mennan*, vep. cit. f. 648.

[18] Ibën Kethiri, *Tefsiru el Kur'ani el adhim*, vep. cit. 2/483; 6/116.

أَحَبُّ الأعمالِ إلى اللهِ إيمانٌ باللهِ، ثم صِلَةُ الرَّحِمِ، ثم الأمرُ بالمعروفِ والنَّهيُ عن المنكرِ

*“Veprat më të dashura tek Allahu janë: Besimi në Allahun, pastaj mbajtja e lidhjeve farefisnore, pastaj urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja…”*[19]

## Dimensioni moral

Vepra të tjera të rangut të lartë janë durimi dhe falja. Ato janë vlera dhe virtyte të rralla për të cilat nxit feja. Sigurisht se kanë edhe kuptimet dhe përkufizimet e tyre fetare.

Të flasim për durimin së pari, e pastaj për faljen.

Durimi është një prej tipareve që Zoti e do, prandaj edhe i ka caktuar shpërblim të madh.[20] E arsyeja pse duhet duruar, në parim, është sepse sprova është e pashmangshme për njeriun. Çdokush, në një ose formë tjetër, sprovohet. Ibën Kethiri ka thënë: “Besimtari patjetër se do të sprovohet në pasurinë, veten, fëmijën ose familjen e tij. Besimtari sprovohet sipas nivelit fetar që ka: nëse është i fortë në fe, sprovohet më shumë...”[21]

Pra, durimi është diçka që na duhet patjetër në jetë, sepse sprovat janë të pashmangshme. Nga këtu, durimi aplikohet në fusha të ndryshme, ku ka e nuk ka qasje e mundësi ndryshimi njeriu, si:

---

[19] Hadith hasen. Shih: Sahih el Xhami, nr. 166.

[20] Shih: Ali Imran, 146 dhe Zumer, 10.

[21] Ibën Kethiri, *Tefsiru el Kur’ani el adhim*, vep. cit. 2/482.

1) Durimi në caktimet hyjnore, si: humbja e të afërmve, që nuk ka asnjë qasje dhe mundësi ndryshimi të tyre. Në këtë rast, durimi është mënyrë për ta përballuar më lehtë fatkeqësinë dhe për ta shndërruar atë në shpërblim te Zoti.[22]
2) Durimi ndaj detyrimeve të caktuara nga Zoti, si: kryerja e adhurimeve që kërkon përkushtim fizik dhe energji. Ata që nuk kanë durim, nuk ia dalin dot t'i kryejnë në tërësi. Po kështu, durim duhet shfaqur edhe kur kërkohet dhënia e gjërave materiale, gjë kjo jo fort e dashur për nefsin. Ne e pamë më lartë se si disa dijetarë e kanë interpretuar sprovën edhe në dhënën e pasurisë, pra përmbushjen e një detyrimi material të fesë, dhe
3) Durimi ndaj sprovave të pashmangshme në kumtimin e fesë.[23] E arsyeja pse duhet bërë durim është se kjo punë nuk është personale, pra ne nuk iu përcjellim njerëzve diçka tonën, por atë që Zoti ua ka urdhëruar, prandaj nuk duhet të heqim dorë, siç thotë Imam Taberiu,[24] për shkak të fyerjeve të tyre.

Por, durimi nuk është dobësi. Durimi, në rastet kur kalohen limitet, mund të shndërrohet në diç të urryer, prandaj me të drejtë Sa'di, siç përmendëm më parë, durimit i vë kufi.

Kjo sa i përket durimit. Ndërsa sa i përket faljes, edhe ajo ka kuptimin dhe vlerën përkatëse. Falja është vlerë dhe vir-

---

[22] Pejgamberi a.s., ka thënë: "E çuditshme është puna e besimtarit, ngado që ta rrotullosh, gjithnjë është në dobi të tij: nëse i ndodh një e mirë, falënderon, dhe për këtë ka shpërblim. Nëse i ndodh një e keqe, duron, dhe për këtë ka shpërblim..." (Muslimi, nr. 2999).

[23] Shih: Ibën Kethiri, *Tefsiru el Kur'ani el adhim*, vep. cit. 2/483; 6/116.

[24] Taberiu, *Xhamiu el bejan an te'vili aji el Kur'an*, vep. cit. 18/558.

tyt, prandaj nuk ka të bëjë aspak me dobësinë. Pothuajse të gjithë mufesirët që i kemi cituar në këtë punim, e kanë përmendur se për qëllim është falja me mundësi hakmarrje. Imam Taberiu, duke e shpjeguar ajetin e 43-të nga kaptina Shura, ka thënë: *"Ai që duron të keqen e atij që i ka bërë keq dhe që ia fal atij gabimin atij që i ka bërë keq, duke mos iu hakmarrë me gjithë mundësinë për një gjë të tillë, dhe këtë vetëm për hir të Zotit..."*[25]

Këtë kuptim e përmend edhe Imam Kurtubiu, i cili shënon edhe një rast që trupëzon këto kuptime madhështore të durimit dhe faljes. Në mexhlisin e Hasan Basriut, një njeri paskësh sharë e fyer disa herë një njeri tjetër. Ky i fundit paskësh duruar aq shumë saqë i tërë qe bërë qull nga djersët. U çua dhe, duke fshirë djersët, lexoi këtë ajet: ***"Kushdo që duron dhe fal, ta dijë se, në të vërtetë, këto janë nga veprimet më të virtytshme."*** *(Shura, 43).* Hasan Basriu kur e dëgjoi duke e lexuar ajetin tha: Për Zotin, e paska marrë vesh dhe e paska kuptuar drejt atë në kohën kur e kanë shpërfillur injorantët![26]

Një detaje tjetër që tregon se përse falja nuk është dobësi është dhe përkufizimi i saj. Imam Kurtubiu, në vazhdim të shpjegimeve që ofron për ajetin e sipërpërmendur, ka thënë: "Përgjithësisht, falja rekomandohet, por ka raste kur gjërat përbysen dhe, në vend të faljes, rekomandohet mosfalja, si p.sh., në rastet kur nevojitet të ndalet shtimi i padrejtësisë dhe e keqja të pritet në rrënjë."[27]

---

[25] Po aty, 20/529.

[26] Shih: Kurtubi, *El xhamiu el ahkami el Kur'an*, vep. cit. 16/44.

[27] Po aty.

Faljen me mundësi hakmarrjeje, Pejgamberi a.s., e ka përshkruar si thelbi i fuqisë. Në një prej haditheve madhështore të tij ka thënë:

ليسَ الشَّدِيدُ بالصُّرَعَةِ، إنَّما الشَّدِيدُ الذي يَمْلِكُ نَفْسَهُ عِنْدَ الغَضَبِ.

*"Nuk është i fortë ai që mund tjetrin në dyluftim; i fortë është ai që përmbahet në hidhërim."*[28]

## Përfundimi

Ndërsa shpalosim detaje rreth këtyre veprave të virtytshme vijmë në përfundim se:

1) Feja nuk ka ligjësuar asgjë vetëm se për të mirën dhe interesin e njeriut;
2) Disa vepra të mira dallojnë nga të tjerat për efektin dhe ndikimin që kanë, qoftë shpirtëror, moral e material, qoftë individual e shoqëror;
3) Devotshmëria nuk është barrë, nuk është ngarkesë, nuk është ajo që ia humb jetës kuptimin, por që ia jep atë. Devotshmëria është disiplinim. Devotshmëria është udhëzuesi jetësor i besimtarit.
4) Adhurimet kanë synime edukative. Ato mund ta luajnë rolin e tyre vetëm atëherë kur të kryhen siç kërkohet;
5) Për shkak se besimtari është shoqëror edhe nga feja, jo vetëm nga natyra, nevoja për ruajtjen e raporteve me të tjerët dhe zhvillimin e tyre konform interesit të përbashkët është e madhe. Për këtë shkak feja ka sjellë mekanizmin e urdhërimit për të mirë dhe ndalimit nga e keqja;

[28] Buhariu, nr. 6114; Muslimi, nr. 2609.

6) Vlerat dhe virtytet islame janë origjinale. Ato dallojnë për konceptet e ekuilibruara dhe për qëllimet fisnike. Ato nuk janë dobësi dhe as që manifestohen për mungesë fuqie. Përkundrazi;
7) Këto vepra të klasifikuara si *azm el umur* përfshijnë tërë jetën e besimtarit, duke filluar nga raporti me Zotin, detyrimet karshi Tij e deri te raportet me veten dhe të tjerët. Këto vepra na ofrojnë konceptin për fetarinë e vërtetë, e cila nuk është pretendim, nuk është formalitet dhe as që manifestohet pjesërisht. Fetaria e vërtetë është e plotë, komplete, produktive, reflekton pozitivitet, energji dhe lumturi.

# SI T`I PËRGATISËSH FËMIJËT PËR JETËN PAS MUNGESËS TËNDE?

Vdekja është një e vërtetë për çdo njeri. Allahu i Lartësuar thotë: ***“Çdo shpirt do ta shijojë vdekjen...”*** *(Ali Imran, 185).* Edhe pse ndarja është e dhimbshme dhe e rëndë, detyra e parë e prindërve është përgatitja e fëmijëve për një jetë që nuk mungojnë sfidat, për ditët kur ndoshta babai apo nëna nuk do të jenë më të pranishëm, qoftë nga vdekja, apo edhe nga rrethana të tjera, që e imponojnë largimin. Ky artikull ndriçon disa prej mënyrave të dobishme për t'i edukuar fëmijët si përgjigje ndaj pyetjes së shtruar në titullin e artikullit: Si t'i përgatisësh fëmijët për jetën pas mungesës tënde?

Pejgamberi a.s., ka thënë: *“Secili prej jush është bari dhe secili prej jush është përgjegjës për tufën e tij.”* (Sahihu i Buhariut). Kujdesi nuk kufizohet vetëm në të tashmen, por shtrihet edhe në të ardhmen, në mënyrë që t'i përgatisim fëmijët të jenë në gjendje ta përballojnë jetën pa u ndierë të humbur kur humbasin njërin nga prindërit.

Udhëheqësi i besimtarëve, Omer bin el Hatabi, Allahu qoftë i kënaqur me të, i mishëroi format më të mëdha të kujdesit për shoqërinë kur refuzoi t'i shpërndante tokat e çliruara tek ushtarët, duke thënë: *“Nëse do t'i shpërndaja, njerëzit e fundit nuk do të kishin asgjë.”*[1] Vizioni i tij ishte që kujdesi

---

[1] *“Pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti im! Sikur të mos më brengoste fakti se do t'i lija pas me duar bosh njerëzit e fundit (pas meje), të varfër që nuk posedojnë asgjë, nuk do të çlirohej asnjë vendbanim (qy-*

të shtrihej dhe të realizohej te brezat e ardhshëm duke përgatitur baza për vazhdimësi dhe zhvillim. Ky është një mësim i rëndësishëm për prindërit, për nevojën e të menduarit për të ardhmen e fëmijëve të tyre pas vdekjes së tyre.

## Mbjellja e besimit dhe virtytit në shpirtin e fëmijëve

Besimi dhe virtyti janë prej dhuratave më të mëdha që prindërit mund t'ua lënë trashëgimi fëmijëve. Allahu i Lartësuar thotë: ***"Babai i tyre kishte qenë njeri i mirë."*** *(El Kehf, 82).* Mirësia nuk sjell dobi vetëm për prindërit, por edhe për fëmijët. Prandaj, prindërit duhet të jenë shembuj të përkushtimit fetar dhe të sjelljes së mirë, dhe të kenë kujdes në edukimin e fëmijëve me vlera të forta të besimit, që t'iu sjellin qetësi dhe forcë kur ata të mungojnë.

Ibën Kajimi, thekson se mbjellja e besimit dhe moralit të mirë te fëmijët fillon nga prindërit përmes udhëzimit dhe edukimit të drejtë. Ai ka thënë: *"Shumica e fëmijëve janë prishur për shkak të prindërve që i kanë neglizhuar dhe nuk ua kanë mësuar detyrimet (farzet) dhe sunetet e fesë."* (Tuhfetul Mevdud bi ahkamil Mevlud).

---

*tet) e që të mos e ndaja (pasurinë e tij) ashtu siç e ndau i Dërguari i Allahut a.s. pasurinë e Hajberit. Por, unë po e lë atë (pasurinë) si një thesar për ta, që ta ndajnë mes vete."* (Sahihu i Buhariut).
Shpjegimi i frazës: *"Njerëz të varfër që nuk posedojnë asgjë",* do të thotë: gjenerata e mëvonshme që do të vijnë pas, pasi brezat e mëparshëm do t'i kenë fituar dhe përvetësuar të gjitha vendbanimet që myslimanët i kanë çliruar dhe nuk do të mbetet më asgjë për ata që vijnë më pas.

## Komunikimi i mirë dhe lidhjet familjare si bazë për bereqet dhe sukses

Të jesh i sjellshëm, i dashur me të afërmit dhe t'i ruash lidhjet farefisnore, janë garanci për dashurinë e njerëzve ndaj teje dhe ndaj fëmijëve pas teje. Lidhja farefisnore është ndër shkaqet më të mëdha të bereqetit dhe suksesit në jetë. Pejgamberi a.s., ka thënë: *"Kush dëshiron që t'i shtohet furnizimi dhe t'i zgjatet jeta, le t'i mbajë lidhjen farefisnore."* (Sahihu i Buhariut).

Fëmijët që i shohin prindërit e tyre duke i respektuar dhe dashur të afërmit, si dhe duke komunikuar me ta me dashuri, mësojnë rëndësinë e këtyre vlerave dhe e vazhdojnë këtë lidhje edhe pas mungesës së prindërve.

## Edukimi për pavarësi dhe përgjegjësi

Ndër dhuratat më të mëdha që prindërit mund t'u japin fëmijëve të tyre është edukimi që u jep atyre pavarësinë dhe aftësinë për ta mbështetur vetveten. Pejgamberi a.s., ka thënë: *"Secili prej jush është bari dhe secili prej jush është përgjegjës për tufën e tij."* (Sahihu i Buhariut). Përgjegjësia jonë ndaj fëmijëve nuk përfundon me ofrimin e ushqimit dhe pijeve, por përfshin edukimin për të marrë përgjegjësi dhe për të marrë vendime të mençura.

Bëjini fëmijët tuaj të aftë t'i menaxhojnë vetë çështjet e tyre, qofshin ato në lidhje me studimet, marrëdhëniet me të tjerët, apo menaxhimin e parave të tyre. Fëmijët që rriten duke u mbështetur plotësisht te prindërit e tyre, bëhen të paaftë përballë çdo sfide nëse veç u mungon mbështetja.

Kalifi i dytë, Omer bin el Hatabi, Allahu qoftë i kënaqur me të, e inkurajonte edukimin e fëmijëve mbi artin e dijes, luftës, pavarësisë dhe shkathtësive praktike të jetës, sepse këto i ndihmojnë ata të mbështeten te vetja dhe u shërbejnë si mbështetje për ta forcuar personalitetin dhe psikologjinë e tyre. Nga thëniet e tij janë: "Ua mësoni fëmijëve tuaj notin, hedhjen me shigjetë dhe kalërimin"; "Mësoni diturinë dhe ua mësoni fëmijëve tuaj, dhe ua mësoni atyre qetësinë dhe dinjitetin",[2] sepse dituria është baza e ndërtimit të një personaliteti të pavarur dhe të suksesshëm. Përmes saj, fëmijët mund të marrin vendime të duhura dhe të bartin përgjegjësitë e tyre.

## Forcimi i besimit dhe i sigurisë në Allahun

**Besimi në Allahun** dhe mbështetja te mëshira dhe urtësia e Tij përbëjnë mbështetjen më të madhe për fëmijët në përballimin e vështirësive të jetës. Edukimi mbi besimin duhet të jetë pjesë e pandashme e metodës edukative të prindërve. Duhet t'ua mësoni fëmijëve se Allahu është Garantuesi, Furnizuesi dhe Ndihmuesi, dhe se humbja e babait apo nënës nuk do të thotë ndërprerje e mëshirës hyjnore.

Allahu i Lartësuar thotë: ***"Prandaj, mos e shtyp jetimin."*** *(Ed Duha, 9).* Allahu ka porositur për jetimin dhe ka theksuar se mëshira e Tij i rrethon ata, dhe se Ai u dërgon atyre njerëz që do t'ua plotësojë nevojat dhe do t'u ndihmojë në vështirësitë e tyre.

---

[2] Kjo është transmetuar nga Imam el Bejhekiu, në librin e tij *"Shu'ab el Iman"* (vëll. 4, f. 177) me zinxhir të mirë transmetuesish *(hasen).*

Ibën Kajimi, në librin e tij "*Medarixhus Salikin*" e thekson fuqishëm këtë vlerë të lartë të besimit, që është bindja e patundur në Allahun e Lartësuar, kur thotë: *"Robi, nëse është i bindur në Allahun dhe i fortë në mbështetjen ndaj Tij, nuk humbet kurrë, sado të grumbullohen sprovat kundër tij."*

Prandaj, mësimi i fëmijëve për të pasur bindje të palëkundur në Allahun ua forcon shpirtin dhe u ndihmon të përballen me vështirësitë me besim dhe siguri. Në këtë frymë, nëna e Imam Malikut ia përsëriste atij që në vegjëli: *"O biri imi, kur ta mësosh diturinë, bëje qëllimin tënd vetëm për kënaqësinë e Allahut, sepse Ai do të të mjaftojë."* Kjo këshillë ia nguliti atij bindjen e thellë dhe mbështetjen e plotë tek Allahu.

## Mbjellja e vlerave dhe e moralit të lartë

Ndër pasuritë më të mëdha që prindërit mund t'ua lënë trashëgimi fëmijëve të tyre janë morali dhe vlerat e larta, të cilat u shërbejnë atyre si pishtarë në jetë. Mësojani fëmijëve tuaj sinqeritetin, besnikërinë, bujarinë dhe sjelljen e mirë me të tjerët. Sepse, edhe nëse prindërit largohen nga kjo botë, këto vlera mbeten si mburoja që i mbrojnë nga rrëshqitja në gabim dhe si mënyrë për ta fituar dashurinë dhe respektin e njerëzve.

Poeti arab ka thënë: *"Dhe rritet djaloshi ynë i ri - sipas asaj që e ka mësuar babai i tij."*

## Edukimi për menaxhimin e parasë dhe të jetesës

Mësoni fëmijët tuaj që nga vegjëlia se si ta menaxhojnë pasurinë, si të kursejnë dhe si të planifikojnë për të ardhmen. Fëmijët që rriten me kulturë të shëndoshë financiare, mund t'i përballojnë më lehtë barrët e jetës, edhe në mungesë të prindërve.

Është jashtëzakonisht e rëndësishme që fëmijët të mësojnë se dinjiteti dhe kënaqësia shpirtërore janë më të mëdha se çdo pasuri. I Dërguari i Allahut a.s., ka thënë: *"Pasuria e vërtetë nuk qëndron në shumësinë e pasurisë materiale, por pasuria e vërtetë është pasuria e shpirtit."* (Sahihu i Muslimit).

## Zgjedhja e mirë e miqve dhe e mbështetësve

Mësoni fëmijët tuaj se si t'i zgjedhin me kujdes shokët e tyre dhe si t'u drejtohen njerëzve të mirë dhe këshilluesve të urtë në kohë nevoje. Sepse shoqëria e mirë është mbështetja më e madhe për fëmijët, pas mbështetjes së Allahut, në kohë të vështira. I Dërguari i Allahut a.s., ka thënë: *"Njeriu është në fenë e shokut të tij, prandaj secili prej jush le të shikojë mirë se me kë po shoqërohet."* (Suneni i Ebu Davudit me zinxhir të mirë të transmetuesve).

## Sigurimi i jetës dhe përgatitja e fëmijëve pas mungesës së prindërve

Prindërit duhet të planifikojnë edhe praktikisht për të ardhmen e fëmijëve të tyre, qoftë përmes një testamenti, qoftë përmes rregullimit të çështjeve financiare, qoftë duke u siguruar që fëmijët të kenë mbështetje nga familja në rast të humbjes së njërit prej tyre. Mendimi për sigurimin e së ardhmes së fëmijëve duhet të shoqërohet me edukimin e tyre për t'u mbështetur tek Allahu dhe për ta ndjekur rrugën e devotshmërisë. Omer bin Abdulazizi, Allahu e mëshiroftë, thoshte: *"Fëmijët e mi janë një nga dy lloj njerëzish: ose janë të devotshëm, dhe Allahu do të kujdeset për ta; ose janë njerëz të prishur, dhe unë nuk dua t'i ndihmoj në prishjen e tyre."*

Ndër gjërat që mund të sjellin dobi për fëmijët, në aspektin e sigurimit të jetës, është ajo që përmendin dijetarët si alternativa të sigurimit tregtar:

1. **Investimi i pasurisë** në një projekt sa më të sigurt, si p.sh. në pasuri të paluajtshme ose të ngjashme, në mënyrë që të ardhurat e tij t'i përforcojnë burimet financiare të familjes dhe, pas vdekjes, të kalojnë në pronësi të fëmijëve, sipas rregullave të njohura të trashëgimisë në Sheriatin islam.
2. **Udhëzimi i çdo fëmije** drejt një fushe pune dhe jetese të përshtatshme, ku ai të mund të sigurojë të ardhura hallall.

# Përfundimi

Trashëgimia më e madhe që prindërit mund t'ua lënë fëmijëve të tyre është *besimi i fortë në Allahun, vlerat e larta morale dhe aftësia për ta përballuar jetën me qëndrueshmëri dhe durim.* Ashtu siç ka thënë Imam Shafiu: "*Nuk është djalosh i vërtetë ai që thotë: "Im atë ishte..." Djalosh i vërtetë është ai që thotë: "Ja ku jam unë!*"

Prandaj, *përgatitni fëmijët tuaj që të mund të thonë: "Ja, këtu jemi ne!",* dhe që të jenë gati për jetën, edhe nëse u mungon babai apo nëna, në mënyrë që të mbeten vazhdimi më i mirë juaji në këtë botë. Allahu i Lartësuar thotë: ***"Allahu ju porosit për fëmijët tuaj"*** *(En Nisa, 11).* Me të vërtetë, edukimi është përgjegjësi madhështore dhe porosi hyjnore.

Prandaj, kujdesuni që të jeni shembull i mirë dhe që t'i përgatitni fëmijët tuaj për ta përballuar jetën me besim dhe kënaqësi, në mënyrë që ata të jenë pasardhës të denjë të një brezi të ndershëm, edhe në mungesën tuaj. Imam Ibën Kajimi ka thënë: *"Kush e lë pa e mësuar fëmijën e vet atë që i sjell dobi dhe e lë atë pa drejtim, ai i ka bërë atij dëm të jashtëzakonshëm. Shumica e fëmijëve bëhen të prishur pikërisht nga prindërit e tyre, nga neglizhenca e tyre ndaj tyre, si dhe nga lënia pas dore e mësimit të detyrave dhe traditave fetare. Ata i lanë pas dore kur ishin të vegjël, kështu që nuk përfituan as vetë, e as nuk u bënë dobi prindërve të tyre kur u rritën."*

Përktheu nga gjuha arabe:

**Miftar Ajdini**

Burimi:

https://islamonline.net//كيف تعد أبناءك للحياة بعد غيابك/

**Isa TËRSHANI**

# MENDJEMADHËSIA - VES I URRYER

## Hyrje

## Përkufizimi i moralit në Islam

Në Islam, etika ose morali është shkenca e cila studion kuptimësinë e së mirës dhe të ligës, e qartëson se si duhet ta trajtojnë njerëzit njëri-tjetrin, si dhe e sqaron edhe synimin që duhet ta kenë njerëzit me anë të veprave të tyre, pra është shkencë, që ua ndriçon njerëzve rrugën për të vepruar si duhet.[1]

E ndiejmë të nevojshme të flasim për etikën ose moralin, sepse ato e kanë zanafillën e tyre qysh me krijimin e njeriut të parë, Ademit a.s.. Kur Ademi a.s., bëri një gabim, ai tregoi natyrën e tij të dobët nga njëra anë, dhe nga ana tjetër tregoi edhe moralin e tij. Pasi bënë gabimin, Ademi a.s. dhe hazreti Hava, thanë:

---

[1] Afif Abdul Fetah Tabbareh, *Shpirti i fesë islame*, përktheu dhe përshtati nga arabishtja Mr. Driton Arifi, Prishtinë 2020. f, 275.

قَالَا رَبَّنَا ظَلَمْنَآ أَنفُسَنَا وَإِن لَّمْ تَغْفِرْ لَنَا وَتَرْحَمْنَا لَنَكُونَنَّ مِنَ ٱلْخَٰسِرِينَ

***“Ata dy thanë: Zoti ynë! Ne i bëmë të padrejtë*** *(e dëmtuam)* ***veten tonë. Dhe në qoftë se Ti nuk na falë dhe nuk na mëshiron, atëherë ne me siguri do të jemi prej të humburve!”***[2]

Kjo është natyra e njeriut të mirë, kjo është thjeshtësia, kjo është modestia, ky është morali i mirë. Nga ana tjetër, edhe shejtani bëri një gabim. Por çfarë bëri ai pas gabimit? Ai tha: “Unë jam më i mirë se njeriu, pse u dashka t’i përulem njeriut? Unë jam krijuar prej zjarrit, ai është krijuar prej balte.” Kjo është mendjemadhësia, ky është morali i mendjemadhësisë dhe i kryeneçit. Që në fillimet e njerëzimit doli në pah morali i mirë dhe morali i ligë.

## Mendjemadhësia në Kuranin fisnik

Allahu i Madhëruar e ka qortuar mendjemadhësinë në shumë vende në Kuranin fisnik dhe i ka qortuar arrogantët mendjemëdhenj duke thënë:

إِنَّهُ لَا يُحِبُّ الْمُسْتَكْبِرِينَ

***“...me të vërtetë, Ai*** *(Allahu)* ***nuk i do mendjemëdhenjtë.”***[3]

Kurse, i Madhi Zot, me një ajet tjetër, në Kuranin fisnik, ka urdhëruar:

---

[2] El A’raf, 23.

[3] En Nahl, 23.

وَلَا تَمْشِ فِي الْأَرْضِ مَرَحًا إِنَّكَ لَنْ تَخْرِقَ الْأَرْضَ وَلَنْ تَبْلُغَ الْجِبَالَ طُولًا

***"Dhe mos ec në tokë me mendjemadhësi e mospërfillje, se ti, me të vërtetë, nuk mund ta çash tokën e të hysh në të e as të kapësh majat e maleve."[4]***

Disa nga dijetarët kanë thanë: "Gjynahu i parë i cili ju bë Allahut ka qenë nga mendjemadhësia e shejtanit." Allahu xh.sh., thotë:

وَإِذْ قُلْنَا لِلْمَلَائِكَةِ اسْجُدُوا لِآَدَمَ فَسَجَدُوا إِلَّا إِبْلِيسَ أَبَى وَاسْتَكْبَرَ ...

***"Dhe** (kujto) **kur Ne u thamë engjëjve: "Bini ju në sexhde para Ademit", ata ranë në sexhde përveç shejtanit** (Iblisit), **i cili nuk pranoi dhe u tregua mendjemadh..."[5]***

Cilësia më e spikatur e shejtanit është mendjemadhësia. Kur Allahu i Madhërishëm e krijoi Ademin a.s., i urdhëroi melaqet e Tij që të përkuleshin para tij me respekt. Të gjithë iu bindën këtij urdhri përveç shejtanit. Ai iu rebelua Zotit, nuk pranoi të përkulej para Ademit a.s., dhe u bë mendjemadh. Kur Allahu xh.sh., e pyeti:

قَالَ مَا مَنَعَكَ أَلَّا تَسْجُدَ إِذْ أَمَرْتُكَ قَالَ أَنَا خَيْرٌ مِنْهُ خَلَقْتَنِي مِنْ نَارٍ وَخَلَقْتَهُ مِنْ طِينٍ

*"(Allahu) **Tha: "Çfarë të ndaloi ty** (o Iblis) **që të mos biesh në sexhde kur Unë të urdhërova?" Ai** (Iblisi)*

[4] El Isra, 37.
[5] El Bekare, 34.

***tha: "Unë jam më i vlefshëm se ai** (Ademi). **Ti më krijove mua nga zjarri, kurse atë e krijove nga balta!"***[6]

Krenaria e madhe dhe mendjemadhësia u bënë shkak që shejtani të mallkohej duke u përjashtuar nga prania e Zotit të Madhëruar.

## Mendjemadhësia në Sunetin e të Dërguarit a.s. – dallimi mes elegancës dhe arrogancës

Edhe tekstet e hadithit i kushtojnë vëmendje të mahnitshme eliminimit të mendjemadhësisë nga zemrat e njerëzve, duke e ndaluar atë dhe duke na paralajmëruar se mund ta humbasin Xhenetin nëse shejtani ka vendosur në zemrat e tyre mendjemadhësi sa grimca e atomit. Atyre do t'ju mohohet hyrja në Xhenet siç transmeton Ibën Mesudi r.a., se Pejgamberi a.s., ka thënë:

...لا يدخلُ الجنَّةَ من كانَ في قلبِه مثقالُ ذرَّةٍ مِن كِبرٍ

*"Nuk do të hyjë në Xhenet ai, që në zemrën e tij ka qoftë një grimcë mendjemadhësie."* Një burrë tha: "*Dikush dëshiron që rrobat dhe këpucët t'i ketë të bukura?*" Muhamedi a.s., tha: *"Allahu është i Bukur dhe e do të bukurën. Mendjemadhësia është refuzimi i të vërtetës dhe sjellja me arrogancë ndaj njerëzve."*[7]

[6] El A'raf, 12.

[7] Dr. Muhamed Ali el Hashimi, *Muslimani ideal*, f. 256.

Po e përmendim edhe hadithin e Pejgamberit a.s., të cilin e transmeton Harith ibën Vehebiu r.a., ku thotë: E kam dëgjuar të Dërguarin a.s., duke thënë:

أَلَا أُخْبِرُكُمْ بِأَهْلِ النَّارِ؟ كُلُّ عُتُلٍّ جَوَّاظٍ مُسْتَكْبِرٍ

*"A doni t'ju tregoj për banorët e Zjarrit? Çdo i vrazhdë, arrogant dhe mendjemadh."*[8]

Gjithashtu Ebu Hurejre r.a., transmeton se Pejgamberi a.s., ka thënë: *"Komunikoi Xheneti me Xhehenemin, dhe Xhehenemi tha: "Unë do të trashëgoj të gjithë ata që janë mendjemëdhenj dhe arrogantë", ndërsa Xheneti tha: "Kurse tek unë nuk do të hyjnë përveçse të dobëtit dhe të pafuqishmit prej njerëzve." Allahu xh.sh., i thotë Xhenetit: "Me të vërtetë, ti je mëshira Ime dhe Unë me ty mëshiroj kë dua nga robërit e Mi." Dhe i tha Zjarrit: "Me të vërtetë, ti je dënimi Im, dhe me ty dënoj kë dua Unë. Secili prej jush, do të mbushet me banorët e tij."*[9]

## Allahu nuk i do mendjemëdhenjtë

Islami kërkon nga myslimani të dallohet në mesin e njerëzve me moral, pamje, veshje, sjellje dhe vepra të mira, njëkohësisht veçon ato të meta morale, që mund ta dobësojnë karakterin e tij dhe mund ta pengojnë zhvillimin e tij shpirtëror, moral dhe kulturor. Një ndër këto pengesa që e ndalon rrugëtimin e besimtarit është edhe mendjemadhësia dhe arroganca. Mendjemadhësia është sëmundje e zemrës dhe cilësi e

[8] Buhariu, 4918.

[9] Buhariu, 4850.

ligë dhe e qortuar fetarisht. Ai që vuan nga mendjemadhësia nuk gjen asnjë mangësi te vetja dhe gjithmonë kënaqet duke gjetur të metat e të tjerët. Myslimani e di që mendjemadhësia nuk ka vend në fenë tonë dhe as që e ngritë kokën e tij lart nga mendimi se ai është më i mirë se njerëzit e tjerë.

## Pasojat dhe ndikimi i mendjemadhësisë

Njeriu mendjemadh e sheh veten në pasqyrën zmadhuese. Mendjemadhi nuk mund t'ua dëshiroj besimtarëve atë që e dëshiron për vete, ai nuk mundet të jetë modest dhe t'i largohet zilisë, urrejtjes dhe zemërimit, si dhe ai nuk mund ta mposhtë mllefin dhe ta pranojë këshillën. Kurse lloji më i keq i mendjemadhësisë është ai që e pengon njeriun ta pranojë të vërtetën dhe t'i nënshtrohet asaj.

Mendjemadhësia sjell me vete shumë të këqija që nuk i kanë hije myslimanit, si: xhelozia, koprracia, mosmirënjohja dhe egoizmi, madje edhe rebelimin ndaj Zotit xh.sh.. Në atë zemër ku sundojnë këto ndjenja, nuk mund të zhvillohen ndjenjat që janë shenjë dalluese të myslimanit, si: modestia, dashuria, mëshira dhe siguria.[10] Thuhet se nuk sillet si mendjemadh përveçse ai që është njeri modest, dhe nuk sillet me thjeshtësi përveçse ai i cili është njeri i lartë.[11]

[10] Kryesia e Çështjeve Fetare në Turqi, *Islami nëpërmjet haditheve*, f. 337.

[11] Ibën Kudama el Mekdesi, Rruga e lumturisë së përjetshme, f. 196.

# Shembuj dhe mësime nga të parët tanë

Mësimet dhe shembujt nga historia islame janë të shumta, mirëpo në këtë shkrim do t'i përmendim dy-tri raste, me qëllim që të njihemi më për së afërmi me të parët tanë. Abdullah ibën Selami, teksa po ecte një ditë midis tregut, mbi shpinën e tij po mbante një barrë me drurë. Atë e pyetën: *"Përse je duke i mbajtur, ndërkohë që Allahu i Madhëruar të ka pasuruar e nuk ke nevojë për këtë gjë?!"* Ai iu përgjigj: *"Unë doja ta largoja mendjemadhësinë prej vetes time."*[12]

Matrafi e pa Mulehebin duke ecur i krekosur me rrobat e tij dhe i tha atij: *"O rob i Zotit, këtë ecje e urren Allahu dhe i Dërguari i Tij."* Mulehebiu i tha: *"A nuk po më njeh mua?"* Ai u përgjigj: *"Sigurisht që të njoh, ti e di vendin nga ke dalë, gjatë jetës ti mban me vete pisllëqe në barkun tënd, dhe fundi yt është një kufomë e cila do të kalbet."* Ai u largua kokulur dhe e la këtë ecje me mendjemadhësi.[13]

Sufjan ibën Ujejne, *Allahu e mëshiroftë,* ka thënë: "Kush e ka bërë gjynahun për shkak të epshit, shpreson për të pendim, ngase Ademi, a.s., ra në gjynah për shkak të epshit, dhe Allahu i Madhëruar ia fali, kurse, kush e ka bërë gjynahun për shkak të mendjemadhësisë, frikoju se për të ka mallkim, sepse Iblisi ra në gjynah për shkak të mendjemadhësisë, dhe u mallkua!"[14]

[12] Saimir Ruhi Bulku, Zemrat e ndriçuara, f. 251.

[13] Po aty, f. 248.

[14] Ibën Kudama el Mekdesi, *Rruga e lumturisë së përjetshme*, f. 195.

## Shkaqet e mendjemadhësisë

1. Pasuria materiale,
2. Dituria e arritur,
3. Bukuria dhe paraqitja e jashtme,
4. Numri i madh i trashëgimtarëve – pasuesve,
5. Kombësia dhe krenaria e tepruar.

Le ta shtrojmë pyetjen se, për çfarë arsye krekoset mendjelarti? - Po! Krekoset për shkak të bukurisë dhe forcës së tij. Po bukuria do të zhduket, sëmundja më e vogël e deformon – e zbehë atë. Çdo ditë koha e bënë të veten në trupin e tij, ndërsa pas kohës së rinisë ndodh dobësimi dhe pleqëria. E nëse krenohet me paratë dhe pasurinë, ai le ta dijë që vdekja nuk bënë dallim ndërmjet të pasurit dhe të varfrit. Njeriu do ta lë tërë atë që e posedonte për tjetrin, për këtë arsye këshillat kuranore kanë ardhur që të ndalojnë krekosjen nga mendjemadhësia. Allahu i Lartëmadhërishëm thotë:

وَلَا تَمْشِ فِي الْأَرْضِ مَرَحًا إِنَّكَ لَنْ تَخْرِقَ الْأَرْضَ وَلَنْ تَبْلُغَ الْجِبَالَ طُولًا

***“Dhe mos ec në tokë me mendjemadhësi. Padyshim që ti as nuk mund ta çash tokën e të hysh në të as nuk mund të kapësh majat e maleve.”[15]***

Pra, mos ec me fodullëk sikur ecin tiranët, sepse ti s’ke mundësi që ta çash tokën me ecjen tënde dhe as me peshën e rëndë të këmbës tënde që e vendos në tokë, dhe sa do që t’i përbuzësh të tjerët, ti s’do ta arrish lartësinë e kodrave. I

[15] El Isra, 37.

Lartmadhërishmi, gjithashtu, na thotë në kontekst të ndalimit nga mendjemadhësia:

وَلَا تُصَعِّرْ خَدَّكَ لِلنَّاسِ وَلَا تَمْشِ فِي الْأَرْضِ مَرَحًا إِنَّ اللَّهَ لَا يُحِبُّ كُلَّ مُخْتَالٍ فَخُورٍ

***"Dhe mos e kthe fytyrën mënjanë me kryelartësi nga njerëzit dhe as mos ec nëpër tokë kryelartë, se Allahu nuk e do asnjë mendjemadh e që shumë lavdërohet."***[16]

Pra, mos e shtrembëro fytyrën tënde kundër atyre që je duke biseduar, ose nëse ata të flasin ty me nënçmim a mendjemadhësi. Kjo, pra, është mendjemadhësia, të cilën e urren Allahu xh.sh., sepse ajo është prej veseve të ulëta, që e prishin shoqërinë njerëzore dhe ngjallin urrejtjen.

Ajo që mundemi të konkludojmë nga kjo temë është:

- Nga mendjemadhësia i bëjmë dëm vetvetes;
- E tërheqim hidhërimin e Allahut;
- Mendjemadhësia të shpie në Xhehenem (ferr);
- Veshja e bukur është e kërkuar. Ajo nuk konsiderohet mendjemadhësi;
- Mendjemadhësia është krenaria e njerëzve të dobët.

Në fund e lus Allahun që të na ruaj nga ky ves i urryer, dhe nga çdo ves a dukuri tjetër negative. Amin!

[16] Lukman, 18.

**Ramadan SHKODRA**

# SREBRENICA - DËSHMI E KTHYER NË AMANET

*Srebrenica* - është emërvendi që i flet botës për njërën prej tragjedive më të mëdha njerëzore në fund të shekullit XX. Është zëri i 8372 burrave dhe djemve myslimanë boshnjakë të vrarë mizorisht nga forcat serbe në korrik të vitit 1995. Është vendi i shehidëve, të cilët u vranë vetëm sepse i përkisnin një etnie tjetër dhe një besimi tjetër nga ai i xhelatit. Aty u synua të zhdukej një popull për shkak të identitetit dhe të fesë së tij. Në Srebrenicë ndodhi gjenocidi, i cili u faktua, me të drejtë vetëm një vit më parë, edhe nëpërmjet konstatimit të tij nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë.

Sot, tridhjetë vjet më pas, "Srebrenica është..., të shkosh në Potoçari; të heshtësh, të shikosh bardhësinë e nishaneve dhe ta lësh heshtjen që të ta shpjegojë leksionin nga historia, për të cilin të gjithë zhurmshëm po flasin."- shprehet në kujtimet e tij, imami Mevludin Hrnjiqi.

Po, vallë, kush është Mevludin Hrnjiqi?

Është autori i librit "Dëshmitar i gjenocidit të Srebrenicës - Kronologji e kujtesës kushtuar gjenocidit në Srebrenicë". Është ai që, bashkë me të tjerët, ishte aty - në qendër të tragjedisë, mu në mesin e kasaphanës. Është ai që nuk shkroi me laps të ftohtë, por me zemrën që ende mban plagët e së kaluarës. Është ai që foli thjesht, por në mënyrë tronditëse.

Është ai që nuk pranoi të heshtë. Është rrëfimtari i dëshmisë bindëse, të vërtetën e së cilës xhelatët nuk mund ta fshehin dot. Është ai që brezave të rinj ua dokumenton dhe ua kujton që kurrë të mos harrojnë se ç'u bënë të parëve fqinjët e tyre.

Imami Mevludin Hrnjiqi nuk është historian, as kronist, as jurist, as gazetar. Ai nuk e shkroi si profesionist i fjalës apo i analizës, por si dëshmitar i mbijetuar, i ndershëm dhe i guximshëm. Ai nuk shkroi me stilin e një akademiku, por me forcën e kujtesës së gjallë, me dhimbjen që buron nga shpirti, me zemrën e plagosur të një njeriu që e pa me sy shfarosjen e popullit të tij.

Prandaj libri "Dëshmitar i gjenocidit të Srebrenicës - Kronologji e kujtesës kushtuar gjenocidit në Srebrenicë", i imam Mevludin Hrnjiqit, nuk është vetëm një vepër letrare a një dëshmi historike. Ai është një britmë që vjen nga thellësia e shpirtit të një të mbijetuari; është një amanet i dhimbjes dhe i qëndresës që nuk bën të harrohet. Nuk është as vetëm autobiografi, por është një testament i dhimbjes dhe i besës, një ftesë për reflektim dhe veprim moral; është një akt nderimi dhe një kambanë që bie për drejtësi dhe kujtesë njëkohësisht.

Me një fjalë, Imami Mevludin Hrnjiq e ka shkruar këtë libër për ta çliruar ndërgjegjen, për të mos e mbajtur brenda vetes peshën e asaj që ka parë dhe përjetuar. Dhe, më shumë se kaq, e ka shkruar për t'i dëshmuar botës, me dinjitet dhe qartësi, mizoritë që i janë bërë popullit boshnjak në Srebrenicë.

I lindur dhe i rritur në rajonin e Srebrenicës, i mbijetuar i gjenocidit të vitit 1995 dhe dëshmitar i gjallë i asaj tragjedie, Imam Mevludin Hrnjiqi, një ndër figurat më të respektuara të

komunitetit mysliman boshnjak sot, mori, pra, mbi vete barrën morale për ta ruajtur kujtesën dhe për ta dokumentuar të vërtetën si një zë i të gjithë atyre që nuk jetojnë më për të rrëfyer. Qëndrimi i tij i palëkundur dhe gatishmëria për ta ndarë dhimbjen me të tjerët, e bëjnë këtë libër jo vetëm të rëndësishëm, por edhe të pazëvendësueshëm në arkivin e kujtesës historike të popullit boshnjak dhe më gjerë. Në një format të këtillë, ky libër është zëri i ndërprerë i klithmave të mijëra të vrarëve, që u artikuluan në dakikun e fundit të jetës së tyre, është amaneti për ta thënë të vërtetën për ta, atë të vërtetë që do të kujtohet si njëra ndër ngjarjet më ngjethëse në historinë e mizorive çnjerëzore, e mbi të gjitha është dhembje e bashkëndjenjë me nënat dhe me familjet boshnjake. Duke e njohur këtë të vërtetë të dhimbshme, bota e qytetëruar u bashkua në shënimin e saj, ndonëse edhe sot vijojnë zërat që e relativizojnë dhe madje edhe e mohojnë gjenocidin e bërë në Srebrenicë. Edhe ata do të mund të mësonin nga dëshmia e autorit Hrnjiq.

Libri është ndërtuar mbi një strukturë kronologjike, që ndjek jetën personale të autorit, të ndërthurur me historinë e përgjakshme të Bosnjës. Ai ndahet në kapituj që trajtojnë jetën para luftës, përvojën gjatë agresionit serb dhe gjenocidin në Srebrenicë, rrugën e mbijetesës nëpër male dhe jetën pas luftës si imam e edukator. Çdo kapitull bart peshën e një kohe të caktuar, që nga fëmijëria e qetë në një familje fshatare myslimane deri te ferri i Srebrenicës dhe rruga e dhimbjes përmes humbjes së babait dhe tre vëllezërve... Libri është një dokumentim i gjallë dhe i thellë i traumës kolektive dhe një testament i qëndresës shpirtërore, që i tejkalon kufijtë e Bosnjës dhe popullit boshnjak dhe që jehon fuqishëm, sidomos

edhe ndër ata që pësuan ngjashëm dhe u përballën me të njëjtin xhelat.

Botimi i këtij libri në gjuhën shqipe është një ngjarje e veçantë dhe me domethënie të thellë. Për herë të parë lexuesi shqiptar ka mundësi që ta lexojë këtë rrëfim të gjallë e të drejtpërdrejtë nga një imam boshnjak, i cili, nëpërmjet përjetimeve të tij personale, flet për tragjedinë e një populli të tërë. Është një ngjarje e veçantë edhe sepse mes asaj që ndodhi në Bosnjë dhe asaj që Serbia tentoi të realizonte në Kosovë ka shumë ngjashmëri. Në të dyja rastet dhuna dhe gjenocidi u përdorën si mjet për spastrimin etnik, për zhdukjen e identitetit. Armiku ishte dhe mbetet i përbashkët - një ideologji e urrejtjes që ka prodhuar vetëm gjak dhe tragjedi në Ballkan.

Ky botim është fryt i një bashkëpunimi të çmuar mes Bashkësisë Islame të Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Bashkësisë Islame të Kosovës, si një shenjë solidariteti, vëllazërie dhe përgjegjësie për ta ruajtur të vërtetën dhe për ta ndarë atë me të gjithë ata që besojnë në drejtësi dhe në të vërtetën.

Shtëpia botuese "Dituria Islame" nga Prishtina e pati për nder që me shumë përkushtim ta realizonte botimin e këtij libri në gjuhën shqipe, sidomos pas bisedave të gjata e plot emocione e dhimbje që patëm vitin e kaluar me Imam Hrnjqin gjatë qëndrimit të tij në Prizren dhe Prishtinë (tetor 2024), me rastin e ekspozitës "Bota kujton Srebrenicën - Svet pamti Srebrenicu" kushtuar gjenocidit të Srebrenicës, të cilin e falënderojmë vëllazërisht.

Libri "Dëshmitar i gjenocidit të Srebrenicës – Kronologji e kujtesës kushtuar gjenocidit në Srebrenicë" i Imam Mevludin Hrnjiqit, që po del në dritë edhe në gjuhën shqipe, le të jetë e le të shërbejë si jehonë e zërit që nuk do të shuhet ku-

rrë; si një thirrje për të mos harruar, por për të mësuar; si kujtesë jo për të urryer, por për të qëndruar të bashkuar përballë padrejtësisë dhe krimit. Le të jetë një homazh për viktimat, për jetët e pafajshme të shuara në Srebrenicë, për nënat që kërkojnë bijtë e tyre edhe sot, për ata që mbijetuan me plagë të pashërueshme. Le të shërbejë gjithashtu si thirrje për të shkruar dhe për ta ruajtur të vërtetën, por edhe si një shembull që duhet ndjekur edhe nga të mbijetuarit tanë në Kosovë, të cilët përjetuan po ashtu terrorin dhe mizoritë e forcave serbe në vitet 90 të shekullit të kaluar, sepse dëshmia është një akt drejtësie, është mënyra më njerëzore për të mos lejuar që krimi të mbulohet nga pluhuri i harresës.

Historia, që të mos përsëritet, nuk duhet të harrohet!

بسم الله الرحمن الرحيم

# TAKVIM
# 1447-1448

# KALENDAR
# 2026

| JANAR I / 2026 | | | |
|---|---|---|---|
| Data sipas kal. botëror | Ditët e javës | Data sipas Takvimit | Festat fetare dhe shënime të tjera astronomike |
| 1 | e enjte | 12 | Rexheb 1447 V.H., Viti i Ri 2026 |
| 2 | e premte | 13 | e Xhuma |
| 3 | e shtunë | 14 | Hëna e plotë |
| 4 | e diel | 15 | |
| 5 | e hënë | 16 | |
| 6 | e martë | 17 | |
| 7 | e mërkurë | 18 | |
| 8 | e enjte | 19 | |
| 9 | e premte | 20 | e Xhuma |
| 10 | e shtunë | 21 | |
| 11 | e diel | 22 | |
| 12 | e hënë | 23 | |
| 13 | e martë | 24 | |
| 14 | e mërkurë | 25 | |
| 15 | e enjte | 26 | Nata e Miraxhit |
| 16 | e premte | 27 | e Xhuma |
| 17 | e shtunë | 28 | |
| 18 | e diel | 29 | |
| 19 | e hënë | 30 | |
| **VIII - Sha'ban 1447 V.H.** | | | |
| 20 | e martë | 1 | Hëna e re |
| 21 | e mërkurë | 2 | |
| 22 | e enjte | 3 | |
| 23 | e premte | 4 | e Xhuma |
| 24 | e shtunë | 5 | |
| 25 | e diel | 6 | |
| 26 | e hënë | 7 | |
| 27 | e martë | 8 | |
| 28 | e mërkurë | 9 | |
| 29 | e enjte | 10 | |
| 30 | e premte | 11 | e Xhuma |
| 31 | e shtunë | 12 | Hamsini |

## JANAR I / 2026

| Data | Ditët e javës | Imsaku | Sabahu | Lindja e diellit | Dreka | Ikindia | Akshami | Jacia | Gjatësia e ditës |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Imsaku dhe kohët e namazit | | | | | | | |
| | | o.m. | o.m. | o.m. | o.m. | o.m. | o.m. | o.m. | o.m. |
| 1 | e enjte | 5:21 | 5:41 | 7:03 | 11:44 | 14:05 | 16:21 | 18:00 | 9:18 |
| 2 | e premte | 5:21 | 5:41 | 7:03 | 11:45 | 14:06 | 16:21 | 18:00 | 9:18 |
| 3 | e shtunë | 5:20 | 5:40 | 7:02 | 11:45 | 14:06 | 16:22 | 18:00 | 9:20 |
| 4 | e diel | 5:20 | 5:40 | 7:02 | 11:45 | 14:06 | 16:23 | 18:01 | 9:21 |
| 5 | e hënë | 5:20 | 5:40 | 7:02 | 11:45 | 14:07 | 16:24 | 18:02 | 9:22 |
| 6 | e martë | 5:20 | 5:40 | 7:02 | 11:46 | 14:08 | 16:25 | 18:03 | 9:23 |
| 7 | e mërkurë | 5:20 | 5:40 | 7:01 | 11:46 | 14:08 | 16:26 | 18:04 | 9:25 |
| 8 | e enjte | 5:20 | 5:40 | 7:01 | 11:46 | 14:09 | 16:27 | 18:05 | 9:26 |
| 9 | e premte | 5:20 | 5:40 | 7:01 | 11:47 | 14:10 | 16:28 | 18:06 | 9:27 |
| 10 | e shtunë | 5:19 | 5:39 | 7:00 | 11:47 | 14:11 | 16:29 | 18:07 | 9:29 |
| 11 | e diel | 5:19 | 5:39 | 7:00 | 11:47 | 14:12 | 16:30 | 18:08 | 9:30 |
| 12 | e hënë | 5:19 | 5:39 | 7:00 | 11:48 | 14:13 | 16:31 | 18:09 | 9:31 |
| 13 | e martë | 5:19 | 5:39 | 7:00 | 11:48 | 14:14 | 16:33 | 18:10 | 9:33 |
| 14 | e mërkurë | 5:19 | 5:39 | 7:00 | 11:49 | 14:15 | 16:34 | 18:11 | 9:34 |
| 15 | e enjte | 5:19 | 5:39 | 7:00 | 11:50 | 14:16 | 16:35 | 18:12 | 9:35 |
| 16 | e premte | 5:19 | 5:39 | 6:59 | 11:50 | 14:17 | 16:36 | 18:13 | 9:37 |
| 17 | e shtunë | 5:18 | 5:38 | 6:59 | 11:50 | 14:18 | 16:37 | 18:14 | 9:38 |
| 18 | e diel | 5:18 | 5:38 | 6:59 | 11:51 | 14:19 | 16:39 | 18:15 | 9:40 |
| 19 | e hënë | 5:18 | 5:38 | 6:58 | 11:51 | 14:20 | 16:40 | 18:16 | 9:42 |
| **VIII - Sha'ban 1447 V.H.** | | | | | | | | | |
| 20 | e martë | 5:18 | 5:38 | 6:58 | 11:52 | 14:21 | 16:41 | 18:17 | 9:43 |
| 21 | e mërkurë | 5:17 | 5:37 | 6:57 | 11:52 | 14:22 | 16:42 | 18:18 | 9:45 |
| 22 | e enjte | 5:17 | 5:37 | 6:56 | 11:52 | 14:23 | 16:44 | 18:19 | 9:48 |
| 23 | e premte | 5:17 | 5:37 | 6:55 | 11:52 | 14:24 | 16:45 | 18:20 | 9:50 |
| 24 | e shtunë | 5:16 | 5:36 | 6:54 | 11:53 | 14:25 | 16:46 | 18:21 | 9:52 |
| 25 | e diel | 5:15 | 5:35 | 6:53 | 11:53 | 14:26 | 16:47 | 18:22 | 9:54 |
| 26 | e hënë | 5:14 | 5:34 | 6:52 | 11:53 | 14:27 | 16:49 | 18:23 | 9:57 |
| 27 | e martë | 5:14 | 5:34 | 6:51 | 11:54 | 14:29 | 16:50 | 18:24 | 9:59 |
| 28 | e mërkurë | 5:13 | 5:33 | 6:50 | 11:54 | 14:30 | 16:51 | 18:25 | 10:01 |
| 29 | e enjte | 5:12 | 5:32 | 6:49 | 11:54 | 14:31 | 16:53 | 18:27 | 10:04 |
| 30 | e premte | 5:12 | 5:32 | 6:48 | 11:54 | 14:32 | 16:54 | 18:28 | 10:06 |
| 31 | e shtunë | 5:11 | 5:31 | 6:47 | 11:54 | 14:33 | 16:55 | 18:29 | 10:08 |

# SHKURT II / 2026

| Data sipas kal. botëror | Ditët e javës | Data sipas Takvimit | Festat fetare dhe shënime të tjera astronomike |
|---|---|---|---|
| 1 | e diel | 13 | Sha'ban 1447 V.H. |
| 2 | e hënë | 14 | Nata e Beratit, Hëna e plotë |
| 3 | e martë | 15 | |
| 4 | e mërkurë | 16 | |
| 5 | e enjte | 17 | |
| 6 | e premte | 18 | e Xhuma |
| 7 | e shtunë | 19 | |
| 8 | e diel | 20 | |
| 9 | e hënë | 21 | |
| 10 | e martë | 22 | |
| 11 | e mërkurë | 23 | |
| 12 | e enjte | 24 | |
| 13 | e premte | 25 | e Xhuma |
| 14 | e shtunë | 26 | |
| 15 | e diel | 27 | |
| 16 | e hënë | 28 | |
| 17 | e martë | 29 | Dita e Pavarësisë së Kosovës |
| 18 | e mërkurë | 30 | Nata e Ramazanit-teravia e parë |
| **IX - Ramazan 1447 V.H.** | | | |
| 19 | e enjte | 1 | Dita I e Ramazanit, Hëna e re, Xhemra I në ajër |
| 20 | e premte | 2 | e Xhuma |
| 21 | e shtunë | 3 | |
| 22 | e diel | 4 | |
| 23 | e hënë | 5 | |
| 24 | e martë | 6 | |
| 25 | e mërkurë | 7 | Xhemra II në ujë |
| 26 | e enjte | 8 | |
| 27 | e premte | 9 | e Xhuma |
| 28 | e shtunë | 10 | |

| SHKURT II / 2026 | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Data | Ditët e javës | Imsaku dhe kohët e namazit | | | | | | | |
| | | Imsaku | Sabahu | Lindja e diellit | Dreka | Ikindia | Akshami | Jacia | Gjatësia e ditës |
| | | o.m. | o.m. | o.m. | o.m. | o.m. | o.m. | o.m. | o.m. |
| 1 | e diel | 5:10 | 5:30 | 6:46 | 11:54 | 14:34 | 16:57 | 18:30 | 10:11 |
| 2 | e hënë | 5:09 | 5:29 | 6:45 | 11.54 | 14:35 | 16:58 | 18:31 | 10:13 |
| 3 | e martë | 5:08 | 5:28 | 6:44 | 11.54 | 14:36 | 16:59 | 18:32 | 10:15 |
| 4 | e mërkurë | 5:07 | 5:27 | 6:43 | 11.54 | 14:37 | 17:00 | 18:33 | 10:17 |
| 5 | e enjte | 5:06 | 5:26 | 6:42 | 11.54 | 14:38 | 17:02 | 18:34 | 10:20 |
| 6 | e premte | 5:05 | 5:25 | 6:41 | 11.54 | 14:39 | 17:03 | 18:35 | 10:22 |
| 7 | e shtunë | 5:03 | 5:23 | 6:39 | 11.54 | 14:40 | 17:04 | 18:36 | 10:25 |
| 8 | e diel | 5:02 | 5:22 | 6:38 | 11.54 | 14:41 | 17:05 | 18:37 | 10:27 |
| 9 | e hënë | 5:01 | 5:21 | 6:37 | 11.54 | 14:42 | 17:07 | 18:39 | 10:30 |
| 10 | e martë | 4:59 | 5:19 | 6:36 | 11.54 | 14:43 | 17:08 | 18:40 | 10:32 |
| 11 | e mërkurë | 4:58 | 5:18 | 6:35 | 11.54 | 14:44 | 17:10 | 18:42 | 10:35 |
| 12 | e enjte | 4:57 | 5:17 | 6:33 | 11.54 | 14:45 | 17:11 | 18:43 | 10:38 |
| 13 | e premte | 4:56 | 5:16 | 6:32 | 11.54 | 14:46 | 17:13 | 18:45 | 10:41 |
| 14 | e shtunë | 4:55 | 5:15 | 6:31 | 11.55 | 14:48 | 17:14 | 18:46 | 10:43 |
| 15 | e diel | 4:54 | 5:14 | 6:29 | 11.55 | 14:49 | 17:16 | 18:48 | 10:47 |
| 16 | e hënë | 4:53 | 5:13 | 6:28 | 11.55 | 14:50 | 17:17 | 18:49 | 10:49 |
| 17 | e martë | 4:51 | 5:11 | 6:27 | 11.55 | 14:51 | 17:18 | 18:50 | 10:51 |
| 18 | e mërkurë | 4:50 | 5:10 | 6:25 | 11.54 | 14:51 | 17:19 | 18:51 | 10:54 |
| **IX - Ramazan 1447 V.H.** | | | | | | | | | |
| 19 | e enjte | **4:49** | 5:09 | 6:23 | 11:54 | 14:52 | **17:21** | 18:52 | 10:58 |
| 20 | e premte | **4:48** | 5:08 | 6:22 | 11.54 | 14:53 | **17:22** | 18:53 | 11:00 |
| 21 | e shtunë | **4:46** | 5:06 | 6:20 | 11.54 | 14:54 | **17:23** | 18:54 | 11:03 |
| 22 | e diel | **4:44** | 5:04 | 6:18 | 11.54 | 14:55 | **17:25** | 18:56 | 11:07 |
| 23 | e hënë | **4:43** | 5:03 | 6:17 | 11.54 | 14:56 | **17:26** | 18:57 | 11:09 |
| 24 | e martë | **4:41** | 5:01 | 6:15 | 11.53 | 14:57 | **17:27** | 18:58 | 11:12 |
| 25 | e mërkurë | **4:40** | 5:00 | 6:13 | 11.53 | 14:57 | **17:28** | 18:58 | 11:15 |
| 26 | e enjte | **4:39** | 4:59 | 6:11 | 11.52 | 14:58 | **17:29** | 18:59 | 11:18 |
| 27 | e premte | **4:37** | 4:57 | 6:08 | 11.51 | 14:58 | **17:30** | 19:00 | 11:22 |
| 28 | e shtunë | **4:36** | 4:56 | 6:06 | 11.51 | 14:59 | **17:31** | 19:01 | 11:25 |

| MARS III / 2026 | | | |
|---|---|---|---|
| Data sipas kal. botëror | Ditët e javës | Data sipas Takvimit | Festat fetare dhe shënime të tjera astronomike |
| 1 | e diel | 11 | Ramazan 1447 V.H. |
| 2 | e hënë | 12 | |
| 3 | e martë | 13 | |
| 4 | e mërkurë | 14 | Hëna e plotë |
| 5 | e enjte | 15 | Xhemra III në tokë |
| 6 | e premte | 16 | e Xhuma |
| 7 | e shtunë | 17 | Dita e fitorës në Bedër, Dita e mësuesit |
| 8 | e diel | 18 | |
| 9 | e hënë | 19 | |
| 10 | e martë | 20 | I'tikjafi - Dita e çlirimit të Mekës viti 630 |
| 11 | e mërkurë | 21 | |
| 12 | e enjte | 22 | |
| 13 | e premte | 23 | e Xhuma |
| 14 | e shtunë | 24 | |
| 15 | e diel | 25 | |
| 16 | e hënë | 26 | Nata e Kadrit* |
| 17 | e martë | 27 | |
| 18 | e mërkurë | 28 | |
| 19 | e enjte | 29 | Nata e Fitër Bajramit |
| **X - Shevval 1447 V.H.** | | | |
| 20 | e premte | 1 | Dita e I e Fitër Bajramit, e Xhuma, Hëna e re |
